



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS / AGRICULTURAL UNIVERSITY OF TIRANA

Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, Albania. / T: +35547200874 / E: info@ubt.edu.al / W: www.ubt.edu.al

UNIVESITETI BUJQËSOR I TIRANËS

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE SIGURIMIT TË CILËSISË (DVBSC)

RAPORT

ANALIZA MËSIMORE E VITIT AKADEMIK

2024-2025

Përgatiti:

Prof. Dr. Ilir Kapaj

Prof. Dr. Ardian Maçi

Prof. Asoc. Dr. Etleva Jojiç

Prof. Dr. Etleva Muça

Dr. Jolia Korita

Msc. Spec. Brunilda Muça

Dhjetor 2025

PËRMBAJTA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Objektivat.....	4
1.3 Metodologjia	4
1.4 Struktura e raportit	5
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E MËSIMDHËNIES.....	6
2.1 Objektivat në mësimdhënie	6
2.2 Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.	9
3. PROGRAMET E STUDIMIT NË UBT	21
3.1 Të dhëna të përgjithshme mbi programet e studimit, që IAL-ja/Njësia baze ka ofruar përgjatë vitit akademik për të cilin raporton, të cilat duhet të shoqërohen me informacionin përkatës për secilin program, mbi statusin e tyre përgjatë vitit dhe aktet përkatëse për krijimin, pezullimin ose mbylljen.....	21
3.2 Të dhëna mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit aktive, përgjatë vitit akademik në secilin fakultet me misionin e institucionit	29
3.3 Të dhëna për realizimin e synimeve të programeve të studimit nga ana e përmbajtjes.....	32
3.4 Të dhëna mbi kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga njësia kryesore e IAL-së dhe një vlerësim i tyre.....	34
PROCESI MËSIMOR.....	40
4.1 Të dhëna mbi plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, dhe raportin e tyre me situatën aktuale në IAL.....	40
4.2 Të dhëna mbi politikat e njësisë/IAL-së për shpërndarjen e fondeve, në funksion të përmirësimit të cilësisë.	54
4.3 Të dhëna mbi numrin e teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimiit	57
5. STAFI AKADEMIK	62
5.1 Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.....	62
5.2 Angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.....	64
6. STUDENTËT DHE GJURMIMI I TYRE.....	66
6.1 Të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit dhe treguesit.....	66
6.2 Gjurmimi i studenteve	113
6.3 Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së	120
7. ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE SIGURIMI I BRENDSDHEM I CILËSISE ...	120
7.1 Standartet Kombëtare të Cilësisë.....	121
7.2 Standartet Ndërkombëtare të Cilësisë.....	121
7.3 Organizimi, menaxhimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë sipas fakulteteve	122
8. VEPRIMTARIA MBESHTETËSE NË FUSHËN E MËSIMIT	130
8.1 Veprimtaria mbështetëse në fushën e mësimiit.....	130
Aneks 1: Programet e studimeve UBT 2024-2025.....	151

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Hyrje

UBT është universiteti më i vjetër në Shqipëri, themeluar më 1 Nëntor, 1951. Fillimisht, ai ka funksionuar si Instituti i Lartë Shtetëror i Bujqësor dhe më tej gjatë historisë së funksionimit të tij, ka fituar statusin si Universiteti Bujqësor të Tiranës. UBT konservon në mënyrë të kujdesshme vlerat e tij akademike, sikundër tregohet ambicioz në strategjitë zhvillimore dhe ato të kërkimit, kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe institucionalizimin e marrëdhënieve me biznesin. UBT është universiteti i parë publik i Akredituar Institucialisht dhe Institucioni i parë Publik i Arsimit të Lartë në vend me numrin më të madh të programeve të studimit të akredituara.

Misioni i UBT është të edukojë shkencëtarë dhe profesionistë të lartë të të menduarit kritik, të kualifikuar për të udhëhequr zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mjedisor në vend. Ne nuk u japim studentëve vetëm edukim dhe përvojë, ne i ndihmojmë ata të kenë sukses në karrierën e tyre dhe të zbulojnë fushën për të cilën kanë pasion dhe ta ndjekin atë.

Puna e nisur në kuadër të Ndërkombëtarizimit nga të gjitha strukturat e UBT e kurorëzuar me nënshkrimin më 28.05.2024 të marrëveshjes midis Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Universitetin BOKU të Vjenës vazhdoi intesivisht edhe gjatë vitit akademik 2024-2025. Qëllimi kryesor i marrëveshjes është reformimi i thellë i UBT-së, në mënyrë që ai të përafrohet brenda vitit 2030 me BOKU dhe universitetet homologe europiane në të tre kolonat e misionit të tij: programet e studimit, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, të gjithë fakultetet dhe strukturat e UBT, u përfshinë në reformimin e programeve të Ciklit të parë të studimit, Bachelor, proces që u finalizua me hapjen e 9 programeve të reja në Bachelor dhe futjen në proces riorganizimi të tre programeve të tjera. Gjithashtu, ka nisur edhe puna edhe për reformimin e ciklit të dytë, Master.

Universiteti Bujqësor i Tiranës po punon intesivisht të shndërrohet në një Qendër Ekselence Rajonale, me synimin final që në fund të këtij bashkëpunimi katërvjeçar të ketë diploma dyfishe dhe programe të përbashkëta të njehsuara me BOKU në Vjenë.

Ky projekt unikal reformimi dhe ndërkombëtarizimi e ka bërë UBT-në, universitetin e parë në vend që projekton të ardhmen e tij me modelin e një ndër universiteteve më të mira në Evropë, me një histori suksesi mbi 150 vjeçare në Shkencat e Jetës, në bujqësi, mjedis, bioteknologji, shkenca pyjore, ekonomi dhe zhvillim rural.

Zbatimi i këtij projekti synon reformimin total të ofertës akademike për të ofruar programe studimi ndërkombëtare dhe të orientuar nga tregu i punës; Programe master në gjuhën angleze të njëjta me Universitetin BOKU; Shkëmbimin e profesorëve dhe studentëve; Riorganizimin e njësive të kërkimit shkencor; Digjitalizimin; Ndërkombëtarizimin e programeve të studimit si dhe Riorganizimin institucional të UBT sipas përvojës së BOKU.

Në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, UBT-ja është Institucion i Arsimit të Lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ato profesionale.

UBT qeveriset sipas parimeve ligjore, në bashkëpunim dhe në transparencë drejt një vizioni të qartë afatgjatë: “UBT-Universitet i Preferuar për Dijen, Shkencën dhe Profesionin”, me objektiva të përcaktuara në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor. Referuar këtij konteksti, UBT-ja është bërë pjesë aktive në shoqërinë shqiptare dhe është pozicionuar me cilësinë më të mirë ndër institucionet publike të arsimit të lartë,

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka filluar të kthehet në një nga universitetet me të preferuara në vend për dijet që ofron, për kërkimin shkencor dhe profesionin e suksesshëm në tregun e vendit dhe të huaj. Tradita, infrastruktura, stafi akademik, studentët dhe qeverisja e mirë po e bëjnë të mundur. Kredencialet e UBT-së janë rritur dhe do të vazhdojnë të rriten duke thelluar zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit, duke rritur kreditet e stafit akademik dhe studentëve.

Viti akademik 2024-2025 ishte një vit i shumë i suksesshëm për UBT-në në drejtim të organizimit, zhvillimit të procesit mësimor dhe ofertës së re akademike që përgatiti për vitin akademik 2025-2026

1.2 Objektivat

Analiza e punës mësimore në tërësinë e saj do të orientohet drejt objektivave të mëposhtme:

- ✓ Vlerësimi i veprimtarisë në punën mësimore në UBT gjatë vitit akademik 2024-2025, referuar detyrave të përcaktuara në Vendimin e Senatit gjatë analizës së vitit të kaluar akademik dhe Planit të Veprimit për këtë vit akademik.
- ✓ Evidentimi i arritjeve me synim shtrirjen e tyre në nivel institucioni.
- ✓ Evidentimi i problematikave dhe mundësitë për zgjidhje.
- ✓ Vendosja e objektivave të reja dhe standardeve më cilësore të punës mësimore për vitin akademik 2025 -20256.

1.3 Metodologjia

Analiza mësimore për vitin akademik 2024-2025 është mbështetur në: Udhëzuesin “Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të arsimit të lartë, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të ministrisë së arsimit dhe sportit” dhe Raportet e Analizave Mësimore të realizuar pranë Njësisë Kryesore të UBT-së gjatë periudhës 02-09 Dhjetor 2025

Në analizën mësimore jepet informacion mbi:

- Realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies.
- Raporte të vlerësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

Raporti i Analizës Mësimore në UBT për vitin akademik 2024-2025 është bazuar në rezultatet e dala nga ky proces në çdo GMK/Njësi Bazë si edhe Njësitë Kryesore; në të dhëna të administruara dhe informacionin e ofruar nga Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe të Karrieres; në të dhëna të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Biblioteka e Universitetit, EDE-ja, në të dhënat nga njësitë e tjera ndihmëse, por më së shumti mbi treguesit e vlerësuar nga Drejtoria e Vlerësimit Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.

Analiza e punës mësimore është mbështetur mbi ndryshimet që kanë ndodhur në kuadrin ligjor si Ligji Nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë

në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimet dhe urdhërat e ardhur nga MAS, kuadri rregullativ dhe institucional, në lidhje me Arsimin e Lartë në vend, si edhe dokumentet kryesore të veprimtarisë së institucionit si Statuti i UBT-së dhe Rregullorja e Studimeve Universitare.

1.4 Struktura e raportit

Raporti i analizës së punës mësimore për vitin akademik 2024-2025 është strukturuar bazuar në grup treguesit e standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë, më konkretisht të grupuar në seksione si më poshtë:

- Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies
- Programet e studimit
- Proçesi mësimor
- Stafi akademik
- Studentët dhe gjurmimi i tyre
- Organizimi, menaxhimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë
- Veprimtaria mbështetëse në fushën e mësimin

2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E MËSIMDHËNIES

2.1 Objektivat në mësimdhënie

Gjatë vitit akademik 2024-2025, objektivat kryesore të mësimdhënies në UBT kanë qënë në përputhje të plotë me:

- Misionin e percaktuar në Statutin e UBT: Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit rural, mjedisit dhe shkencave të natyrës, mjekësisë veterinarë, inxhinierisë pyjore, bioteknologjisë bujqësore dhe resurseve gjenetike.
- Vizionin i UBT-së 2030: Universiteti Bujqësor i Tiranës në të tre nivelet e arsimit të lartë, synon të bëhet qendra ekselente më e madhe e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor.
- Planin strategjik të UBT-së.

Objektivi kryesor në UBT për vitin akademik 2024-2025 ka qënë reformimi i programeve të Ciklit të parë të studimit, Bachelor, dhe përgatitja e Ofertës së re Akademike për Vitin akademik 2025-2026.

Ky objektivi u finalizua me hapjen e 9 programeve të reja në Bachelor dhe futjen në proces riorganizimi të tre programeve të tjera. Gjithashtu, ka nisur edhe puna edhe për reformimin e programeve të ciklit të dytë, Master

Bazuar në këtë objektivi të gjitha njësitet kryesore të universitetit kanë percaktuar objektivat specifike të tyre si me poshte:

I. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA)

Formimin e specialistëve në fushat e Ekonomisë dhe Agrobiznesit përmes kurrikulave që kombinojnë formimin teorik me atë praktik dhe që mbështeten në metoda bashkëkohore të analizës sasiore dhe profesionale.

Pajisjen e studentëve me kompetenca moderne për identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave ekonomike dhe menaxheriale, duke përfshirë menaxhimin e ndërmarrjeve, ekonominë bujqësore, politikat e zhvillimit rural, financat e fermave, zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe digjitalizimin e industrisë së agrobiznesit.

Sigurimin e një baze të fortë kërkimore, duke nxitur zbatimin e metodave të kërkimit shkencor në funksion të sfidave të ekonomisë dhe agrobiznesit, veçanërisht në kontekstin e proceseve të integritetit evropian.

Mbështetjen e zhvillimit të karrierës akademike dhe profesionale për të diplomuarit, duke krijuar mundësi për kualifikim të mëtejshëm, përfshirë studimet në ciklin e tretë.

Programet e studimit të FEA-s janë konceptuar dhe ofrohen në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të fakultetit dhe të njësive të tij bazë. Brenda kuadrit strategjik të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ato pasqyrojnë zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë në

hapësirën europiane, qasjen e reformës UBT_BOKU 2030, tendencat e tregut të punës, kërkesën për kompetenca të reja në ekonominë digjitale dhe transformimin e shpejtë të sektorit agro-ushqimor dhe zhvillimit rural në tërësi.

Në këtë kuadër, FEA përbën një njësi unike për natyrën e saj akademike dhe për shërbimin që ofron në formimin e kapitalit njerëzor në systemin e Agrobiznesit, si dhe për kontributin që sjell në zhvillimin e një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë kombëtare, përfshirë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

II. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM)

Programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) janë të harmonizuara me legjislacionin kombëtar dhe përputhen me interesat zhvillimore të vendit. FBM funksionon si një qendër gjithëpërfshirëse e arsimit profesional, universitar dhe pasuniversitar, duke kombinuar kërkimin shkencor dhe trajnimin praktik për përgatitjen e profesionistëve në fushën e bujqësisë dhe mjedisit. Fakulteti formon specialistë në drejtimit e prodhimit bimor dhe shtazor, hortikulturës, mbrojtjes së bimëve, mekanizimit të bujqësisë, biologjisë detare dhe akuakulturës, peshkimit, si dhe menaxhimit të burimeve natyrore, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në mirëqenien e shoqërisë.

Departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), në funksion të realizimit të programeve të studimit, sigurojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e një numri të mjaftueshëm dhe të kualifikuar të personelit ndihmës mësimor-shkencor për zhvillimin e orëve laboratorike, të cilat janë pjesë integrale e planit mësimor.

III. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU)

Viti akademik 2024-2025 ka qënë një vit i rëndësishëm për Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit pasi ka filluar riorganizimi i programeve të studimit, në kuadër të reformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës sipas Universitetit BOKU të Vjenës. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ofron programe studimi, në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e njësive kryesore.

Të gjitha programet e studimit janë aktive përveç një programi studimi: Master Shkencor në Inxhinieri Agrorëshqimore, drejtimi Vreshtari-Enologji i cili është mbyllur për shkak të mungesës së studentëve. Gjithashtu në kuadër të reformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës sipas modelit të Universitetit BOKU të Vjenës, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, gjatë vitit akademik 2024-2025 është punuar për reformimin e programeve të ciklit të parë të studimit. Gjatë këtij viti akademik nuk është hapur programi "bachelor" i studimit në Inxhinieri Agrorëshqimore, Profili: Teknologjia e Pijeve Alkoolike dhe Joalkoolike. FBU ofron programe studimesh të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

IV. Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP)

Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) mbështet misionin e tij në ofrimin e arsimit cilësor profesional dhe shkencor, duke përgatitur specialistë dhe kërkues që i përgjigjen standardeve bashkëkohore dhe kërkesave dinamike të tregut të punës në fushat e pyjeve, zonave të mbrojtura

dhe industrisë së drurit. Përmes programeve të strukturuar të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe trajnimit praktik, fakulteti synon të formojë profesionistë të aftë për të adresuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të burimeve natyrore.

FSHP ka si vizion të konsolidohet si një qendër moderne dhe e integruar e arsimit universitar dhe pasuniversitar, e cila ndërthur teorinë me praktikën, inovacionin me kërkimin, dhe politikat e zhvillimit me nevojat e komunitetit. Fakulteti synon të shërbejë si pikë referimi kombëtare dhe rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve profesionale, shkencore dhe institucionale që lidhen me pyjet, biodiversitetin dhe teknologjinë e përpunimit të drurit.

Analiza e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të Fakultetit të Shkencave Pyjore (FSHP) gjatë vitit akademik 2024-2025 është orientuar drejt arritjes së objektivave strategjike të përcaktuar në analizën e vitit të kaluar akademik. Në mënyrë të veçantë, vëmendja është përqendruar në:

Vlerësimin e performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, në raport me detyrat dhe pritshmëritë e përcaktuara në analizën paraprake, duke evidentuar progresin, sfidat dhe mësimet e nxjerra gjatë vitit akademik 2024-2025.

Përmirësimin dhe përafrimin e programeve të studimit dhe kurrikulave me kërkesat në rritje të tregut të punës, me qëllim pajisjen e studentëve me kompetenca profesionale, teknike dhe kërkimore që përputhen me profilin e zhvillimit të sektorit pyjor dhe industrisë së drurit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së procesit mësimor, përmes zbatimit të standardeve akademike bashkëkohore, metodave të përmirësuara të mësimdhënies, integritit të praktikave laboratorike dhe fushore, si dhe forcimit të kapaciteteve pedagogjike të stafit akademik.

Përcaktimin e objektivave të rinj strategjike për vitin akademik 2025-2026, me synimin që FSHP të ecë në mënyrë të qëndrueshme drejt procesit të akreditimit dhe riakreditimit të programeve të studimit, duke siguruar përputhshmëri të plotë me standardet e cilësisë të kërkuara nga institucionet vlerësuese.

V. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (FMV)

Programe të studimit në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare gjatë vitit akademik 2024–2025 janë organizuar dhe zhvilluar në përputhje me misionin e institucionit për të formuar veterinerë të kualifikuar, të aftë në diagnostikimin e patologjive të kafshëve, sigurimin e ushqimit dhe parandalimin e sëmundjeve zoonotike. Misioni i FMV-së, i orientuar nga praktikat dhe standardet europiane të EAEVE, fokusohet në ndërthurjen e teorisë me praktikën, duke përgatitur studentët për kërkesat e tregut të punës dhe nevojat reale të shëndetit publik dhe veterinar.

Realizimi i objektivave të mësimdhënies në bazë të planit strategjik:

Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Gjatë vitit akademik 2024–2025 janë përditësuar syllabuset e të gjitha lëndëve, duke u harmonizuar me standardet moderne EAEVE dhe orientimin kompetencor.

Rritja e formimit praktik të studentëve. Orari i praktikave është përshtatur për të lehtësuar lëvizjen drejt Klinikës së Kafshëve të Mëdha, fermës universitare dhe praktikave jashtë kampusit. Studentët janë ndarë në grupe të vogla për të siguruar një ekspozim maksimal praktik, ndërkohë që janë garantuar materialet didaktike, mjetet mbrojtëse dhe respektimi i standardeve të biosigurisë.

Modernizimi i programeve dhe përputhshmëria me standardet europiane. Në kuadër të projektit BOKU-AUT 2030, janë organizuar takime me ekspertë EAEVE për të vlerësuar kurrikulën ekzistuese dhe për të identifikuar mangësitë kritike. Kjo ka çuar në formimin e një grupi punues Ad-hoc që ka hartuar draftin e kurrikulës 5.5-vjeçare, me modul të integruar, mapping të Day-One Competences dhe propozim të sistemit të krediteve sipas procesit Bologna.

Përshtatshmëria me misionin dhe nevojat e tregut të punës. Programet e studimit janë zhvilluar për të krijuar veterinerë të aftë për të përmbushur nevojat e sektorit publik dhe privat, duke integruar njohuritë teorike me aftësitë praktike të kërkuara nga tregu.

2.2 Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.

Të gjitha Njësitë Kryesore kanë punuar serizisht për realizimin e objektivave të vendosura nga strukturat përkatëse dhe brenda afateve të vendosura për vitin akademik 2024-2025.

Detaje më të plota në lidhje me realizimin e objektivave të Njësive gjatë vitit akademik 2024-2025 jepen në forme tabelare: *Tabela nr.1 : Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies*

I. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA)

Për realizimin e objektivave të tij strategjike, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit zbaton një sërë procesesh të integruara, të strukturuar sipas standardeve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, në përputhje me praktikën më të mira të hapësirës europiane.

Proceset kryesore përfshijnë:

- Hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe syllabuseve.
- Zhvillimin rigoro të mësimin teorik dhe praktik.
- Mbarëvajtjen e praktikave profesionale për studentët.
- Akreditimin e programeve të studimit.
- Përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës për aftësitë profesionale të studentëve.
- Identifikimin e kompetencave të reja të kërkuara nga tregu i punës dhe përditësimin e programeve të studimit për t'i plotësuar ato.
- Organizimin e leksioneve të hapura me ekspertë për trajtimin e tematikave aktuale të sektorit të ekonomisë dhe agrobiznesit.

Detaje më të plota në lidhje me realizimin e objektivave të kësaj njësie gjatë vitit akademik 2024-2025 jepen në tablën më poshtë.

Tabela nr.1 : FEA Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/Drejtorja/Se ktori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Verifikimi i materialeve didaktike	Depozitimi i materialeve didaktike në departament	EPZHR / GMK	Materialet vihen në dispozicion të studentëve në librarinë e universitetit dhe në sitet personale të pedagogëve	Tetor 2024 e në vazhdim	Stafi akademik i EPZHR ka përditësuar sitet personale me të gjitha materialet mesimore për studentët
2	Leksione të hapura	Personalitete të ftuar, profesorë vendas dhe të huaj.	EPZHR	Zhvillimi i disa leksioneve të hapura, përtë tre nivelet e studimit	Tetor 2024-qershor 2025	Feedback shumë pozitiv i studentëve dhe pjesëmarrësve
3	Plan veprimi i Informimit të maturantave	Lëvizje nëpër qytete, sipas një kalendari të përcaktuar. Hartimi i postera ve dhe fletëpalosjeve për programet që ofron EPZHR	EPZHR / FEA	Njohja e maturantëve me programet dhe profesionet për zgjedhjen e studimeve të larta	Mars-prill 2025	Takime të suksesshme me maturantët në shkolla të mesme të vendit
4	Plan për prezantimin e programeve të studimit të DEPZHR	Intervista të realizuara në televizione, organe të shtypit	EPZHR	Prezantimi i avantazheve që kanë studentët të cilët regjistrohen në programet e studimit të EPZHR/FEA	Maj-shator 2025	Komente pozitive nga ana e studentëve potencialë
5	Vlëresimi i procesit mësimor	Kontrolle për respektimin e orarit zyrtar mësimor dhe cilësisë së mësimdhënies	EPZHR / FEA	U verifikua korrektësia dhe cilësia e mësimdhënies	Janar-shkurt 2025; Maj-qershor 2025	Kontrollet e realizuara rezultuan në një seriozitet të stafit akademik në procesin mësimor
6	Informimi i studentëve për hapjen e programit MSH	Takim informues me studentët e viteve të treta.	EPZHR / GMK/ FEA	Informimi i studentëve të bachelor-it në prag diplomimi, për mundësitë e vazhdimet të studimeve në MSH	1.7.2025	Plotësim i kërkesave të vazhdueshme të studentëve cilësor për hapjen e këtij programi
7	Mobilitet të stafit dhe studentëve	Shkëmbimi i eksperiencës akademike dhe mësimi në kuadër të globalizimit	FEA	U realizuan disa mobilitet të stafit dhe studentëve të EPZHR	Viti 2024 - 2025	Mobilitet e realizuara: 6 - staf akademik dhe 3 - studentë
8	Marrja e masave për mbylljen e vitit akademik	Përgatitja e dokumentacionit për mbylljen e vitit akademik, mbarëvajtja e provimeve dhe diplomimit të studentëve.	EPZHR / FEA	Ngritja e komisioneve, hartimi i tezave. Diplomimi i studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe	Korrik 2025, 1.9.2025	Mbyllja me sukses e procesit mësimor.

				studimeve ptofesonale të studentëve.		
9	Aplikim për akreditim programesh	Aplikim për akreditim Master Egzekutiv, MSH Ekonomik Cirkulare, MP Ekonomi dhe Politikat Agrare	EPZHR / GMK	Propozimi i realizuar nga Departamenti dhe vendimi i dekanatit për vazhdimin e procedurave	Maj-Korrik 2024	Proces i realizuar, në pritje të fillimit të procesit të akreditimit
10	Ndjekja e procesit të regjistrimit të studenteve në programet e ciklit të parë, të dytë dhe profesional të studimeve	Asistimi i stafit në procesin e regjistrimit të studentëve	EPZHR/ FEA	Orientimi i studentëve në procedurat e regjistrimit sipas grafikut të përcaktuar në departament	Bazuar në afatet e përcaktuara nga urdhri i përbashkët RASH-QSHA	Plotësimi maksimal i kuotave për Ekonomik dhe 98% për DEPZHR për vitin e ri akademik
11	Përgatitja e dokumentacionit për vitin akademik, sipas modelit të unifikuar	Rishikimi i kurrikulave. Përgatitja e syllabusave, plan ngarkesës në përputhje me kurikulën e re sipas BOKU-t	EPZHR/ GMK	Dokumentacioni i plotë i depozituar në departament, Fakultet dhe Rektorat	30.9.2025	Dokumentacion i plotë dhe i përditësuar
12	Përgatitja e dokumentacionit për vitin akademik, sipas modelit të unifikuar	Rishikimi i kurrikulave. Përgatitja e syllabusave, plan ngarkesës	DMI/ GMK	Dokumentacioni i plotë i depozituar në departament, Fakultet dhe Rektorat	1.10.2024	Dokumentacion i plotë dhe i përditësuar
13	Ndjekja e procesit të regjistrimit të studenteve në programet e ciklit të parë, të dytë dhe profesional 2-vjeçar të studimeve	Asistimi i stafit në procesin e regjistrimit të studentëve	DMI/ FEA	Orientimi i studentëve në procedurat e regjistrimit	Bazuar në afatet e përcaktuara nga urdhri i përbashkët RASH-QSHA	Plotësimi maksimal i kuotave
14	Aplikim për akreditim programesh	Përcaktimi i programit të ciklit të dytë MSH për aplikim akreditimi	DMI/ GMK	Propozimi i realizuar nga Departamenti dhe vendimi i dekanatit për vazhdimin e procedurave	Tetor 2024 - Shtator 2025	Proces i realizuar, në pritje të fazave të mëtejshme
15	Verifikimi i materialeve didaktike	Depozitimi i materialeve didaktike në departament	DMI/ GMK	Materialet vihen në dispozicion të studentëve në librarinë e universitetit dhe në sitet personale të pedagogëve	1.10.2024	Stafi akademik i DMI ka të updatuar sitet personale & classroom me të gjitha materialet mesimore për studentët. Pjesa më e madhe e moduleve mbulohen me teks mësues.
16	Leksione të hapura	Lektorë të huaj për dhënien e eksperiencës së tyre me botën e biznesit.	DMI	Zhvillimi i dy leksioneve të hapura,	1.10.2024	Feedback shumë pozitiv i studentëve

				duke ftuar Lektorët e huaj		
17	Plan veprimi i Informimi të maturantave	Informimi i maturantëve nëpërmjet mediave sociale dhe videove promovuese, hartimi i posterave dhe fletëpalosjeve për programet që ofron DMI	DMI/ FEA	Njohja e maturantëve me programet dhe profesionet për zgjedhjen e studimeve të larta	Qershor - Korrik 2025	Shpërndarje e informacionit tek të gjithë maturantët dhe studentet e interesuar.
18	Vlëresimi i procesit mësimor	Kontrolle për respektimin e orarit zyrtar mësimor dhe cilësisë së mësimdhënies	DMI/ FEA	U verifikua korrektësia dhe cilësia e mësimdhënies	Janar-Shkurt 2025; Maj-Qershor 2025	Kontrollet e realizuara rezultuan në një seriozitet të stafit akademik në procesin mësimor
19	Mobilitet të stafit dhe studentëve	Shkëmbimi i eksperiencës akademike dhe mësimi në kuadër të globalizimit	FEA	U realizuan disa mobilitet të stafit dhe studentëve të DMI(Bach,Msh)	Viti 2024 - 2025	Mobilitet e realizuara: 7 - staf akademik dhe 8- studentë
20	Marrja e masave për mbylljen e vitit akademik	Përgatitja e dokumentacionit për mbylljen e vitit akademik, mbarëvajtja e provimeve dhe diplomimit të studentëve.	DMI/ FEA	Ngritja e komisioneve, hartimi i tezave. Diplomimi i studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe studimeve profesionale të studentëve.	Korrik 2025, 1.9.2025	Mbyllja me sukses e procesit mësimor.
21	Përgatitja e dokumentacionit për vitin akademik, sipas modelit të unifikuar	Rishikimi i kurrikulave. Përgatitja e syllabusave, plan ngarkesës	DDA/ GMK	Dokumentacioni i plotë i depozituar në departament, Fakultet dhe Rektorat	1.10.2025	Dokumentacion i plotë dhe i përditësuar
22	Ndjekja e procesit të regjistrimit të studenteve në programet e ciklit të parë, të dytë dhe profesional të studimeve	Asistimi i stafit në procesin e regjistrimit të studentëve	DDA/ FEA	Orientimi i studentëve në procedurat e regjistrimit	Bazuar në afatet e percaktuar nga urdhri i perbashket RASH-QSHA	
23	Aplikim për hapjen e programeve të reja të studimit në ciklin e parë "Bachelor" në kuadër të reformës AUT – BOKU 2030.	Ngritja e nengurpit të punës, percaktimi i kurrikulës, emertimit, përgatitja e të gjithë dokumentacionit të kerkuar për të dyja fazat e aplikimit në MAS.	SËG/DDA/ nengrupi i punës	Propozimi i Departamentit, vendimi i dekanatit për vazhdimin e procedurave, miratimi nga KSS dhe gjithë instancat e tjera në nivel universiteti.	Janar – Mars 2025	Proces i realizuar, në përfundim miratimi nga MAS për hapjen e programit të ri Bachelor në Menaxhim Biznesi me dy profile: a) Menaxhim Agrobiznesi dhe b) Menaxhim i Turizmit Rural në vitin akademik 2025 – 2026.
24	Leksione të hapura	Lektorë të ftuar për dhënien e eksperiencës së tyre me botën e	DDA	Zhvillimi i leksioneve të hapura	Nëntor 2024– Maj 2025	Feedback shumë pozitiv i studentëve

		biznesit ne fushat e tyre te ekspertizes				
25	Plan veprimi i per promovimin e programeve te reja të studimit në kuadër të reformës AUT – BOKU te maturantet	Dokumentuar plani promovues ne Dekanat	DDA/ FEA	Njohja e maturantëve me programet dhe profesionet për zgjedhjen e studimeve të larta	Shkurt - Korrik 2025	
26	Vlëresimi i procesit mësimor	Kontrolle për respektimin e orarit zyrtar mësimor dhe cilësisë së mësimdhënies	DDA/ FEA	U verifikua korrektësia dhe cilësia e mësimdhënies	Viti akademik 2024 - 2025	Kontrollet e realizuara rezultuan në një seriozitet të stafit akademik në procesin mësimor
27	Informimi i studentëve për programet e ciklit te dyte qe ofron DDA	Takim informues me studentët e viteve të treta.	DDA / GMK/ FEA	Informimi i studentëve të bachelor-it në prag diplomimi, për mundësitë e vazhdimi të studimeve në DDA	1.6.2025	
28	Mobilitet të stafit dhe studentëve	Shkëmbimi i eksperiencës akademike dhe mësimi në kuadër të globalizimit	FEA	U realizuan disa mobilitete të stafit dhe studenëve të DDA	Viti 2024 - 2025	
29	Marrja e masave për mbylljen e vitit akademik	Përgatitja e dokumentacionit për mbylljen e vitit akademik, mbarëvajtja e provimeve dhe diplomimit të studentëve.	DDA/ FEA	Ngritja e komisioneve, hartimi i tezave. Diplomimi i studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe studimeve ptofesionale të studentëve.	Korrik 2023, 1.9.2023	Mbyllja me sukses e procesit mësimor.
30	Verifikimi i materialeve didaktike	Depozitimi i materialeve didaktike në departament	DDA/ GMK	Materialet vihen në dispozicion të studentëve në librarinë e universitetit.	30.09.2025	Stafi akademik i DDA ka të updatuar info ne lidhje me me materialet perkatese ne departament dhe ne librarine e universitetit.
31	Kurrikula bashkëkohore në kuader të Marrëveshjes me Universitetin Boku dhe në funksion të kërkesave të tregut të punës	Studime tregu në funksion të programeve dhe kurrikulave që bazohen te nevojat e bizneseve, sa u takon kompetencave te mbuluara nga programet.	DMTR, FEA			
32	Përmrësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies	Rishikim i syllabuseve; vënia në dispozicion të studentëve i materialeve didaktike; sigurimi i pajisjeve audiovizuale në funksion të procesit të	GMK, DMTR, FEA		Shtator 2024 - Nëntor 2024	

		mësimdhënies; monitorim i preocesit				
33	Promovimi i Programeve	Planifikim në grupe	DMTR		1.12.2024	
34	Rishikimi i kurrikulave dhe programeve	Ngritje e grupeve të punës. Diskutime dhe vendimmarrje në departament	DMTR, FEA		Maj- Qershor 2025	

II. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM)

Tabela nr.1 : FBM Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/S ektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Monitorimi dhe ndjekja e procesit të regjistrimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë përbën një aspekt thelbësor të veprimtarisë akademike.	Asistimi i stafit në procesin e regjistrimit të studentëve, siguron që pranimi dhe regjistrimi të realizohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret përkatëse, duke garantuar transparencë, korrektësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.	Departamentet/ FBM	Orientimi i studentëve në procedurat e regjistrimit. Përmes këtij mekanizmi, Fakulteti siguron një menaxhim efikas të procesit akademik dhe një fillim të suksesshëm të studimeve për çdo student të ri.	Bazuar në afatet e përcaktuar nga urdhri i përbashkët RASH-QSHA	Plotësimi i kuotave për vitin akademik 2024-2025 në ciklet e studimit të FBM
2	Përgatitja e dokumentacionit për vitin akademik realizohet në përputhje me modelin e unifikuar të përcaktuar nga universiteti.	Rishikimi i kurrikulave. plan ngarkesës	GMK/Departamentet/ FBM	Dokumentacion i plotë dhe i përditësuar, i depozituar në departament, Fakultet dhe Rektorat	Nëntor 2024	Ky proces synon standardizimin dhe harmonizimin e dokumenteve administrative e akademike, duke garantuar cilësi, qartësi dhe përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. Zbatimi i këtij modeli unifikuar lehtëson menaxhimin e të dhënave, rrit efikasitetin administrativ dhe siguron një funksionim të rregullt e të koordinuar të veprimtarive akademike gjatë gjithë vitit akademik.
3	Rishikimi periodik i cikleve të leksioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor dhe përshtatjen e përmbajtjes akademike me zhvillimet	Update i leksioneve	FBM/Depart.	Realizuar	Çdo fillim viti akademik	Në këtë mënyrë, sigurohet që studentët të marrin njohuri të përditësuara dhe të aftësohen për sfidat profesionale të fushës përkatëse.

	bashkëkohore shkencore dhe kërkesat e tregut të punës.					
4	Zhvillimi i qëndrueshëm i cilësisë së pranimeve në programet e studimit	Respektimi i kriterëve për pranimet e reja bazuar edhe tek Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular në UBT, në programet e studimit BSc dhe në programet e ciklit të dytë që mbulon FBM	FBM/Depart., Vendorsja e kriterëve përzgjedhëse	Drejtuesi i departamentit, Drejtuesit e grupeve mësimore	Përzgjedhja e kandidatëve për Programet e studimit që mbulon FBM në përputhje me kriteret për pranimet e reja dhe Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular në UBT	Shtator – Tetor 2024
5	Vlërimi i procesit mësimor	Kontrolle për respektimin e orarit zyrtar mësimor dhe cilësisë së mësimdhënies	Departamentet/ FBM	U verifikua korrektësia dhe cilësia e mësimdhënies	Nëntor-Dhjetor 2024; Maj-Prill 2025	Kontrollet e realizuara rezultuan në një seriozitet të stafit akademik në procesin mësimor
6	Promovimi i programeve të studimit synon rritjen e vizibilitetit dhe tërheqjen e kandidatëve të rinj drejt Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.	Takime me maturanet, si dhe përditësimi dhe përdorimin e platformave digjitale dhe mediave sociale për komunikim efektiv.	FBM	Organizimi i aktiviteteve informuese, ditëve të hapura, prezantime në shkolla të mesme	Mars 2024	Qëllimi kryesor është informimi i të rinjve mbi mundësitë akademike, praktikat profesionale dhe perspektivat e punësimit që ofrojnë programet e studimit, duke forcuar imazhin dhe reputacionin e fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
7	Përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më të përparuar.	Kualifikimi i mëtijshëm i stafit akademik të FBM, pjesëmarrja me referime në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore, realizimi i mobiliteteve të tipit training dhe teaching në universitete të BE	Realizimi i artikujve në revista dhe referimeve në konferenca, ëorkshope, etj.	FMB/Depart.	Ka kaluar me sukses kualifikimi për Prof. Assoc.Dr. i një anëtar i stafit akademik të DSHA. 2 anëtar të stafit kanë ndjekur studimet jashtë vendit në kuadër të Doktoraturës.	
8	Leksione të hapura	Lektorë të ftuar për dhënie e eksperiencës së tyre me botën e biznesit ne fushat e tyre te ekspertizes	Departamentet/ FBM	Zhvillimi i leksioneve të hapura	Nentor 2024– Maj 2025	Reagim shumë pozitiv i studentëve. Këto aktivitete krijojnë një hapësirë interaktive për diskutim, frymë bashkëpunimi dhe nxitje të mendimit kritik, duke lidhur teorinë me praktikën.
9	Informimi i studentëve të ciklit të parë për të gjithë programet e ciklit të dytë që ofron njësi kryesore.	Takim informues me studentët e viteve të treta.	Departamentet/ FBM	Informimi i studentëve të bachelor-it në prag diplomimi, për mundësitë e vazhdimi të studimeve në MSH	Qershor-Korrik 2025	

III. Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit (FBU)

Tabela nr.1 : FBU Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtorja/Spektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Organizimi i praktikave mësimore për modulet e formimit bazë	Njohja e studentëve me njësitë prodhuese të ushqimit	DTA, DShUB, DK, QKU	Realizuar	Çdo vit akademik	Nuk ka
2	Realizimi i projekt kurseve për çdo modul	Kontrolli i dijeve të studentëve nëpërmjet projekt-kurseve	DTA, DShUB, DK	Realizuar	Çdo vit akademik	Nuk ka
3	Realizimi i kontrollit të dijeve nëpërmjet provimeve të ndërmjetme për çdo modul	Kontrolli i studentëve	DTA, DShUB, DK	Realizuar	Çdo vit akademik	Nuk ka
4	Përmirësimi i kurës së mundur i Kurrikulave të programeve të studimit	Rishikimi dhe përmirësimi i Programeve të studimit sipas BOKU	DTA, DShUB	Realizuar	Çdo fillim viti akademik	Nuk ka
5	Rishikimi i sillabuseve	Rishikimi dhe përmirësimi i Sillabuseve sipas BOKU	DTA, DShUB	Realizuar	Çdo fillim viti akademik	Nuk ka
6	Përmirësimi i dokumentacionit, cilësisë së metodave të mësimdhënies	Plotësim i vazhdueshëm	DTA, DShUB, DK	Realizuar	Çdo fillim viti akademik	Nuk ka
7	Përmirësimi i materialve të mësimdhënies apo teksteve mësimore	Plotësim i vazhdueshëm	DTA, DShUB, DK	Realizuar	Çdo fillim viti akademik	Nuk ka

IV. Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP)

Tabela nr.1 : FSHP Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtorja/Spektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente

1	Ndjekja e ecurisë së regjistrimit të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë Uni Tuscia.	Ndihma e stafit akademik dhe ndihmës akademik gjatë procesit të regjistrimit të studentëve	Departamentet / FSHP	Orientim i studentëve në procedurat e regjistrimit, në përputhje me urdhrin RASH-QSHA	Sipas kalendarit zyrtar	Bachelor: + 20%. Master Profesional: rënie. Master Shkencor: rritje
2	Përgatitja e dokumentacionit për vitin akademik 2024 - 2025, sipas modelit të unifikuar	Rishikimi i kurrikulave dhe planit të ngarkesës mësimore.	Departamentet / FSHP	Dokumentacion i plotë i depozituar në Departament, Fakultet dhe Rektorat	Nëntor 2024	Dokumentacion plotësisht i përditësuar
3	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies	Rishikimi i syllabuseve; Materialet didaktike në dispozicion të studentëve; Monitorimi i procesit mësimor	Departamentet / FSHP	Dorëzimi i syllabuseve të përmirësuar në departament	Shtator 2024 - Korrik 2025	Mbarëvajtje e qetë dhe e rregullt e procesit mësimor
4	Vlerësimi i procesit mësimor	Kontroll i orarit zyrtar dhe cilësisë së mësimdhënies	Departamentet / FSHP	U verifikua korrektësia dhe cilësia e mësimdhënies	Shtator 2024 - Korrik 2025	Evidentohet serioziteti dhe përkushtimi i stafit
5	Promovimi i programeve të studimit	Takime me maturantë; publikime promovuese në rrjetet sociale të FSHP	Departamentet / FSHP	Aktivitetet e promovimit sipas planit	Mars-Prill 2025	Përmirësim i materialeve dhe avantazhet e programeve
6	Informimi i studentëve të ciklit të parë mbi programet e ciklit të dytë	Takim informues me studentët e viteve të treta	Departamentet / FSHP	Informim për vazhdimin e studimeve në Master Shkencor	Korrik 2025	Reflektim i kërkesës së studentëve për programe të reja

V. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (FMV)

Këto qëllime u realizuan nga strukturat përgjegjëse dhe brenda afateve kohore të paracaktuara nëpërmjet: përditësimit të syllabuseve dhe materialeve mësimore, trajnimit dhe kualifikimi i vazhduar të stafit akademik, vënies në dispozicion të studentëve të të gjitha materialeve mësimore, vlerësimit të vazhduar të studentëve në mënyrë objektive, zhvillimit korrekt të provimeve, përshtatjes së programit të moduleve dhe orarit mësimor në funksion të formimit praktik të studentëve, evidentimit të gjendjes së laboratorëve mësimor dhe nevojave për realizimin e

praktikave, planifikimi lëvizjeve të studentëve në shërbim të formimit praktik përfshirë edhe kostot financiare të tyre.

Provimet/riprovimet u mbajtën sipas kalendarit të planifikuar nga Zv. Dekani për mësimin dhe janë zhvilluar në korrektësi të udhëzimeve dhe vendimeve të marra në Dekanatin e FMV apo Rektoratin e UBT. Janë respektuar datat, oraret, format e provimeve, mënyrat e përpilimit të procesverbaleve, përjashtuar disa raste vonesash në dorëzim dhe problemesh teknike të sistemit të cilat janë arritur të korrigjohen në kohë. Provimet janë zhvilluar sipas rregullores në fuqi, të shoqëruara gjithmonë me dokumentacionin përkatës për vlerësimin gjithëvjeter të studentëve.

Tabela nr.1 : FMV Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/Drejtorja/Spektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1.	Përmirësimi i mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve	Përditësimi i syllabuseve të të gjitha lëndëve në përputhje me kërkesat moderne të EAEVE dhe orientimin kompetencor	Departamentet, FMV	Syllabuset janë dorëzuar dhe miratuar në Departamente; disa janë harmonizuar me standardet e kurrikulës që do riorganizohet në vazhdim gjatë vitit akademik 2025-2026	Në vazhdim	Procesi ka synuar qartësimin e rezultateve të të nxëniet, integrimin e praktikave klinike dhe sinkronizimin e përmbajtjes me planin strategjik të FMV.
		Përditësimi i materialeve mësimore: prezantime, skenarë klinikë, video demonstrative, përmbledhje praktike	Departamentet, FMV	Të gjitha materialet e përditësuara janë depozituar në Departamente dhe janë verifikuar në nivel cilësie	Tetor 2024	Lehtësimi i mësimdhënies vizuale dhe interaktive ka rritur qartësinë e koncepteve, sidomos në lëndët klinike dhe biologjike.
		Trajnimi dhe kualifikimi i vazhduar i stafit akademik	Dekanati, Departamentet	Stafi ka marrë pjesë në mobilitete ERASMUS+, CEEPUS dhe ëorkshop-e pedagogjike	2024–2025	Trajnimet kanë fokusuar metodologjitë moderne të mësimdhënies, vlerësimin objektiv.

		Vënia në dispozicion e materialeve për studentët në platforma qendrore dhe individuale	Departamentet, FMV	Materialet janë të aksesueshme në platformat e pedagogëve	Tetor 2024	Është intensifikuar komunikimi elektronik me studentët, duke rritur transparencën dhe aksesin në materiale në kohë reale.
		Zbatimi i vlerësimit të vazhduar të studentëve	Stafi akademik, FMV	Vlerësimi është kryer sipas rubrikave të përcaktuara në syllabus dhe është reflektuar në procesverbale	Fundi i semestrit	Studentët informohen për kriteret e vlerësimit; theksi është te monitorimi i progresit gjatë gjithë vitit akademik dhe jo vetëm në provim.
		Komisionet e provimeve dhe organizimi i provimeve finale	Departamentet, FMV	Komisionet janë miratuar paraprakisht; provimet janë zhvilluar sipas standardeve	Fundi i çdo semestri	U përdorën teste me alternativa të shumëfishta (quiz) të korrigjuara me ClickScore. Për lëndët klinike u aplikuan OSCE, vlerësime praktike “on-site”, dhe testime të aftësive profesionale.
		Ofrimi i moduleve në gjuhën angleze për studentët e huaj	Departamentet, FMV	Janë përgatitur disa module bazë në anglisht; proces në zgjerim	2024–2025 dhe në vazhdim	Duke qenë se FMV është aktiv në mobilitete ndërkombëtare, kërkesa për mësim në anglisht po rritet; përgatitja e moduleve do të zgjerohet vit pas viti.
2.	Rritja e formimit praktik të studentëve	Përshtatja e programeve të moduleve	Departamentet, Dekanati	Programet e disa moduleve janë rishikuar dhe pasuruar me më shumë orë praktikash laboratorike dhe klinike	Tetor 2024	Synon forcimin e “hands-on skills” dhe harmonizimin e praktikave me standardet EAEVE.
		Përshtatja e orarit mësimor për praktikë	Departamentet, Dekanati FMV	Është riorganizuar orari për të lehtësuar lëvizjen drejt Klinikës së Kafshëve të Mëdha, fermës universitare dhe praktikave të jashtme	Tetor 2024	Studentët janë shpërndarë në grupe të vogla në klinika të kafshëve të vogla në Tiranë, si dhe në rotacion në fermën universitare për praktikë 1–2 javore; qëllimi është rritja e ekspozimit klinik ditor.
		Angazhimi i stafit për nevojat laboratorike dhe klinike	GMK, Departamentet, Administratori, FMV	Janë evidentuar nevojat laboratorike dhe janë siguruar materialet didaktike dhe mjetet mbrojtëse	Shtator 2024 dhe në vazhdim	Janë siguruar bluza përparëse, stetoskopë personale, formularë klinikë, mjete mbrojtëse dhe janë respektuar standardet e biosigurisë gjatë praktikave.

		Nevojat për mjete lëvizëse dhe kostot	Departamentet, Administratori, FMV	Është planifikuar lëvizja e studentëve me autobus për praktikatat në terren dhe është bërë vlerësimi i kostove	Shtator–Tetor 2024	Lëvizjet mundësojnë praktika në ferma të derrave, gjedhit, shpendëve dhe peshqve; studentët trajnohen në diagnostikë, biosiguri, mirëqenie, higjenë mishi dhe procese të abatorit. Përvoja praktike lidhet drejtpërdrejt me “Day One Competences”
3.	Modernizimi i programeve të studimit: përmirësimi i kurrikulave të AUT me standarde evropiane (BOKU-AUT 2030)	Organizimi i takimit me ekspertë EAEVE për vlerësimin e programit ekzistues dhe identifikimin e mangësive kritike në kurrikulë	Dekanati FMV, Departamentet, Koordinatorët e Projektit BOKU-AUT 2030	Takimi u mbajt më 19.03.2025; raporti i vetë-vlerësimit i përgatitur dhe prezantuar; ekspertët dhanë rekomandime për përmirësim	Mars 2025	Identifikimi i problemeve: numër i pamjaftueshëm rastesh klinike; praktika profesionale ekstrasurorale e pa strukturuar, rezultatet e të nxëniet të lidhen me kompetencat “Day One” të EAEVE
3.1	Krijimi i Grupit të Punës për Reformën e Kurrikulës (Ad-hoc Working Group)	Formimi i një grupi 7-anëtarësh: profesorë të ndryshëm, studentë dhe këshilltarë ndërkombëtarë për të hartuar kurrikulën e re 5.5 vjeçare	Dekanati FMV, Komisioni i Kurrikulës, Rektori	Grup funksional; përgatiti draft kurrikule të integruar dhe strukturë semestrash; shtimi i një semestri për praktika profesionale me zgjedhje dhe me rrotacione klinike	Mars–Maj 2025	Strukturë-first approach; fokusi te kompetencat EAEVE; përfshirë koordinim me partnerë jashtë institucioneve (ferma, thertore, spitalet veterinare)
3.2	Hartimi i draftit të kurrikulës së re dhe alokimi i krediteve	Draftimi i programit 5.5-vjeçar me modul të integruar, përcaktim të orëve për secilën temë, mapping e Day-One Competencies, propozim i sistemit të krediteve sipas procesit Bologna	Grup Punues, Dekanati FMV	Drafti i kurrikulës i përfunduar; mapping kompetencash digjitale; propozim për ristrukturimin e përgjegjësiave dhe infrastrukturës	Maj 2025	Përputhje me 38 Day-One Competences; përfshirë trajnim praktik, laboratorik dhe klinik, si dhe vlerësim të bazuar në kompetenca
3.3	Pilotimi i rrotacioneve klinike dhe bashkëpunimi me partnerët	Nisja e programit pilot të rrotacioneve klinike për studentët në semestrin aktual; sigurimi i bashkëpunimit me fermat, spitalet, thertoret dhe laboratorët	Departamentet, Stafi Akademik, Partnerët e Jashtëm (fermat, spitalet, thertoret dhe laboratorët)	Program pilot aktiv; studentët kanë filluar rrotacionet klinike dhe praktikatat të monitoruara	Tetor 2025	Ndihmon për të testuar sistemin e rrotacioneve, për të mbledhur feedback për kurrikulën e re dhe për të siguruar realizimin e kompetencave praktike

3. PROGRAMET E STUDIMIT NË UBT

3.1 Të dhëna të përgjithshme mbi programet e studimit, që IAL-ja/Njësia baze ka ofruar përgjatë vitit akademik për të cilin raporton, të cilat duhet të shoqërohen me informacionin përkatës për secili program, mbi statusin e tyre përgjatë vitit dhe aktet përkatëse për krijimin, pezullimin ose mbylljen.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 UBT ka zhvilluar procesin mësimor me **6064 studentë** aktivë në **73 programe studimi**, të ciklit të parë të studimeve (Program dy vjeçar profesional, Bachelor), ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional, Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë të studimeve (Master Ekzekutiv dhe Doktoraturë).

Programet e studimit aktivë në UBT sipas cikleve të studimit janë:

7 Programe Profesionale 2 vjeçare, 22 Bachelor, 20 Masteri i Shkencave, 16 Master Profesional, 2 Master Ekzekutiv/Specializim Afatgjatë , 1 DIND dhe 5 Shkolla Doktorature.


Këto Programe e Studimi mbulojnë gjithë spektrin e problematikës që ka sot sektori i prodhimit bujqësor & blegtoral, ai i ushqimit dhe i mjedisit, i bizneseve që operojnë nga sigurimi i inputeve, deri tek shporta e konsumatorit, të niveleve nga 5 deri në 8 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK).

Programet e studimit janë, gjithashtu në përputhje me vizionin:


UBT është qendra e vetme, më ekselente dhe më e madhe e edukimit profesional, universitar, pasuniversitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen e profesionistëve dhe specialistëve të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe të mjedisit, veçanërisht për *prodhimin bimor, prodhimin shtazor; hortikulturë; mbrojtjen bimësh; mekanizimit të bujqësisë, biologji marine dhe akuakulturë; peshkim; menaxhim i burimeve natyrore; ekonominë agrare; politikat bujqësore; zhvillim i integruar rural; menaxhimin e ndërmarrjeve; marketingun; financën & kontabilitetin ; agroturizmin, bioteknologjinë dhe ushqimin; industrinë e pijeve; mbarështimin e pyjeve; industrinë e drurit; mjekësi veterinare & shëndet publik, po mbi të gjitha, të jenë qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.*

Në formatimin e programeve egzistuese por edhe programeve të reja/apo të riorganizura dhe të miratuara gjatë vitit akademik 2024-2025, kanë pasur një ndikim shumë të madh çështjet me interes kombëtar por edhe global si: krizat ushqimore, shumëfishimi i kulturave të ndryshme të të ushqyerit, tendenca e rritjes së prodhimeve bujqësore alternative, perceptimi shumë më ekzigjent që kanë konsumatorët për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve, energjia e rinovueshme, strategjia e gjelër, etj.


Fokusi i çdo fakulteti të UBT-së ka qenë jo vetëm përmirësimi i kurrikulave të studimit por edhe i përmbajtjes së moduleve për ti bërë ato sa më fleksibile në mbështetje të interesit të shoqërisë shqiptare në fushat përkatëse që mbulojnë.



Të dhënat e përgjithshme mbi programet e studimit sipas çdo Njësie kryesore të UBT janë të pasqyruara në: Programet e studimit UBT (Aneksi 1 Exel)



Ecuria e Programeve të Studimit në numër dhe regjistrimeve respektive të studenteve në 4 vitet e fundit, 3 vite Para Reformës dhe në vitin 2025-2026 Pas reformës UBT – BOKU 2030, të realizuar gjatë vitit akademik 2024-2025 për ciklin e parë të studimeve rezulton si më poshtë:



Siç duket qartë edhe në grafik, Oferta e Re Akademike që u realizua gjatë vitit akademik 2024-2025 në kuader të Projektit UBT-BOKU 2030 dhe u aplikua për vitin akademik 2025-2026 ishte e sukseshme. Numri i programeve në Ciklin e Parë të studimeve u përgjysmua, nga 25 programe në 13 programe, të gjitha programet u hapen dhe numri i studenteve ishte me i lartë.

Programet Aktive, Programet e hapura dhe Numri studentëve të regjistruar në Bachelor, sipas fakulteteve

Viti Akademik	2022-2023			2023-2024			2024-2025			2025-2026		
Progra/nr Stud/Njesia Kryesore	Progra aktive	Progra hapura	Numri Student	Progra aktive	Progra hapura	Numri Student	Progra aktive	Progra hapura	Numri Student	Progra aktive	Progra hapura	Numri Student
FEA	6	6	587	6	6	544	6	6	466	4	4	474
FBM	11	6	93	11	9	164	11	7	88	4	4	118
FSHP	3	3	60	4	4	72	4	4	42	2	2	44
FBU	3	3	125	3	3	119	3	2	81	2	1	73
FMV	1	1	96	1	1	100	1	1	70	1	1	65
UBT	24	19	961	25	23	999	25	20	747	13	12	774

Situata e detajuar e programeve të studimit sipas Fakulteteve është pasqyruar në Analizën Mësimore të Njësive Kryesore dhe në mënyre të përmblendhur është pasqyruar më poshtë:

FEA

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) ofron programe studimit të niveleve nga 5 deri në 8 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK). Më poshtë po i paraqesim në mënyrë eksplicite situatën e programeve për vitin akademik 2024-2025 në FEA.

Programet profesionale 2 vjecare (diplomë profesionale) të studimit të zhvilluara gjatë këtij viti akademik 2024-2025 janë:

- Menaxhim Sistemesh Informacioni (MSI)
- Agroturizëm dhe Mikpritje (AM)

Programet e studimeve profesionale janë të organizuara në dy vite akademike me 120 kredite Europiane (ECTS), ata janë aktiv prej vitit akademik 2021-2022, hapur me urdhrat e hapjeve përkatëse nga MAS (tabela 2). Programet i janë nënshtruar procesit të akreditimit bazuar akteve ligjore në fuqi dhe vendimet e BA janë të pasqyruara në tabelën 2.

Bazuar në Strategjinë e UBT – BOKU 2030, si dhe nivelit të studentëve në Programin Profesional 2-vjeçar gjatë vitit akademik 2024-2025, u miratua mbyllja e programit të studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni”.

Programet e studimit të ciklit të parë bachelor të ofruara gjatë vitit akademik 2024-2025 janë:

- Menaxhim Agrobiznesi
- Ekonomiks i Aplikuar
- Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural
- Informatikë Biznesi
- Financë- Kontabilitet
- Menaxhimi i Turizmit Rural

Theksojmë se te gjithë programet e ciklit të parë bachelor janë të akredituar (Aneksi nr.1).

Programet e studimit të ciklit të parë të studimeve realizohen me 180 kredite Europiane (ECTS).

Të gjithë programet kanë qënë aktivë që nga datat e hapjes

Programet e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor të ofruara gjatë vitit akademik 2024-2025 janë pesë dhe më konkretisht:

- Menaxhim Agrobiznesi në profilin "Administrim i Ndërmarrjeve"
- Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare) (riorganizim i programit të studimit të ciklit të dytë master shkencor “Ekonomi dhe Politikat Agrare”), diplomë Duale.
- Financë - Kontabilitet
- Marketingu i Ushqimit Dhe Biznesi Digjital, diplomë Duale
- Informatikë Biznësi

Programi i studimit master i shkencave "Menaxhim Agrobiznesi" profili "Administrim i Ndërmarrjeve" është akredituar me vendim bordi Nr.93 Date 01.11.2019, ai është aktiv prej vitit që ka filluar bazuar udhërit të hapjes në 2008. Ndërkohë për programet e tjera jemi në pritje të axhendes së Akreditimit që duhet të dërgohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional të ofruara gjatë vitit akademik 2024-2025 janë shtatë dhe më konkretisht:

- Menaxhimi i Ndërmarrjeve me profil "Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"
- Ekonomi dhe Politikë Agrare me profil "Ekonomi dhe Politikë Agrare"
- Financë - Bankë
- Kontabilitet - Auditim
- Menaxhimi Informacionit në Agrobiznes
- Menaxhimi i Turizmit Rural.
- Siper marrje dhe Inovacion ne Ekonomi Cirkulare (Diplome e perbashket me LUM University, Itali)

Pjesa më e madhe e programeve te ciklit të dytë master profesional jane akredituar informacioni paraqitet dhe ne tabelen 2. Ndërkohë që për programin Ekonomi dhe Politikë Agrare me profilin "Ekonomi dhe Politikë Agrare" institucioni ka nisur procesin (aplikuar pranë ASCAL) dhe është në pritje të kalendarit të aktiviteteve nga ASCAL. Informacione me te detajuara per programet e studimit jepen ne tabelen 2.

Programet e studimit aktive të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional realizohen me 120 (ETCS) pervec programit “Siper marrje dhe Inovacion ne Ekonomi Cirkulare” i cili realizohet me 60 kredite.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 priti studentët e parë programi i ciklit të dytë të studimit master Profesional në "Sipërmarrje dhe inovacion në ekonomi cirkulare" (në anglisht "Open innovation & youth entrepreneurship in the Mediterranean green sector"). Ky program erdhi si bashkepunim i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (EPZHR), CIHEAM Bari, LUM University dhe CIHEAM SG. Eshte nje program 1 vjecar me 60 kredite. Hapja e programit u miratuar me urdher Nr. 444, Date 22.08.2024 te MAS.

Programet e studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv dhe Doktoraturë

Programet e ciklit të tretë të ofruara nga FEA gjatë vitit akademik 2024-2025 janë:

- Master Ekzekutiv në Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Territorial i Zonave Rurale
- Doktoratë në “Ekonomi dhe Agrobiznes”.

Programi i studimeve i ciklit të tretë master ekzekutiv në “Planifikim dhe zhvillim ekonomik territorial i zonave rurale” u hap për herë të parë në vitin akademik 2020-2021 si produkt i projektit SMART-AL (tabela 2) . Ky program i drejtohet profesionistëve të cilët duan të thellojnë njohuritë e tyre dhe të kontribuojnë në kërkimin shkencor në fushën e Politikave të Zhvillimit Rural dhe Organizimit të Territorit. Programi i studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv realizohen me 120 (ETCS).

Programi i studimeve në Doktoraturë është riorganizuar dhe funksional tashmë në nivel njësie kryesore mbi bazën e një marrveshje midis të gjitha njësive bazë në FEA. Vlen të theksohet se numri i aplikimeve në këtë program si edhe cilësia e aplikantëve ka qenë mjaft e lartë. Deri ne mbyllje te vitit akademik 2023 - 2024, në FEA ishin të regjistruar në këtë program studimi 48 doktorantë. Gjatë vitit akademik 2024 – 2025 u hap thirrja e re (e tretë) e aplikimeve në këtë

program studimi dhe në mbyllje të vitit akademik përfundoi i gjithë procesi. Tashmë numri total i studentëve të regjistruar në programin e ciklit të tretë “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Agrobiznes” është 82.

FBM

Programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) janë të harmonizuara me legjislacionin kombëtar dhe përputhen me interesat zhvillimore të vendit. FBM funksionon si një qendër gjithëpërfshirëse e arsimit profesional, universitar dhe pasuniversitar, duke kombinuar kërkimin shkencor dhe trajnimin praktik për përgatitjen e profesionistëve në fushën e bujqësisë dhe mjedisit. Fakulteti formon specialistë në drejtimet e prodhimit bimor dhe shtazor, hortikulturës, mbrojtjes së bimëve, mekanizimit të bujqësisë, biologjisë detare dhe akuakulturës, peshkimit, si dhe menaxhimit të burimeve natyrore, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në mirëqenien e shoqërisë.

Programet e studimit në FBM janë organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe aktet ligjore, sipas akteve rregullatore të brendshme dhe zbatimi i tyre bëhet në përputhje me përcaktimet e rregulloreve të programeve të studimit. Struktura e programeve të studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) bazohet në ndërtimin e planeve mësimore të detajuara dhe kurrikulave të miratuara për secilin program studimi. Këto programe janë të organizuara në lëndë dhe module, të cilat përcaktojnë ngarkesën mësimore në orë dhe përmbajtjen përkatëse akademike. Çdo modul vlerësohet me kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar transparencë, krahasueshmëri dhe mundësi të lëvizshmërisë akademike për studentët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Programet e studimit në FBM përveç lëndëve që përfshihen në disiplina të formimit karakterizues, përmban edhe lëndë që bëjnë pjesë në disiplina të formimit të përgjithshëm, lëndë të karakterit integruar, lëndë formuese, praktika dhe lëndë me zgjedhje, të cilat i formojnë studentët, por dhe u krijojnë mundësinë atyre të orientohen drejt një kategorie më të gjërë profesionale e specialitetesh brenda fushës së bujqësisë dhe të mjedisit. Programe e studimit në FBM ofrojnë njohuri të reja e bashkëkohore, të cilat lidhen me aspekte teorike e praktike në fushën e bujqësisë dhe mjedisit, bazuar mbi parimet akademike të kësaj fushe dhe të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të FBM6 dhe Rregulloret e programeve të studimit në FBM.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamentet përgjegjëse për zbatimin e programeve të studimit, përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me organizimin, numrin e personelit akademik që ato kanë dhe në lidhje me shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), në funksion të realizimit të programeve të studimit, sigurojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e një numri të mjaftueshëm dhe të kualifikuar të personelit ndihmës mësimor-shkencor për zhvillimin e orëve laboratorike, të cilat janë pjesë integrale e planit mësimor. Ky personel është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike, e të mjediseve të tjera mësimore, si dhe për menaxhimin e teknologjisë së informacionit që përdoret në procesin e mësimdhënies, duke garantuar cilësi dhe funksionim efikas të mësimit praktik.

Mbështetur në natyrën specifike të programeve të studimit, personeli ndihmës mësimor shkencor angazhohet edhe në kryerjen e praktikave mësimore në terren, sipas detajimit të programit mësimor të përcaktuar në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe të përcaktuara në planet kalendare sipas javëve.

Personeli akademik ndihmës mësimor shkencor të departamenteve që janë përfshirë në zbatimin e programeve të studimit, kanë një nivel të kënaqshëm kualifikimi (në pjesën më të madhe të tyre kanë kryer ciklin e dytë të studimeve, Dr, MSc ose MP).

FBU

Viti akademik 2024-2025 ka qënë një vit i rëndësishëm për Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit pasi ka filluar riorganizimi i programeve të studimit, në kuadër të reformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës sipas Universitetit BOKU të Vjenës. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ofron programe studimi, në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e njësive kryesore.

Të gjitha programet e studimit janë aktive përveç një programi studimi: Master Shkencor në Inxhinieri Agroushqimore, drejtimi Vreshtari-Enologji i cili është mbyllur për shkak të mungesës së studentëve. Gjithashtu në kuadër të reformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës sipas modelit të Universitetit BOKU të Vjenës, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, gjatë vitit akademik 2024-2025 është punuar për reformimin e programeve të ciklit të parë të studimit. Gjatë këtij viti akademik nuk është hapur programi "bachelor" i studimit në Inxhinieri Agroushqimore, Profili: Teknologjia e Pijeve Alkoolike dhe Joalkoolike. FBU ofron programe studimesh të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Në tabelën 2 janë paraqitur të gjitha programet studimit që janë aktive ose jo me disa karakteristika në lidhje me vendimin e hapjes, procedurën e akreditimit etj. Në tabelë gjithashtu janë paraqitur programet e studimit të cilat janë akredituar dhe ato që janë në proces akreditimi. Programet e studimit të ofruara nga FBU janë në përputhje me kërkesat e tregut dhe përshaten me misionit dhe objektivat e fakultetit.

FSHP

Gjatë vitit akademik 2024-2025, Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) ka ofruar programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në fushat e **Inxhinierisë Pyjore** dhe **Industriës së Drurit**. Në themel të këtyre programeve ka qënë siguri i një arsimit cilësor dhe bashkëkohor, i orientuar drejt zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shkencore që u mundësojnë studentëve të përballojnë me sukses kërkesat e tregut të punës dhe sfidat e zhvillimit të sektorit të pyjeve, menaxhimit të burimeve natyrore dhe industriës së drurit.

FSHP ka synuar të ofrojë programe të balancuara ndërmjet formimit teorik, praktikave profesionale, kërkimit shkencor dhe trajnimeve të specializuara, duke siguruar harmoni me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe me nevojat reale të industriës.

FMV

Fakulteti përbëhet nga katër Departamente të cilët kontribuojnë së bashku në programet studimit që ofrojmë. Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare programet e studimit janë realizuar duke

respektuar syllabuset dhe planet kalendare, në përputhje me kurrikulat përkatëse. Proçesi mësimor është zhvilluar në nivel të kënaqshëm.

Nga stafi i FMV zhvillohen module edhe në programe të studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit si dhe Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit. Gjatë vitit akademik 2024-2025, të gjithë programet e studimit që FMV ofron ishin aktive.

- Programi i integruar i ciklit të dytë, MSc në Mjekësi veterinarë, është një program aktiv i hapur që në vitin 1952 dhe i akredituar me Vendim e Bordit të Akreditimit Nr. 86, datë 05.10.2019. Ky program është përshtatur sipas Direktivës 2005/36/EC në përputhje me strukturën e Bolonjës dhe me kohëzgjatje normale pesë vite akademike e organizuar me 300 kredite.
- FMV ofron Programin me karakter Profesional 2-vjeçar “Menaxhim Veterinar” e dizajnuar për të trajnuar specialistë me standardet më të larta për të punuar profesionalisht si pjesë e një ekipi veterinar dhe gjithashtu brenda sektorëve të përafërt. Ky është një program me kohëzgjatje normale 2 vite studimi, me 120 kredite. Ky program është aktiv i hapur në vitin 2011 me të MASH, Nr. 208, datë 12.05.2011.
- Gjatë këtij viti ka qenë aktiv edhe Programi i Doktoraturës në Shkenca Veterinare. Ky program është hapur me vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 20 datë 19.06.2009 me emërtimin Doktoraturë në “Mjekësi Veterinare” dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 825, datë 29.7.2009, “Për Hapjen e Programit të Studimeve të Doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe Miratimin e Kuotave dhe të Tarifës për këtë Program”. Programi me emërtimin Doktoratë në “Shkenca Veterinare” është riorganizuar mbështetur në vendimin e senatit Nr. 15, Datë, 21. 04. 2021, vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 20, datë 28.04.2021 dhe Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 505, datë 30.12.2021, “Për Riorganizimin e Programit të Studimeve të Ciklit të Tretë Doktoratë në Shkenca Veterinare” në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Doktorantët që janë në proces kanë realizuar detyrimet dhe raportimet periodike sipas rregullores në fuqi. Nga aplikimet në këtë vit të doktoraturës u shpallën 7 kandidatë fitues, të cilët përbushën detyrimet fillestare dhe pritët të prezantojnë metodikat e kërkimit në fushat respektive.
- Fakulteti ynë, në bashkëpunim me Universitetin e Milanos dhe atë të Portos vazhdojnë zbatimin e projektit të programit specializimi në fushën e Sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik veterinar. Ky program është miratuar për hapje nga MAS (Urdhër Nr. 278, datë 05.06.2024) dhe ë aktiv që prej fillimit të vitit akademik 2024-2025

3.2 Të dhëna mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit aktive, përgjatë vitit akademik në secilin fakultet me misionin e institucionit

FEA

Programet e studimit të FEA-s kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ato synojnë pajisjen me njohuritë bazë mbi shkencat e ekonomisë bujqësore, financave rurale, teknologjisë dhe inovacionin për të siguruar praktikën më të mirë dhe inovative në fushën e bujqësisë dhe agroindustrisë.

Në secilin prej programeve aktive të studimit ka një numër të konsiderueshëm modulesh në funksion të misionit të institucionit, me fokus ekonominë bujqësore, zhvillimin rural dhe bujqësinë digjitale. Programet e studimit të ofruara nga FEA, janë në një pjesë të rëndësishme unike me vlerë strategjike për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e tij afatgjatë. Ato mbështeten në vlerat kombëtare dhe në identifikimin e rrugëve të zhvillimit ekonomik e social të zonave rurale, aktiviteteve të biznesit apo administrimit të burimeve natyrore të përshtatshme me kushtet e Shqipërisë.

Programet e studimit në FEA mishërojnë në mënyrë të qartë profilin e UBT, misionin dhe rolin që ai ka dhe duhet të luajë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore në vend. Ato gjithashtu konsellojnë vlerat më të mira, traditën, historinë e zhvillimit mbi 70-vjeçarë të UBT, të Fakultetit të Ekonomisë Agrare (sot FEA) si edhe synojnë të hipotekojnë me kujdes gjithçka të arritur ndër breza. Kësisoj FEA si edhe vetë UBT mbeten unike në nivel vendi në këtë drejtim.

FSHP

Programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Pyjore (FSHP) janë konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe me nevojat strategjike të sektorëve pyjorë, mjedisorë dhe të industrisë së drurit në Shqipëri. Çdo program ka objektiva të qarta formuese, që synojnë pajisjen e studentëve me dije teorike, aftësi praktike dhe kompetenca profesionale e analitike, të domosdoshme për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ekonomisë së gjelbër.

Programe të ndryshme të ciklit të parë dhe të dytë integrojnë module që mbështesin direkt misionin akademik dhe kërkimor të institucionit, duke u fokusuar në:

- shkencat pyjore,
- menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve dhe zonave të mbrojtura,
- konservimin e natyrës dhe biodiversitetit,
- teknologjinë dhe inovacionin në përpunimin e drurit,
- përdorimin efikas të burimeve natyrore,
- zhvillimin rural dhe ekonomik në sektorët pyjorë dhe industrialë.

Përmes këtyre moduleve, programet kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve dhe sigurojnë përputhshmëri me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe me prioritetet kombëtare për mjedisin, klimat dhe ekonominë e qëndrueshme.

Programet aktive të FSHP janë një komponent i rëndësishëm i ofertës universitare të UBT-së, pasi adresojnë nevojat e një sektori të specializuar dhe strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit. Fakulteti mbetet institucioni i vetëm në nivel kombëtar që ofron formim të plotë akademik në shkencat pyjore dhe industrinë e drurit, duke e bërë këtë profil të pazëvendësueshëm dhe në përputhje me rolin historik dhe identitetin e UBT-së.

Gjithashtu, programet e studimit ruajnë dhe promovojnë traditën e gjatë 72-vjeçare të Fakultetit të Shkencave Pyjore si një njësi themelore e UBT-së, duke mbështetur vazhdimësinë e ekspertizës, profesionalizmit dhe kontributit të tij në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, mjedisit dhe industrive natyrore në Shqipëri. Në këtë mënyrë, FSHP siguron që formimi akademik i studentëve të jetë në funksion të misionit institucional dhe të vlerave themelore universitare.

FMV

Të dhëna mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit aktive, përgjatë vitit akademik në secilin fakultet me misionin e institucionit;

Edhe gjatë vitit akademik 2023-2024, para fillimit të procesit mësimor nga stafi akademik i FMV u rishikuan dhe ripunuan nga titullarët e lëndëve syllabuset e disa moduleve, ku titullarët përkatës pas diskutimeve në GMK, vlerësuan të nevojshëm përditësimin e informacioneve. Syllabuset janë diskutuar dhe miratuar në Departamente, janë firmosur dhe vulosur në Dekanat, si dhe janë të depozituara elektronikisht dhe të printuara në Departament dhe në Dekanat. Përgatitja e tyre, në shqip dhe në anglisht, u bazuan në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe udhëzimet e ardhura nga Rektorati i UBT.

Bazuar në programet e lëndëve janë hartuar edhe planet mësimore. Këto plane mësimore u përgatitën në kohë, para fillimit të semestrave, dhe u dorëzuan në Departament. Të gjitha temat e leksioneve dhe të praktikave mësimore janë të pasqyruara në planet kalendare përkatëse të përgatitura me fillimin e vitit akademik.

Edhe pse FMV aktualisht nuk ofron një program në gjuhë të huaj, në kuadër të ndërkombëtarizimit, një pjesë të lëndëve të programit të studimit Mjekësi Veterinare ofrohen edhe në gjuhën angleze. Deri më tani kjo është shfrytëzuar vetëm me studentët që kanë ardhur në FMV në kuadër të programit ERASMUS.

FBM

Programet e studimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës janë të harmonizuara me legjislacionin kombëtar dhe pasqyrojnë respektimin e interesave të vendit, të cilat reflektohen qartë në misionin dhe vizionin e universitetit. Kjo përcaktohet dhe formalizohet edhe përmes dokumenteve bazë të vetëqeverisjes së institucionit, si Statuti i UBT-së dhe Rregullorja e Studimeve Universitare.

Programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) janë në përputhje me misionin e institucioneve publike të arsimit të lartë në Shqipëri dhe nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare. Në përputhje me misionin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, FBM luan një rol thelbësor në të katër dimensionet kryesore të një fakulteti modern: transmeton dijen tek studentët përmes metodave pedagogjike bashkëkohore; krijon dijen përmes kërkimit shkencor dhe e integron atë në përmirësimin e procesit mësimor; kontribuon në zgjidhjen e sfidave kombëtare në fushën e bujqësisë dhe mjedisit duke aplikuar rezultatet e kërkimit shkencor; dhe përpaket që profesionistët e rinj të diplomuar në FBM të jenë jo vetëm ekspertë të aftë, por edhe qytetarë të përgjegjshëm dhe të denjë të komunitetit evropian.

Programi mësimor pasqyron mbështetjen e vlerave dhe interesave kombëtare dhe nxit ruajtjen dhe pasurimin e tyre. Programet e studimit të ofruara në FBM janë strukturuar sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilet e programeve në FBM. Lëndët dhe modulet e përfshira në një program studimi në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), si dhe emërtimi i tyre, janë të përshtatura me drejtimin dhe profilin e studimit për të tre ciklet e arsimit të lartë. Ngarkesa mësimore e programit, e shprehur në orë dhe kredite (ECTS), respekton përcaktimet ligjore për secilin cikël studimi dhe harmonizohet me praktikën dhe programet e ngjashme ndërkombëtare, duke garantuar krahasueshmëri dhe standarde të njohura globalisht.

Nga analizat vjetore e periodike të punës mësimore të bëra në departamentet e FBM-së, **rezulton se programet kanë një ngarkesë të plotë mësimore dhe raport të ekuilibruar teori - praktikë** e cila është në përputhje me profilin e programit të caktuar dhe krijon mundësi profilizimi të studentëve në fushën e bujqësisë dhe mjedisit.

Programet e studimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës janë të harmonizuara me legjislacionin kombëtar dhe pasqyrojnë respektimin e interesave të vendit, të cilat reflektohen qartë në misionin dhe vizionin e universitetit. Kjo përcaktohet dhe formalizohet edhe përmes dokumenteve bazë të vetëqeverisjes së institucionit, si Statuti i UBT-së dhe Rregullorja e Studimeve Universitare.

Programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) janë në përputhje me misionin e institucioneve publike të arsimit të lartë në Shqipëri dhe nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare. Në përputhje me misionin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, FBM luan një rol thelbësor në të katër dimensionet kryesore të një fakulteti modern: transmeton dijen tek studentët përmes metodave pedagogjike bashkëkohore; krijon dijen përmes kërkimit shkencor dhe e integron atë në përmirësimin e procesit mësimor; kontribuon në zgjidhjen e sfidave kombëtare në fushën e bujqësisë dhe mjedisit duke aplikuar rezultatet e kërkimit shkencor; dhe përpaket që profesionistët e rinj të diplomuar në FBM të jenë jo vetëm ekspertë të aftë, por edhe qytetarë të përgjegjshëm dhe të denjë të komunitetit evropian.

Programi mësimor pasqyron mbështetjen e vlerave dhe interesave kombëtare dhe nxit ruajtjen dhe pasurimin e tyre. Programet e studimit të ofruara në FBM janë strukturuar sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilet e programeve në FBM. Lëndët dhe modulet e përfshira në një program studimi në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), si dhe

emërtimi i tyre, janë të përshtatura me drejtimin dhe profilin e studimit për të tre ciklet e arsimit të lartë. Ngarkesa mësimore e programit, e shprehur në orë dhe kredite (ECTS), respekton përcaktimet ligjore për secilin cikël studimi dhe harmonizohet me praktikën dhe programet e ngjashme ndërkombëtare, duke garantuar krahasueshmëri dhe standarde të njohura globalisht. Nga analizat vjetore e periodike të punës mësimore të bëra në departamentet e FBM-së, **rezultoni se programet kanë një ngarkesë të plotë mësimore dhe raport të ekuilibruar teori - praktikë** e cila është në përputhje me profilin e programit të caktuar dhe krijon mundësi profilizimi të studentëve në fushën e bujqësisë dhe mjedisit.

FBU nuk ka informacion të detajuar

3.3 Të dhëna për realizimin e synimeve të programeve të studimit nga ana e përmbajtjes

FBM

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, së bashku me departamentet përbërëse, është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit në të tre ciklet akademike dhe disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tyre. Ky informacion pasqyrohet në Rregulloret e Brendshme të FBM dhe në Rregulloret specifike të programeve të studimit. Programet përfshijnë të dhëna të detajuara mbi lëndët (syllabuset), praktikën, seminarët, orët laboratorike dhe të gjithë komponentët e tjerë formues të programit, brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara. Programet e studimit në FBM janë në një proces përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, dhe çdo vit akademik shfrytëzohet si mundësi për rishikim dhe optimizim të tyre.

Në fillim të çdo viti akademik janë konsideruar dhe marrë në shqyrtim të gjitha propozimet për ndryshimet e mundshme të kurrikulave të studimeve, në përputhje me zhvillimet aktuale. Propozimet për ndryshimin e kurrikulave i janë nënshtruar procedurave përkatëse ligjore për ndryshimin e kurrikulës. Ndryshimet e bëra në kurrikulën e studimeve, pas miratimit janë reflektuar në të gjithë elementët e dosjes së programit të studimit të caktuar.

FEA

Struktura kurrikulare e programeve të studimit reflekton qartë kompetencat e kërkuara por edhe modelet më të mira të ngjashme në universitetet dhe kurrikulat perendimore. Për të arritur objektivat e programeve të studimit, zhvillimi teorik dhe praktik i studentëve është në fokus të përmbajtjes së këtyre programeve. Gjatë hartimit të tyre i jepet rëndësi edhe praktikës profesionale të studentëve me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për nevojat e tregut të punës.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së njohurive, janë bërë disa ndryshime cilësore në syllabuset e mëparshme, kjo në sajë të përvojës në mësimdhënie të stafit dhe kërkesave të tregut. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë zhvillimet e shpejta të kohës në ekonomi, bujqësi, zhvillim rural dhe teknologji, u rishikuan syllabus-et ekzistuese, kryesisht në lidhje me përmirësimin e temave si dhe rifreskimin e literaturës referuar 5 viteve të fundit. Gjykojmë që përmbajtja e programeve të

studimit që zhvillohen sot në FEA është në koherencë të plotë me zhvillimet në arsimin e lartë ndërkombtarisht si edhe dinamikat e brendëshme gjithashtu.

FMV

Programet e lëndëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare (FMV) janë konceptuar për të mbështetur qëllimin kryesor të programit të studimit në Mjekësi Veterinare, duke ofruar një kombinim të fortë të njohurive teorike dhe aftësive praktike. Lëndët zhvillohen në një vijimësi progresive, ku studentët kalojnë nga konceptet bazë dhe metodologjitë fillestare drejt lëndëve më komplekse dhe specializuara, me synimin për t'i përgatitur ata si profesionistë kompetentë. Në përgjithësi, syllabuset janë të përputhshme me standardet EAEVE, mbulojnë të gjitha fushat kryesore të mjekësisë veterinarë, përfshirë anatominë, fiziologjinë, patologjinë, klinikën, shëndetin e kafshëve, publik dhe sigurinë ushqimore, dhe përdorin materiale didaktike të pasura, përfshirë prezantime, video demonstrative dhe skenarë klinikë, që mbështesin mësimin vizual dhe praktik. Rritja e praktikave laboratorike dhe klinike ka mundësuar zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe realizimin e kompetencave “Day One” të EAEVE.

Megjithatë, ende ekzistojnë sfida që duhen adresuar për të përmirësuar plotësisht realizimin e synimeve të programeve. Në disa lëndë, praktika e drejtpërdrejtë është e kufizuar, gjë që redukton ekspozimin praktik të studentëve. Një pjesë e syllabuseve është ende e fokusuar kryesisht në teorinë klasike dhe nuk ofron mjaft raste klinike reale ose shembuj praktikë bashkëkohorë, ndërkohë që integrimi ndërdisiplinor midis lëndëve, si lidhja mes patologjisë, klinikës dhe shëndetit publik, mund të forcohet për të dhënë një kuptim më të plotë dhe holistik të profesionit veterinar. Përdorimi i mjeteve digjitale, platformave të e-learning dhe simulimeve klinike është gjithashtu në fazë fillestare dhe duhet zgjeruar për të mbështetur mësimin modern dhe të bazuar në kompetenca.

Synimi për të ardhmen është që programet e lëndëve të zhvillohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë një ekuilibër të fortë midis teorisë dhe praktikës, duke zgjeruar ekspozimin praktik në të gjitha lëndët kyçe, duke integruar më shumë raste klinike dhe projekte ndërdisiplinore, si dhe duke përdorur në mënyrë efektive teknologjitë moderne për të mbështetur mësimin dhe zhvillimin e aftësive profesionale që kërkon tregu i punës dhe standardet ndërkombëtare. Me këto përmirësime, programet do të mund të garantojnë formimin e plotë të mjekëve veterinarë profesionistë dhe përgatitjen e tyre për sfidat reale të profesionit

FSHP

Struktura e kurrikulave të programeve të studimit të FSHP pasqyron qartë kompetencat e kërkuara profesionale, shkencore dhe praktike, duke u bazuar në modelet më bashkëkohore të universiteteve dhe kurrikulave perëndimore. Përmbajtja e programeve është ndërtuar në mënyrë që të sigurojë një ndërthurje të balancuar midis formimit teorik dhe zhvillimit praktik, me synimin kryesor përgatitjen e specialistëve të aftë për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe sfidave të sektorëve pyjorë, mjedisorë dhe të industrisë së drurit.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar komponentit të praktikave profesionale, të cilat janë integruar në programet e studimit me qëllim forcimin e aftësive praktike, teknike dhe menaxheriale

të studentëve. Përmes këtyre praktikave, studentët ekspozohen ndaj metodave të punës në terren, teknologjive bashkëkohore dhe proceseve të menaxhimit të burimeve natyrore, duke krijuar një bazë solide për punësimin e tyre.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së njohurive dhe të përmbajtjes akademike, gjatë vitit akademik 2024-2025 janë realizuar përditësime cilësore në syllabus-et ekzistuese. Këto ndryshime janë bërë duke u mbështetur në përvojën pedagogjike të stafit akademik, rekomandimet e studentëve, si dhe kërkesat dhe zhvillimet e tregut të punës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. U rishikuan temat kryesore të lëndëve, u zgjeruan përmbajtjet praktike dhe u rifreskua literatura bazë dhe ndihmëse duke iu referuar burimeve të 5 viteve të fundit, në përputhje me standardet e akreditimit.

Vlerësohet se përmbajtja aktuale e programeve të studimit të FSHP është e krahasueshme me atë të universiteteve më të mira europiane, veçanërisht me universitetet gjermane dhe austriake në fushën e shkencave pyjore dhe industrisë së drurit. Ndryshimet e realizuara gjatë viteve të fundit kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë akademike, koherencën tematike dhe shkallën e përafrimit me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke e pozicionuar fakultetin në një nivel më të lartë konkurrueshmërie akademike dhe profesionale.

FBU nuk ka informacion të detajuar.

3.4 Të dhëna mbi kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga njësia kryesore e IAL-së dhe një vlerësim i tyre.

FBM

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ndjek me kujdes dinamikën e zhvillimit të biznesit në vend, duke i monitoruar vazhdimisht dhe duke orientuar në bazë të tyre programet e studimit. Në nivel universiteti, pjesë e strukturës organizative është Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS), e cila funksionon pranë fakulteteve dhe ofron shërbime për informimin dhe orientimin e studentëve, që nga regjistrimi deri pas diplomimit, duke i ndihmuar ata në përgatitjen për tregun e punës. Si pjesë e strukturave mbështetëse është ngritur dhe funksionon edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila ka si qëllim kryesor mbështetjen dhe orientimin e studentëve në zhvillimin e karrierës së tyre. Një detyrë funksionale e QKA-së është gjithashtu evidentimi i të dhënave për studentët e viteve të fundit dhe gjurmimi i tyre në lidhje me ecurinë e punësimit pas diplomimit. QKA organizon Panairin e Karrierës në UBT, me qëllim përafrimin e ofertës dhe kërkesës për punësim të studentëve të diplomuar. Ai organizohet në mjediset e UBT-së, ku ftohen dhe marrin pjesë biznese të fushës së bujqësisë dhe mjedisit (agrobiznesit), por jo vetëm. Në lidhje me këtë aspekt, edhe programet e studimit në FBM, i shërbejnë jo vetëm formimit të specialistëve dhe kërkuesve me dije, njohuri e kompetenca profesionale në fushën e bujqësisë dhe mjedisit por i shërben edhe plotësimit të nevojave të tregut të punës në këto fusha.

Përmes hartimit të politikave të synuara, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit kanë ndërmarrë dhe organizuar aktivitete që synojnë afrimin e studentëve me tregun e punës, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike dhe sektorin privat të biznesit.

Programet e studimit në FBM kanë objektiva të qarta për formimin e studentëve, duke përcaktuar dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit dhe që karakterizojnë profilin e tij. Objektivat e programeve përfshijnë të tre dimensionet kryesore të veprimtarisë akademike: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive dhe shërbimeve drejt shoqërisë dhe ekonomisë.

Ato synojnë dhe janë të orientuara në: paisjen e studentëve me dijet e nevojshme profesionale në fushën e bujqësisë dhe mjedisit; përgatitja e specialistëve dhe kërkuesve të aftë për të kontribuar në menaxhimin e qendrueshëm të mjedisit; të ofrojnë dije bashkëkohore në përgjigje të problematikave aktuale në sektorin e bujqësisë dhe mjedisit; të formojë specialistë të kualifikuar dhe të aftë për tregun e punës brënda dhe jashtë vëndit.

Këto objektiva pasqyrohen në Rregulloret e programeve të studimit dhe shpjegohen në detaje në syllabuset e lëndëve dhe moduleve që përbëjnë secilin program studimi. Objektivat, të përfshira gjithashtu në fillim të çdo syllabusi, përmbajnë informacion të plotë mbi dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programeve të studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit.

FEA

Qendra e Karrierës dhe Alumni si një njësi që luan rolin e ndërmjetësit midis njësive bazë/ kryesore dhe tregut të punës funksionon jo vetëm për të lehtësuar procesin e kalimit të studentëve në tregun e punës, por edhe për të mbledhur informacion në lidhje me ecurinë e tyre. Një nga funksionet e Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA) në nivel institucional, është të gjurmojë ecurinë e studentëve të UBT-së në këtë treg, mbasi ata përfundojnë studimet dhe diplomohen.

Ekonomia Bujqësore ka qenë tradicionalisht një nga sektorët më dominues me një potencial të lartë zhvillimi në vendin tonë, duke punësuar një pjesë të konsiderueshme të popullsisë dhe duke kontribuar në PBB-në e vëndit. Kontributi i sektorit të bujqësisë edhe pse ka rënë në vitet e fundit prapëse prapëse peshe të rëndësishme në PBB e vëndit. Agroturizmi si nënsektor është gjithashtu një pikë e fortë e ekonomisë, duke synuar jo vetëm zhvillimin e ekonomisë lokale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma, por edhe mirëpritjen e turistëve, me interes të shtuar për të njohur Shqipërinë dhe shijuar produktet tipike të vëndit. https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/AIDA_FactSheet_Agro2024.pdf

Po kështu, rritja e interesit për reduktimin e ndikimit mjedisor të miratuar në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane (Bashkimi Evropian, 2020) dhe Axfhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, përcakton rekomandime konkrete për 1) Përafrimin e rajonit me ambicien e BE-së për vitin 2050 për ta bërë kontinentin Evropian neutral ndaj karbonit. 2) Aktivizimi/shfrytëzimi i potencialit të ekonomisë cirkulare, 3) Reduktimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, 4) Promovimi i qëndrueshmërisë në prodhim dhe furnizim me ushqim, dhe 5) Shfrytëzimi i potencialit të madh turistik të rajonit, duke u fokusuar në mbrojtjen e biodiversitetit dhe restaurimin e ekosistemeve. Konteksti politik i lartpërmendur paraqet sfida të reja për vëndin dhe kërkon kompetenca të reja

në mënyrë që hendeuku midis kompetencave të ofruara dhe atyre të nevojitura të reduktohet, hendeu i cili krijon papunësi të rinjtë.

Këto zhvillime padyshim kanë krijuar premisa të forta për një nevojë në rritje për kapital human, për kapacitete menaxheriale dhe profesionistë të aftë për të menaxhuar dhe cuar përpara.

Nga analiza e bërë, rezulton se interesi kryesor për kompetencat profesionale në programet e studimit që ofron FEA (kryesisht të menaxhimit dhe financës) vjen nga aktorët e Sistemit të Agrobiznesit, (Sektori i prodhimit në fermave; në veçanti fermat komercilae dhe të specializuara, aktorë në sektorin e agroindustrisë; numri i të cilëve në vitet e fundit është rritur ndjeshëm, si edhe ato të sketorit të prodhimit dhe tregëtimit të inputeve.

Gjithashtu një interes në rritje për kompetencat që ofron fakulteti ynë vjen edhe nga institucionet publike (p.sh. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe institucionet e varësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore si dhe Institucionet në nivel vendor/Bashkitë) por edhe atyre private si Bankat/institucionet financiare, Kompanitë e Konsulencës, Projektet e Zhvillimit pa përjashtuar edhe agrobiznese të cilat mund të jenë të interesuara për profilet që ofron departamenti. Gjithashtu, në kontekstin e procesit të integrimit në BE dhe nevojën për të ndjekur praktikatat më të mira botërore pritet që kërkesa për këto kompetenca të rritet në institucionet publike. Teksa është e vështirë të bëhet një parashikim i saktë i rritjes së nevojës për këto kompetenca në kuadrin e integrimit në BE (sepse edhe vetë dinamika e integrimit është e vështirë që të parashikohet), mund të vlerësohet që nevoja për punësim përgjatë kësaj dekade mund të jetë rreth dyqind- treqind specialistë.

Konsideruar programet e ofruara nga FEA që lidhen me politikat e zhvillimit rural, një vend të rëndësishëm zënë gjithashtu edhe interesat për profesionistë që mbulojnë fushat e FEA-s në nivel institucionesh publike (p.sh. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe institucionet e varësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore si dhe Institucionet në nivel vendor/bashkitë) etj. Gjithashtu, në kontekstin e procesit të integrimit në BE dhe nevojën për të ndjekur praktikatat më të mira botërore si edhe rritjen e vazhdueshme dhe uljen e informalitetit, pritet që kërkesa për këto kompetenca të rritet në vijimësi. Po kështu operatorët e fushës së teknologjive digjitale, kompanitë e konsulencës, apo ata aktorë që janë të përfshirë në projektet e zhvillimit janë sot punëdhënës me mjaft interes për të diplomuarit tane.

Shqipëria gjithashtu ka bërë përparim të konsiderueshëm në transformimin e saj dixhital, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të platformës e-Albania dhe Axiendës Dixhitale të Qeverisë Shqiptare 2022-2026, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm ofrimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturën dixhitale. Megjithatë, pavarësisht këtyre arritjeve, vendi ende përballë me sfida në përmirësimin e gatishmërisë së tij për AI dhe ruajtjen e avancimeve konkurruese në teknologji dhe shërbimet dixhitale.

Në përfundim theksojmë se të diplomuarit tanë do të përgatiten të luajnë role të ndryshme në këtë mjedis dinamik si: menaxher, konsulent biznesi, financier, menaxher sistemesh informacioni në biznese dhe institucione të ndryshme financiare, programues, kërkues tregu në sistemin e

agrobiznesit, specialist në institucione dhe organizatat të hartimit dhe implementimit të politikave të zhvillimit rural, si ekonomist gjithashtu në kompani të tjera vendase apo të huaja, në organizata kombëtare apo ato ndërkombëtare, administratë qendrore dhe lokale, sektorin bankar, apo të punojnë si kërkues për zhvillimin dhe lançimin e produkteve të reja.

Në ditët e sotme dinamika e zhvillimit të profesioneve ka qenë e jashtëzakonshme. Kësisoj si rezultat i zhvillimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe shndërrimit të saj në një instrument transformues për bizneset dhe pse jo edhe një avantazh krahasues në një mjedis mjaft kompetitiv, aktorët e tregut po dëshmojnë gjithnjë dhe më tepër një “uri të dukshme” për profesionet e lidhura me përdorimin e teknologjisë. Vlen për tu theksuar se numri i ndërmarrjeve që operojnë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit sa vjen dhe rritet nga viti në vit.

Sipas publikimit të INSTAT “**Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2025**”, Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar që kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune gjatë vitit 2025, përfaqësojnë 99,4 % të ndërmarrjeve, nga 99,3 % që rezultuan në vitin 2024. Gjatë vitit 2025, përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është 31,8 %, nga 29,7 % që rezultoi në vitin 2024. Përqindja më e lartë e të punësuarve që përdorin kompjuter me akses në internet vërehet në aktivitetin e Informacionit dhe Komunikimit me 79,7 %, e ndjekur nga aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe Teknike me 70,3 % dhe Shërbimet Administrative dhe Mbështetëse me 65,4 %.

Në vitin 2025, 28,0 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve, duke shënuar një rritje prej 3,5 %, krahasuar me vitin 2024. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor me 48,2 %, pasuar nga aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe Teknike me 44,8 % dhe aktivitetet e Informacionit dhe Komunikimit me 43,3%. Gjatë vitit 2025 vlera e xhiros së realizuar nga shitjet online rezultoi 10,1 % duke pësuar një rritje prej 0,6 %, në krahasim me vitin 2024. Peshën më të madhe të xhiros së realizuar e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e Tregtisë me shumicë dhe pakicë me 46,1 % dhe aktivitetet e Informacionit dhe Komunikimit me 16,5 %.

Në vitin 2025, shërbimet cloud të cilat i referohen shërbimeve që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj janë përdorur nga 33,8 % e ndërmarrjeve që kanë akses në internet. Krahasuar me vitin 2024, përdorimi i shërbimeve cloud në ndërmarrjet që kanë akses në internet, ka shënuar 3,8% rritje. Media sociale (Facebook, LinkedIn, Tëiter, Youtube, Pinterest etj.) është përdorur nga 86,5 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, nga 83,1 % që rezultoi në vitin 2024, duke rritur kërkesën për specialistë të fushës.

Duke marrë parasysh të dhënat e mësipërme, kërkesën në zhvillim në sektorin e bujqësisë për shërbimet TIK si dhe tendencat e në rritje të përdorimit të TIK në sektorët e tjerë, kërkesa dhe oferta për mundësi punësimi për studentët e diplomuar në programet e ofruara nga DMI, është gjithnjë në rritje.

Sipas të dhënave të gjurmimit për të diplomuarit e vitit akademik 2024-2025 në programet e Universitetit Bujqësor të Tiranës, rreth 37% e studentëve janë të punësuar pas diplomimit, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbetet e papunë ose e padeklaruar

FMV

Sipas analizave dhe të dhënave të grumbulluara, aktualisht ka një nevojë të konsiderueshme për veterinerë në sektorin publik dhe privat, veçanërisht në fushat e mjekësisë së kafshëve të fermës, shëndetit publik veterinar dhe sigurisë ushqimore. Në institucionet shtetërore si AKU, AKVMB dhe FSVI, aktualisht ka mbi 900 profesionistë aktivë, por pozicione të paplotësuara ekzistojnë ende në disa rajone, duke reflektuar një kërkesë të vazhdueshme për specialistë.

Sipas pyetësorit të realizuar në vitin akademik 2024–2025, mbi 82% e pjesëmarrësve identifikuan mungesën e aftësive praktike dhe klinike si sfidën kryesore për të diplomuarit, ndërsa 56% vunë në dukje strukturën e paqartë të praktikave si një pengesë. Sektori më i prekshëm nga mungesa e profesionistëve është mjekësia e kafshëve të fermës (~68%), pasuar nga siguria ushqimore, shëndeti publik veterinar dhe diagnostika laboratorike (~35–50%). Përkundër kësaj, mungesa e veterinerëve për kafshët shoqëruese është më e vogël (~17%).

Në pjesën private të tregut, ka një tendencë në rritje të hapjes së klinikave dhe spitaleve të specializuara për kafshë shoqëruese, sidomos në qytetet kryesore, duke krijuar mundësi të konsiderueshme punësimi për të diplomuarit. Aktualisht ekzistojnë 71 klinika veterinare dhe 143 farmaci veterinare të licensuara (burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit), të cilat kërkojnë staf të kualifikuar, veçanërisht me njohuri në diagnostikë, mjekësi të kafshëve të fermës, shëndet publik dhe sigurinë ushqimore.

Rezultatet e pyetësorit tregojnë gjithashtu një nevojë të madhe për ekspertë të rinj në fushat e shëndetit public veterinar, epidemiologji ushqimore, mjekësi preventive dhe menaxhim të fermave, veçanërisht gjatë 1–3 viteve të ardhshme (~50–60%). Shtimi i stafit akademik do të jetë i nevojshëm, pasi rreth 20% e personelit aktual pritet të dalë në pension në dekadën e ardhshme, duke krijuar nevoja për profesorë dhe trajnerë në të gjitha disiplinat kryesore të mjekësisë veterinare.

Nga ana e përmbajtjes së kurrikulës, pyetësori nxorri në pah se duhet të përforcohet trajnimi në diagnostikë laboratorike, patologji, lëndë të kafshëve të fermës, siguri ushqimore, higjienë dhe bio-siguri, si dhe praktika e strukturuar për të gjitha speciet. Rekomandimi më i përhapur ishte vendosja e praktikave të detyrueshme dhe të monitoruara çdo vit, krijimi i një klinike mobile për terrenin, dhe sigurimi i logbook-eve dhe testimeve OSCE për çdo vit studimi. Kjo do të përmirësojë përputhshmërinë me kompetencat “Day One” të EAEVE dhe do të adresojë boshllëqet aktuale në tregun e punës.

Në përfundim, tregu i punës për veterinerët në Shqipëri ofron mundësi të gjera punësimi, sidomos në fushat e mjekësisë së kafshëve të fermës, diagnostikës dhe sigurisë ushqimore. Sidoqoftë, ekziston një nevojë urgjente për përmirësim të praktikës së strukturuar, rritje të aftësive klinike dhe laboratorike të të diplomuarve, si dhe zgjerim të stafit akademik për të përmbushur kërkesat e tregut dhe standardet ndërkombëtare të EAEVE. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e

përmirësimit të programit të studimit në përputhje me nevojat reale të profesionit dhe kërkesat e punësimit.

FSHP

Tregu i punës për të diplomuarit nga Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) karakterizohet nga një kombinim i mundësive të rëndësishme të punësimit dhe sfidave strukturore të sektorit pyjor, mjedisor dhe agroindustrial në Shqipëri. Ky treg është ndikuar nga zhvillimet ekonomike, prioritetet kombëtare për mjedisin dhe bujqësinë, si dhe nga orientimet e vendit drejt standardeve të Bashkimit Evropian.

Kërkesa në tregun e punës

Rritje e kërkesës për profesionistë në shkencat pyjore dhe mjedisore

- Vihet re një kërkesë në rritje për specialistë të kualifikuar në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, ruajtjen e biodiversitetit dhe rehabilitimin e ekosistemeve. Ky trend lidhet ngushtë me:
 - angazhimet kombëtare për përafrim me legjislacionin mjedisor të BE-së,
 - nevojën për administrim më efikas të zonave të mbrojtura,
 - prioritetet e ekonomisë së gjelbër dhe menaxhimin e ndryshimeve klimatike
- Kërkesw e lartë në sektorin e produkteve pyjore jo-drusore (PPJD)

Sektori i PPJD-ve, që punëson rreth **76,000** persona, paraqet mundësi të rëndësishme për të diplomuarit e FSHP. Rritja e tregut për bimë mjekësore e aromatike ka intensifikuar kërkesën për:

- ekspertë në sektorin pyjor,
- specialistë për kultivimin dhe standardizimin e PPJD-ve,
- profesionistë në gjurmueshmëri, cilësi dhe zhvillim rural

Kalimi gradual nga mbledhja e produktit të egër drejt kultivimit të qëndrueshëm rrit nevojën për profilin pyjor–agronomik.

Profesionistë për zhvillim të qëndrueshëm dhe ekonomi të gjelbër

Me rritjen e projekteve kombëtare e ndërkombëtare për:

- zbutjen e ndikimeve klimatike,
- restaurimin ekologjik,
- pyllëzimet, rimbjelljet
- reduktimin e riskut nga zjarret,

Kërkohet një brez i ri specialistësh të aftë të aplikojnë praktika moderne dhe teknologji të avancuara.

Oferta në tregun e punës

Sfida të punësimit për të diplomuarit

Megjithëse ekziston kërkesë për profesionistë në pylltari dhe mjedis, oferta e të diplomuarve nuk përputhet gjithmonë në mënyrë optimale me kërkesën e tregut.

Disa nga arsyet përfshijnë:

- mospërputhje midis formimit akademik dhe kërkesave praktike të tregut,
- mungesë e praktikave të thelluara profesionale në disa programe,
- vështirësi pune në zonat rurale, ku shpesh kërkohet prezenca fizike e specialistëve.

Ky fenomen shoqërohet shpesh edhe me uljen graduale të regjistrimeve në disa programe pyjore, për arsye demografike dhe faktorë të lidhur me perceptimin e profesionit.

Mungesa e kandidaturave nga shkollat profesionale

Numri i vogël i të rinjve që ndjekin shkollat profesionale në profilin e pyjeve, mjedisit dhe drurit krijon mungesë të punonjësve të gatshëm dhe të trajnuar për tregun e punës. Kjo ndikon:

- cilësinë e stafit teknik në ndërmarrje,
- kapacitetin e industrisë për të absorbuar teknologji moderne,
- vonesa në adaptimin e praktikave të qëndrueshme.

Vlerësim i përgjithshëm

Mqs programet e FSHP-së vazhdojnë të përshtaten me nevojat e tregut, të modernizojnë kurrikulat dhe të rrisin përbërësit praktikë e profesional:

- potenciali i punësimit të të diplomuarve do të rritet ndjeshëm,
- nevojat e sektorëve pyjor, mjedisor dhe të drurit do të përmbushen më mirë,
- institucionet publike dhe private do të kompletohen me profesionistë të aftë dhe të certifikuar.

FSHP është në një pozicion strategjik për të marrë një rol udhëheqës në përgatitjen e forcës së punës për ekonominë e qëndrueshme të vendit, përmes:


- përshtatjes së kurrikulave,
- zgjerimit të marrëveshjeve me industrinë dhe institucionet publike,
- forcimit të praktikave profesionale,
- integritit të teknologjive bashkëkohore (GIS, dronë, CAD/CAM druri, analiza ekologjike),
- bashkëpunimit me projektet e BE-së, FAO, UNDP dhe partnerë të tjerë.

FBU nuk kanë dhënë informacion.

PROCESI MËSIMOR

4.1 Të dhëna mbi plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, dhe raportin e tyre me situatën aktuale në IAL

Bazuar në dhënat e fakulteteve, situata e plotësimit të standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore rezulton:



Referuar Normës së sipërfaqes minimale të shfrytëzueshme sipas Kodit të Cilësisë në IAL (2021) 3.8 m² /student situata në UBT për vitin akademik 2024-2025 të gjithë Njësitë Kryesore plotësojnë Standartin e cilësisë.

Për të realizuar një vlerësim sa më të saktë të plotësimit të standarteve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, situata e detajuar sipas Njësiteve Kryesore paraqitet si më poshtë:

FEA

Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit e ushtron veprimtarinë e tij në dy godina brenda Kampusit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Godina dykatëshe (A) e vitit 1957 dhe godina pesëkatëshe (B) e vitit 2010. Të dy godinat janë të lidhura në nivelin e katit të dytë, me korridore nga të dy krahët. Sipërfaqja totale e shfrytëzueshme për studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit është 11541m². Hapësira normative e shfrytëzueshme për m²/student në FEA është 3.9 m²/studentë (tabela 3-1)

Në të dy godinat janë në funksion 14 salla leksioni, 28 salla seminaresh. Të gjitha sallat e leksioneve janë të pajisur me videoprojektor. Disa prej sallave të leksioneve apo të laboratorëve janë të pajisur edhe me sisteme audiovizivë dhe shfrytëzohen edhe për aktivitete të tjera si konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime etj. (tabela 3-2)

Në Fakultetin e Ekonomisë sot funksionojnë 8 laboratorë me kompjutera të pajisur me kompjutera dhe softere specifike për modulet e ndryshme aplikative (nr 201A, 206A, 207A, 227A, 228A, 110B, 111B, 112B) dhe 1 laborator për gjuhët e huaja. Të gjithë laboratorët janë të pajisura me videoprojektore dhe kondicionere. Informatika si një shkencë e aplikuar, ka nevojë për laboratorë që sigurojnë një ambient bashkëkohor për zhvillimin e lëndëve aplikative nëpërmjet softereve më të fundit. Kjo infrastrukturë ekziston por ka nevojë për përditësimet më të fundit, sidomos në drejtim të softereve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve. Në këtë kontekst u realizua dhe instalimi i paketës Office 365 të licensuar për laboratorët 206A, 207A, 201A, 227A, 228A, 112B si edhe instalimi i kësaj pakete për të gjithë stafin akademik.

Gjithashtu funksionon prej disa vitesh salla e Videokonferencave, e cila është në dispozicion të doktorantëve/stafit akademik dhe është e pajisur me mjetet audiovizive (211 B) si dhe vitin e fundit u hap edhe salla e trajnimeve.

Koniderohet e rëndësishme dhe e nevojshme që infrastruktura veçanarisht ajo kompjuterike të mund të mirëmbahet dhe pajiset në vijimësi përmes abonimit me paketat bazë të programeve të licensuara si edhe ato profesionale.

Të dhëna më të detajuara paraqiten në tabelat më poshtë.

Tabela nr 3-1: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore				
Numri Ndërtesa/Godina/Mjedise (Godina A/2 kate; Godina B/4 kate)	Norma Sipërfaqes m2/student	Sistem Mbrojtje Kundra Zjarrit (Po/Jo)	Sistem Kondicionimi (Ngrohje/ Ftohje)	Burime Alternative për Furnizimin me Energji Elektrike (Panele/Gjenerator etj)
Auditorë	3.790	Po	Po	Po
Salla audiovizive & për aktivitete Promovuese	121	Po	Po	Po
Laboratorë për lëndët	354	Po	Po	Po
Salla për bibliotekë& 42library42	275	Po	Po	Po
Mjedis për fotokopjime, 42library etj.	76	Po	Po	Po
Zyrë informacioni për studentët	415	Po	Po	Po
Holle dhe ambiente të hapura në shërbim të studentëve	4.490	Po	Jo	Po
Nyje hidrosanitare për studentët (40& 52 jashte, nga të cilat 2 për tetrapelgjkë)	465	Po	Jo	Po
Mjedise për stafin akademik & administrativ	1.555	Po	Po	Po
Sipërfaqja Total (m2) e shfrytëzueshme FEA	11.541			
Hapësira normative e shfrytëzueshme per m2/student ne FEA	3.9 m2/studentë			
Norma e sipërfaqjes minimale se shfrytëzueshme sipas Kodit të Cilësisë në IAL (2021)	3.8 m2/studentë			

Tabela nr 3-2: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore			
Mjediset Didaktike dhe Kërkimore	Numri i Ambienteve (Nr auditorë, salla etj...)	Kapaciteti për Student/Personel (Nr i personave që akomodohen)	Numri i Teksteve të Kataloguar; Kompjuterave/projektorë etj...
Auditorë Leksioni	14	1882	12 laptop & 12 projektorë

Auditorë Seminari	28	1040	
Laboratorë/Salla kompjuterash	8	170/13	170 PC & 8 projektorë
Ambiente Personeli Akademik	63	107	107
Ambiente Personeli Administrativ	21	48	39
Ambiente Teknike	4	5	2
Biblioteka Fizike-FEA	1	100	500 libra shqip, 2000 libra në gjuhë të huaj, 1700 materiale jo libra, periodikë të ndryshëm, 30 kompjutera
Biblioteka Online	1		JSTOR: https://ëëë.jstor.org Edëard Elgar Publishing https://ëëë.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent IOPSCIENCE https://ëëë.eifl.net/e-resources/iopscience https://journals.biologists.com/dev https://journals.biologists.com/jcs https://journals.biologists.com/jeb
Salla Audiovizive	3(L. Agraja, B. Male & 201A)	275/3	22
Multimedia	1(211B)	15	10
Salla Konferencash/Ekspozita	2 (Training Room & Gete)	30	2 & 2
Arkiva	3	1	1

FBM

FBM në vazhdimësi ka bërë përpjekje dhe është angazhuar në sigurimin e mjediseve të përshtatshme dhe cilësore, për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike brenda auditorëve. Procesi mësimor për të gjitha programet e studimit, zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Këto ambiente janë të ndara në disa godina kryesore, Godina e Agronomisë dhe Godina e Kopshtit Botanik, Godina ku ndodhet grupi kërkimor Gjenetikë-Përmirësim Gjenetik dhe Godina e Agro-mekanizimit, Godina e Zooteknisë & Akuakulturës, Sallat e Agromjedisit.

Këto mjedise janë të mjaftueshme për numrin e studentëve, grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e programeve të studimit që FBM ofron. Duke u bazuar në natyrën interdisiplinore të kurrikulave të programeve të ndryshme të studimit, për realizimin e objektivave mësimore të tyre, shfrytëzohen ndërmjet departmenteve ambjentet e ndryshme në nivel Fakulteti por dhe të Fakulteteve të tjera, në varësi të disiplinës që zhvillohet.

Hapësirat në dispozicion të programeve të studimit për zhvillimin e mësimit nga studentët janë në përputhje me VKM Nr.418 “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen bashkimin ose mbylljen e instotucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndricmit natyral, janë të orientuara nga krahu i majtë i studentit. Të gjitha mjediset e godinave kanë sisteme portative të fikjes së zjarrit, janë të pajisura me rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm përmes depozitave të ujit. *Departamenti i Mjedisit*

dhe Burimeve Natyrore do të ketë në dispozicion të studentëve auditorë të rinj si pjesë e godinës së re që tashmë ka përfunduar ndërtimin dhe është në fazë mobilimi.

Pedagogët shfrytëzojnë gjerësisht teknologji të reja të mësimdhënies (laptop, mjete audiovizive etj.). Shumica e kabineteve dhe sallave janë të pajisura me videoprojektorë. Pavarësisht pëmirësimeve ka ende punë për të bërë në drejtim të zgjerimit të hapësirave për realizmin e mësimin në kushte optimale.

Tabela nr 3.1 Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore në FBM

Numri Ndërtesa/Godina/Mjedise	Norma Sipërfaqes m ² / student	Sistem Mbrojtje Kundra Zjarrit (Po/Jo)	Sistem Kondicionimi (Ngrohje/Ftohje)	Burime Alternative për Furnizimin me Energji Elektrike (Panele/Gjenerator etj)
Agronomia	3773	Vendim nr. 1, Proces-Verbal nr. 60, date 17/04/2014	Pjesërisht	Po
Zooteknia	2333	Ka pjesërisht fikse zjarri	Pjesërisht	Jo
Mjedisi	2530	Vendim nr. 3, Proces-Verbal nr. 62, date 17/04/2014	Pjesërisht	Jo
Kopshti Botanik	347	Ka pjesërisht fikse zjarri	Pjesërisht	Jo
Mekanika	2010	Vendim nr. 5, Proces-Verbal nr. 66, date 17/04/2014	Pjesërisht	Jo
Laboratori i Gjenetikës, FSHP	340	Ka fikse zjarri	Pjesërisht	Jo
laboratori Peshkut	368	Jo	Pjesërisht	Jo
Stacioni i peshkut	308	Vendim nr. 7, Proces-Verbal nr. 68, date 21/04/2014	Pjesërisht	Jo
Total	12.009			

Burimi: Administratori i FBM-së

Tabela nr 3.2 Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore në FBM

Standardet Infrastrukturore			
Mjediset Didaktike dhe Kërkimore	Numri i Ambienteve (Nr auditorë, sala etj...)	Kapaciteti për Student/Personel (Nr i personave që akomodohen)	Numri i Teksteve të Kataloguar; Kompjuterave etj...
Auditorë Leksioni	20	1,349	60
Auditorë Seminari	33	1,473	
Laboratorë	34	842	
Ambiente Personeli Akademik	65	100	
Ambiente Personeli Administrativ	3	18	
Ambiente Teknike	10	37	
Biblioteka Fizike			
Biblioteka Online			
Salla Audiovizive			
Salla Kompjuterash	2	62	
Multimedia			
Salla Konferencash/Ekspozita			
Etj	1	30	
Total	167	3,881	

Burimi: Administratori i FBM-së

Raporti Pedagog /student për Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, sipas strukturës (plan) është 1 Pedagog për afërsisht 11 studentë, kurse me numrin faktik të stafit akademik është 1 pedagog për

10 studentë (nuk janë përfshirë studentët e ciklit të tretë të studimeve). Norma e sipërfaqjes minimale së shfrytëzueshme sipas Kodit të Cilësisë në IAL (2021) është $3.8 \text{ m}^2/\text{student}$. *Raporti sipërfaqe në m^2 për student është 8.3 m^2 për student.*

FBU

Gjatë vitit akademik 2024-2025, janë zbatuar planet mësimore të cilat janë aprovuar në fillim të vitit kalendarik. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit është zhvendosur në godinën e re e në muajin maj dhe si rrjedhojë edhe mësimi gjatë vitit akademik 2024-2025 është zhvilluar në kushte të papërshtatshme. Gjithashtu godina “Kantina” ka shfaqur prej vitesh probleme infrastrukturore. Të gjitha këto kanë bërë që të mos jetë e mundur plotësimi i hapësirave të nevojshme infrastrukturore për studentët dhe stafin akademik e ndihmësakademik. Megjithatë kjo nuk ka ndaluar zhvillimin normal të mësimit duke u ndihmuar dhe nga fakultet e tjera në UBT të cilat kanë vënë në dispozicionin sallat e leksioneve dhe të seminareve për zhvillimi normal të mësimit.

Tabela nr 3.1: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore			
Mjediset Didaktike dhe Kërkimore	Numri i Ambienteve (Nr auditorë, salla etj...)	Kapaciteti për Student/Personel (Nr i personave që akomodohen)	Numri i teksteve të Kataloguar; Kompjuterave etj...
Auditorë leksioni	5	392	5 (projektor)
Auditorë seminari	2	32	
Laboratorë	13	255	344 (pajisje laboratorike)
Ambiente personeli akademik	1		
Ambiente personeli administrativ	1	15	
Ambiente teknike	25	39	50 (komputera, printera)
Biblioteka fizike	3	4	6 (kompjuter, printera)
Biblioteka online	1	1	
Salla audiovizive			
Salla kompjuterash			
Multimedia			
Salla Konferencash/Ekspozita			
Etj...			

Tabela nr 3.2: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore				
Numri Ndërtesa/Godina/Mjedise	Norma Sipërfaqes m ² /student	Sistem Mbrojtje Kundra Zjarrit (Po/Jo)	Sistem Kondicionimi (Ngrohje/Ftohje)	Burime Alternative për Furnizimin me Energji Elektrike (Panele/Gjenerator etj)
2	6,35 m ²	po	Ngrohje/Ftohje	Gjenerator

Konkluzione

Lidhur me standardet infrastrukturore në FBU kërkohen investime për plotësimin me mjete audio-vizive, pajisje instrumentale dhe didaktike për të përmbushur të gjithë objektivat e mësimdhënies. Për vetë natyrën që ka kjo njësi kryesore, kërkohen investime periodike në pajisje laboratorike dhe mjete didaktike. Norma e sipërfaqes për 46nterne është përmirësuar me vënien në shfrytëzim të hapsirave të godinës së re të FBU-së. Pavarësisht përmirësimit të stadardeve të sipërfaqes për student kërkohet të instalohet rrjeti i internetit dhe të përmirësohet më tej infrastruktura e brendshme e godinës.

FSHP

Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) e zhvillon veprimtarinë e tij akademike dhe kërkimore në dy 46ntern 46ntern 46nternet46 ë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Godina kryesore e fakultetit, një ndërtesë katërkatëshe, ofron hapësira të dedikuara për mësimdhënie, kërkim, administratë dhe shërbime për studentët. Përveç saj, në funksion është edhe Laboratori i Mbrojtjes së Pyjeve, një strukturë moderne e ndërtuar në vitin 2018, e përshtatur për zhvillimin e praktikave laboratorike dhe analizave të specializuara.

Sipërfaqja totale e shfrytëzueshme për studentët e FSHP-së është **4073 m²**, duke siguruar një raport hapësiror prej **11.4 m²/student**, sipas të dhënave të përlllogaritura në tabelën 3-1. Ky tregues është në përputhje me kërkesat e standardeve shtetërore dhe me udhëzimet e Kodit të Cilësisë për infrastrukturën akademike në institucionet e arsimit të lartë.

Struktura hapësinore dhe infrastrukturore e fakultetit përfshin:

- **6 salla leksionesh**, të përshtatshme për zhvillimin e mësimi teorik, shumica të pajisura me videoprojektor dhe mjete didaktike bashkëkohore;
- **10 salla seminaresh**, të cilat mundësojnë mësim interaktiv, diskutime në grup dhe punë praktike të orientuara;
- **8 laboratorë funksionalë**, të specializuar për profilet kryesore të fakultetit (shkencat pyjore, teknologjinë e drurit, ekologjinë, zhvillimin rural, produktet jo-drusore etj.);
- **2 laboratorë të dedikuar për teknologjitë dixhitale gjeohapësinore (GIS) dhe projektim CAD**, të cilët përfaqësojnë komponentë kyç të modernizimit të kurrikulave dhe aftësimit teknologjik të studentëve.

Të gjithë laboratorët janë të pajisur me videoprojektor, kondicioner dhe infrastrukturën përkatëse për zhvillimin e praktikave laboratorike dhe trajnimeve teknike. Kjo strukturë fizike dhe

teknologjike ofron kushte të përshtatshme mësimore në përputhje me kërkesat e standardeve të cilësisë, duke mundësuar jo vetëm zhvillim të mësimi teorik, por edhe përgatitje praktike dhe profesionale të studentëve në funksion të kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në shkencat pyjore dhe industrinë e drurit.

Të dhëna të detajuara mbi hapësirat, kapacitetet dhe funksionalitetin e tyre paraqiten në tabelat në vijim.

Tabela nr. 3.2: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore				
Numri Ndërtesa /Godina/Mjedise (Godina FSHAP /4 kate)	Norma Sipërfaqes m ² /student	Sistem Mbrojtje Kundra Zjarrit (Po/Jo)	Sistem Kondicionimi (Ngrohje/Ftohje)	Burime Alternative për Furnizimin me Energji Elektrike (Panele/Gjenerator etj)
Auditorë	4,073	Po	Po	Po
Salla audiovizive & për aktivitete Promovuese	-	-	Po	Po
Laboratorë për lëndët	8	Po	Po	Po
Salla për bibliotekë& 47nternet	-	-	-	Po
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	-	-	-	Po
Zyrë informacioni	1	Po	Po	Po
Holle dhe ambiente të hapura në shërbim të studentëve	1	Po	Jo	Po
Nyje hidrosanitare	Jemi në fazën e marrjes së aktit HS	Po	Jo	Po
Mjedise për stafin akademik & administrativ	27	Po	Po	Po
Sipërfaqja Total (m²) e shfrytëzueshme FSHP	4,073			
Hapësira normative e shfrytëzueshme per m² / student	11.4 m²/studentë			
Norma e sipërfaqjes minimale se shfrytëzueshme sipas Kodit të Cilësisë në IAL (2021)	3.8 m²/student			

Table 3-2. Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore			
Mjediset Didaktike dhe Kërkimore	Numri i Ambienteve (Nr auditorë, salla etj...)	Kapaciteti për Student/Personel (Nr i personave që akomodohen)	Numri i Teksteve të Kataloguar; Kompjuterave/projektorë etj...
Auditorë Leksioni	5	568	
Auditorë Seminari	10	399	
Laboratorë/Salla kompjuterash	8/2.	317	50 Kompjutera
Ambiente Personeli Akademik	23	27	20
Ambiente Personeli Administrativ	4	6	2
Ambiente Teknike (QDEID)	1	-	1
Biblioteka Fizike	-	-	
Biblioteka Online	-	-	
Salla Audiovizive	-	-	
Multimedia	-	-	
Salla Konferencash/Ekspozita	2	110	
Arkiva	1	1	

FMV

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (FMV), pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, operon në një infrastrukturë të përqendruar brenda kampusit universitar, rreth 6 km nga qendra e Tiranës, me akses të lehtë për studentët përmes transportit publik, falë stacioneve të vendosura pranë hyrjes kryesore. Vendosja gjeografike dhe organizimi hapësinor i godinave universitare plotësojnë kërkesat e Kodit të Cilësisë lidhur me aksesueshmërinë, sigurinë dhe funksionalitetin e mjedisve akademike.

FMV përbëhet nga katër ndërtesa kryesore, të strukturuar për të mbështetur në mënyrë të integruar proceset mësimore, praktike dhe kërkimore:

- **Ndërtesa kryesore (1598m²)**, që përfshin sallat e leksioneve, sallat e seminareve, 12 laboratorë mësimorë, 5 laboratorë kërkimorë dhe zyrat akademike e administrative;
- **Klinika e Kafshëve të Vogla (1420 m²)**, e organizuar në dy kate dhe e pajisur me sallë pritjeje, sallë kirurgjie, dhomë ekzaminimi e trajtimi, sallën “Aldea” (120 vende), si edhe 2 laboratorë mësimorë/kërkimorë dhe 2 salla mësimi për grupe të vogla studentësh.

- **Ndërtesa e Anatomisë (753 m²)**, e organizuar në dy kate dhe e pajisur me 4 laboratorë mësimorë, një sallë leksionesh, ambiente të dedikuara për funksionimin e klinikës veterinare, zyra personeli dhe ambiente të tjera funksionale;
- **Godina e QTP-se (420 m²) e organizuar ne nje kat**
- **Projekti Grek (74 m²) e organizuar ne nje kat**
- **Klinika e Kafshëve të Mëdha (270 m²)**, e ndërtuar rishtazi në zonën e ish-Fermës Didaktike Eksperimentale, me sallë leksionesh, ambiente radiologjie e ultrasonografie dhe hapësira për mbajtjen e kafshëve të mëdha;

Në total, FMV disponon 13 laboratorë mësimorë (602 m²) dhe 11 laboratorë kërkimorë (490 m²), të cilët përmbushin standardet bazë për zhvillimin e praktikave mësimore dhe kërkimit shkencor. Po ashtu, Fakulteti ofron edhe ambiente shërbimi të specializuar për obstetrikë–gjinekologji, grafi dhe shërbime ambulatorë, me sipërfaqe totale prej 225 m².

Për sa i përket infrastrukturës bibliografike, FMV operon me një bibliotekë akademike prej 45 m², me kapacitet 20 vende, e cila siguron akses në literaturë bazë, materiale kërkimore dhe botime shkencore.

Vendosja e godinave të FMV-së mundëson lëvizje të thjeshtë, të shpejtë dhe të sigurt midis mjediseve akademike, laboratorike dhe klinike, duke përmbushur kërkesat për organizim funksional të infrastrukturës. Sipërfaqja totale e dedikuar procesit mësimor arrin në 4265 m², duke siguruar një raport prej 7 m²/student, në përputhje me parametrat orientues të standardeve shtetërore për ambientet e mësimdhënies.

Vlerësimi i infrastrukturës aktuale të FMV-së tregon se fakulteti përmbush në masë të konsiderueshme kërkesat e standardeve institucionale dhe atyre të MAS për funksionimin e programeve të studimit në fushën e mjekësisë veterinare. Elementët që rezultojnë në përputhje janë:

- **Aksesueshmëria** e mjediseve për studentët, stafin dhe përdoruesit e shërbimeve klinike;
- **Diversiteti i ambienteve mësimore** (salla, laboratorë, klinika);
- **Përputhshmëria e hapësirave laboratorike** me nevojat e praktikës profesionale në mjekësinë veterinare;
- **Përfshirja e ambienteve të specializuara klinike**, të cilat janë element kyç i standardeve të programeve profesionale;
- **Raporti hapësirë/student**, i cili përputhet me kufijtë e përcaktuar në standardet e infrastrukturës për arsimin e lartë.

Pavarësisht nivelit të përgjithshëm të përmbushjes së standardeve, analiza evidenton disa boshllëqe dhe nevoja zhvillimore:

1. **Kapacitetet e sallave të leksioneve** në disa raste janë të pamjaftueshme dhe kërkojnë shtim të numrit të ulëseve.
2. **Pajisjet teknike** (projektorë, kablo lidhëse, sisteme audio) kërkojnë rinovim dhe standardizim për të siguruar cilësi optimale të mësimdhënies.
3. **Klinika e Kafshëve të Mëdha**, megjithëse funksionale, kërkon plotësim të mëtijshëm me pajisje laboratorike dhe staf teknik për të përmbushur standardet e praktikës intensive klinike.
4. **Laboratorët kërkimorë** kanë nevojë për përditësim me pajisje moderne, për të rritur kapacitetin e kërkimit shkencor.
5. **Biblioteka**, ka kapacitet të kufizuar dhe kërkon modernizim digjital dhe rritje të fondeve bibliografike.
 - a. Të dhëna mbi politikat e IAL-së për shpërndarjen e fondeve, në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Procesi i përmirësimit, sidomos sa i përket infrastrukturës në shërbim të mësim, është i dukshëm dhe vazhdon, siç është investimi i madh në rindërtimin nga e para të godinës së Anatomisë. Në këtë godinë tashmë gjenden 4 laboratorë mësimorë, ambiente teknike, laborator shkencor, sallë leksioni dhe një seksion i saj është destinuar për klinikën veterinare. Me përfundimin e godinës së re, në këtë vit akademik u rritën ndjeshëm kapacitetet infrastrukturore në shërbim të mësimdhënies, aftësimi praktik të studentëve si edhe kërkimit shkencor. Sidoqoftë kjo godinë ka ende nevoja për mobilim e pasurim me pajisje për laboratorët mësimorë si edhe për sallën e leksionit, e cila gjatë këtij viti akademik nuk u vu në përdorim.

Tabela nr. 3.1: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore				
Numri Ndërtesa/Godina/Mjedise	Norma Sipërfaqes m ² /student	Sistem Mbrotjtje Kundra Zjarrit (Po/Jo)	Sistem Kondicionimi (Ngrohje/Ftohje)	Burime Alternative për Furnizimin me Energji Elektrike (Panele/Gjenerator etj)
Godina Kryesore e Veterinarisë	1598	Po	PO	Gjenerator
Godina e Klinikave	1420	Po	PO	Gjenerator
Godina e Anatomisë	753	Po	PO	Gjenerator
Godina e QTP	420	Po	PO	Gjenerator
Projekti Grek	74	Po	PO	Gjenerator
	4265			

Tabela nr. 3.2: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore

Standardet Infrastrukturore			
Mjediset Didaktike dhe Kërkimore	Numri i Ambienteve (Nr auditorë, salla etj...)	Kapaciteti për Student/Personel (Nr i personave që akomodohen)	Numri i Teksteve të Kataloguar; Kompjuterave etj...
Auditorë Leksioni	8	609	
Auditorë Seminari	11	490	
Laboratorë	13	602	
Ambiente Personeli Akademik	26	476	
Ambiente Personeli Administrativ	1	30	
Ambiente Teknike	2	100	
Biblioteka Fizike	1	40	
Biblioteka Online			
Salla Audiovizive			
Salla Kompjuterash			
Multimedia			
Salla Konferencash/Ekspozita			
Ambjente shërbimi për të tretet	3	225	
Salla për praktika lëndore mesimore	4	397	
Nyje hidrosanitare për studentet dhe personelin	18	816	
Korridoret	7	480	

Klinika Veterinare

Departamenti i Moduleve Klinike ka në përbërje Klinikën Veterinare të kafshëve të vogla, e cila përbën bazën kryesore të punës praktike të stafit dhe studentëve. Në këtë klinikë kryhen shërbime rutinë dhe të avancuara, përfshirë vaksinime, diagnostikë klinike, trajtime, ndërhyrje kirurgjikale, kontroll oftalmologjik e otologjik, si dhe të gjitha manipulimet e nevojshme për kafshët shoqëruese.

Gjatë vitit akademik 2024–2025, klinika ka funksionuar përgjithësisht në kushte normale dhe ka ofruar mundësi të plota për zhvillimin e praktikave mësimore. Në ambjentet e saj janë realizuar orët praktike të katër moduleve të departamentit, duke mbuluar rreth 20 grupe mësimore. Aktiviteti klinik i zhvilluar deri më 15 nëntor 2025 dhe pritshmëritë deri më 31 dhjetor 2025 paraqiten në tabelën më poshtë.

Periudha	Konsulta	Mjekime	Operacione	Praktika mësimore	Operacione mësimore	Të ardhura (Lekë)
Deri më 15/11/2025	22	60	32	47	21	232,000
Pritshmëria deri më 31/12/2025	30	80	40	55	25	300,000

Në vitin 2025, klinika e kafshëve të shoqërimit ka realizuar një xhiro vjetore rreth **160,000 lekë më të lartë** se ajo e vitit paraardhës. Megjithatë, duke analizuar ecurinë gjatë katër viteve të fundit, vihet re një trend rritës, ndonëse rezultatet mbeten ende larg potencialit të klinikës.

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Xhiro	13,800	22,400	117,550	120,000	120,000	161,200	300,000

Prej më shumë se një viti, në Fakultet është ndërtuar Klinika e re Veterinare, e cila pritet të pajiset së shpejti me aparatura moderne. Që nga muaji **Nëntor 2025**, të gjitha shërbimet ndaj publikut janë transferuar në këtë klinikë të re, ndërsa ambjentet e vjetra përdoren vetëm për procesin mësimor.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe modernizimit të Laboratorit të Imazherisë, ku gjatë vitit të kaluar janë realizuar ndërhyrjet kryesore: përmirësimi i dhomës së ekspozimit, instalimi i portave mbrojtëse kundër rrezatimit, vendosja e xhamit të plumbit, sistemi i aspirimit dhe veshja me fletë plumbi e ambientit deri në një lartësi prej 2.5 metrash. Këto masa garantojnë funksionim të sigurt, të certifikuar dhe në përputhje me protokollat ndërkombëtare të mbrojtjes radiologjike.

Është bërë progres edhe në aspektet administrative: janë rishikuar dhe listuar çmimet e shërbimeve, si dhe janë lehtësuar procedurat financiare, duke rritur transparencën dhe efikasitetin. Gjithashtu, prej një viti në klinikë është vendosur funksioni i **Pedagogut dezurn**, i cili mbikëqyr rastet klinike gjatë ditës dhe siguron vijimësi profesionale në shërbim.

Megjithatë, stafi i departamentit vlerëson se funksionimi i klinikës duhet të konsiderohet si aktivitet i përbashkët i gjithë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, dhe jo vetëm përgjegjësi e DLK-së. Departamentet e tjera, veçanërisht Departamenti Paraklinik dhe Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar, kanë një rol thelbësor në mbështetjen e shërbimit klinik, pasi një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës laboratorike dhe kapaciteteve diagnostike administrohen prej tyre. Kjo qasje e integruar garanton eficiencë më të madhe, përdorim të koordinuar të burimeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve dhe studentëve.

Pavarësisht se bashkëpunimi ndërmjet departamenteve për mbështetjen e aktivitetit klinik ka funksionuar mbi baza të përvojës së akumuluar, aktualisht po vlerësohet nevoja për një strukturim edhe më të qartë të këtij koordinimi. Në këtë kuadër, po ndërmerren hapa për përmirësimin e qarkullimit të informacionit, përcaktimin e procedurave të përbashkëta dhe forcimin e mekanizmave të bashkërendimit ndërdepartamentor. Një qasje e tillë synon të rrisë më tej eficiencën dhe qëndrueshmërinë e shërbimit klinik, veçanërisht në menaxhimin e proceseve që lidhen me analizat laboratorike të specializuara që varen nga funksionimi i laboratorëve përkatës.

Përsa i përket aktivitetit laboratorik që mbështet klinikën, përdorimi i pajisjeve hematologjike dhe biokimike kërkon furnizim të rregullt me solucione specifike, kalibrimi periodik dhe asistencë profesionale, që mbartin kosto operative të konsiderueshme. Për të garantuar vazhdimësinë e

praktikës klinike, mësimore dhe kërkimore, aktualisht disa analiza kryhen në mënyrë manuale, që siguron rezultatet e nevojshme për trajtimin e rasteve klinike dhe zhvillimin praktik të studentëve.

Për të përforcuar më tej eficiencën dhe qëndrueshmërinë e funksionimit të laboratorëve dhe shërbimit klinik, do ndiqet një qasje institucionale, e strukturuar dhe bashkëpunuese, e cila përfshin:

- *zhvillimin e një mekanizmi të koordinuar ndërdepartamental për përdorimin dhe menaxhimin e laboratorëve;*
- *përcaktimin e protokolleve standarde për mbështetjen laboratorike të klinikës;*
- *parashikimin e një buxheti vjetor të qëndrueshëm për solucione, kalibrimi dhe shërbime teknike;*
- *sigurimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike përmes kontratave vjetore me kompani të licencuara, që garanton ndërhyrje të shpejtë dhe të certifikuar kur paraqiten nevoja.*

Kjo qasje synon të konsolidojë përdorimin efikas të pajisjeve dhe burimeve, të mbështesë zhvillimin praktik të studentëve dhe të sigurojë vazhdimësi të lartë të shërbimit klinik.

Pavarësisht përmirësimeve të ndërmarra gjatë viteve të fundit, klinika ende nuk arrin të ofrojë numrin optimal të rasteve klinike që do të siguronte një eksperiencë mësimore më të pasur dhe një nivel më të lartë të aftësive praktike për studentët. Sipas standardeve të EAEVE, për arritjen e kompetencave klinike të njohura si “Day 1 Competences”, studentët kanë nevojë të punojnë me një numër të mjaftueshëm rastesh reale, për të ushtruar aftësitë praktike dhe vendimmarrjen klinike në situata të ndryshme. Aktualisht, numri prej rreth 230 rasteve në vit nuk e lejon përvojën praktike të studentëve të arrijë kompetencat e duhura, por po ndërmerren hapa konkretë për të rritur qasjen dhe shkallën e ekspozimit praktik, me qëllim të përmbushjes së kompetencave klinike të kërkuara nga standardet ndërkombëtare.

Disa nga arsyet që ndikojnë në këtë situatë lidhen me konkurrencën në rritje të klinikave private dhe me marketingun modest që klinika e fakultetit ka zhvilluar ndër vite. Në këtë kuadër, po hartohen strategji për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin lokal, promovimin e shërbimeve klinike dhe nxitjen e pjesëmarrjes së rasteve të reja, gjithmonë duke ruajtur fokusin mbi qëllimin kryesor: aftësimin praktik të studentëve dhe përmbushjen e kompetencave klinike të kërkuara nga standardet ndërkombëtare.

Për të përforcuar qasjen e publikut dhe për të rritur numrin e rasteve klinike, janë parashikuar iniciativa, në mënyrë që studentët të përfitojnë një përvojë më të pasur praktike. Këto përfshijnë rritjen e prezencës në rrjetet sociale, me publikime edukative mbi kujdesin veterinar, informacione mbi shërbimet e ofruara dhe shembuj rastesh, duke respektuar gjithmonë privatësinë, organizimin e ditëve të hapura, ku qytetarët mund të marrin këshilla falas ose shërbime bazë me çmime simbolike, forcimin e bashkëpunimeve me bashkitë për fushata vaksinimi dhe sterilizimi, duke orientuar rastet më komplekse drejt klinikës së fakultetit, dhe zhvillimin e aktiviteteve informuese

në shkolla dhe komunitete, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si institucion referencë dhe qendër e besueshme për kujdesin dhe edukimin veterinar

Si një mundësi për të rritur aksesin dhe numrin e rasteve klinike, është konsideruar edhe hapja e një ambjenti klinik në një zonë të preferuar të qytetit, që do të ishte më i aksesueshëm për qytetarët. Kjo do të kërkonte mbështetje institucionale dhe koordinim të mëtejshëm, dhe mund të shërbejë si një opsion potencial për përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e ndërveprimit me komunitetin.

Të gjitha këto masa synojnë rritjen e fluksit të rasteve, përmirësimin e praktikës studentore dhe përforcimin e rolit të klinikës si qendër universitare e shërbimit veterinar. Rritja e cilësisë së shërbimit dhe e numrit të rasteve është thelbësore, jo për arsye financiare, por për të ofruar studentëve mundësi më të gjera praktike dhe për t'i përgatitur ata më mirë për profesionin.

Për të siguruar një përvojë praktike më të plotë për studentët dhe për të rritur cilësinë e shërbimit klinik, është e domosdoshme pajisja e klinikës me 25 sete kirurgjikale bazë, që mundësojnë punën e pavarur të çdo grupi studentësh gjatë praktikave. Për diagnostikë më të avancuar, është e nevojshme vendosja e një aparati ekografie digital të standardeve moderne dhe e një aparati radiologjie digital për kafshët e shoqërimit, që përmirësojnë cilësinë e diagnozës dhe shpejtësinë e shërbimit. Për sigurinë dhe efikasitetin gjatë operacioneve, kërkohet një aparati anestezie inhalatore, i pajisur me bombula oksigjeni, oksid azoti dhe substanca anestetike inhalatore (halotan, izofluran). Një zhvillim tjetër i domosdoshëm është shtimi i dy mjekëve veterinerë të dedikuar, me mundësi specializimi: njëri në anestezi dhe reanimacion, dhe tjetri në mjekësi interne ose kirurgji, për të rritur cilësinë e shërbimit dhe për të mbështetur në mënyrë efektive procesin mësimor. Këto hapa janë thelbësorë për të garantuar që klinika të ofrojë shërbim cilësor, të sigurt dhe të plotë, duke përmbushur standardet e edukimit veterinar dhe duke i dhënë studentëve mundësi reale praktike, të domosdoshme për formimin e tyre profesional.

4.2 Të dhëna mbi politikat e njësisë/IAL-së për shpërndarjen e fondeve, në funksion të përmirësimit të cilësisë.

FEA

Sikundër është e sanksionuar edhe në aktet ligjore dhe rregullative FEA si njësi kryesore e UBT respekton kriteret dhe politikat e pëdorimit të fondeve si edhe alokimit të tyre bazuar mbi prioritetet, nevojat si edhe vendimarrjen e organeve më të larta të UBT (senati akademik dhe bordi i administrimit). Burimet kryesore të fondeve janë ato të ardhura nga buxheti i shtetit si edhe ato të siguruar nga FEA (kryesisht përmes tarifave të studimit). Gjatë viteve të fundit i është kushtuar një vëmendje e posacme përmirësimit të kushteve të mësimdhënies si atyre infrastrukturore po aq edhe të faciliteteve si edhe bazës laboratorike. Kjo ka sjellë rritje të cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies dhe një preformancë më të mirë të stafit akademik.

Zërat kryesore të shpenzimeve të FEA-s rezultojnë ato që lidhen me shpenzimet e pagave dhe orëve suplementare, shpenzimet për investime si edhe ato të lidhura me zërin mallra dhe shërbime për mirëfunksionimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore të shërbimeve për studentët dhe të tretët dhe asaj administrative të fakultetit në tërësi.

FBM

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedit, i udhëhequr nga Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-së, harton projektbuxhetin duke marrë në konsideratë realizimin e objektivave të fakultetit, të cilat janë përcaktuar në funksion të përmbushjes së misionit si dhe objektivave të parashikuara në programet e studimit. Projektbuxheti siguron mbështetjen e nevojshme financiare për funksionimin dhe zhvillimin e plotë të ciklit të programeve të studimit në FBM.

Gjatë hartimit të planit financiar, FBM përfshin këto prioritetë:

1. Kualifikimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik, përmes trajnimeve dhe kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme brenda dhe jashtë vendit.
2. Përmirësimin cilësor të mjediseve mësimore dhe laboratorëve shkencorë.
3. Pajisjen me teknologji dhe aparatura bashkëkohore në funksion të procesit mësimor.
4. Rritjen e konkurrueshmërisë së stafit përmes pjesëmarrjes në projekte, konferenca dhe kongrese kombëtare e ndërkombëtare.
5. Përmirësimin e kushteve higjienosanitare në ambientet e fakultetit.

FSHP

Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP), si njësi kryesore akademike brenda Universitetit Bujqësor të Tiranës, zbaton politikat institucionale të shpërndarjes së fondeve në përputhje me udhëzimet e Kodit të Cilësisë, legjislacionin në fuqi dhe vendimmarrjen e organeve të larta drejtuese (Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit). Menaxhimi financiar bazohet në parimet e transparencës, eficiencës dhe orientimit strategjik drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve.

Burimet kryesore financiare të përdorura nga fakulteti përfshijnë:

- **fonde nga buxheti i shtetit**, të cilat mbulojnë shpenzimet bazë të funksionimit akademik dhe administrative;
- **të ardhura nga tarifat e studimit**, të cilat përbëjnë një instrument plotësues për financimin e investimeve, modernizimin e infrastrukturës dhe mbështetjen e iniciativave akademike.

Gjatë viteve të fundit, FSHP ka orientuar një pjesë të konsiderueshme të fondeve drejt përmirësimit të kushteve të mësimdhënies dhe forcimit të bazës infrastrukturore e laboratorike.

Këto investime përfshijnë:

- modernizimin e sallave të mësimi me pajisje didaktike bashkëkohore,
- përmirësimin e laboratorëve ekzistues dhe ngritjen e laboratorëve të rinj,
- rritjen e kapaciteteve teknologjike në funksion të kurrikulave të përditësuara,
- lehtësimin e proceseve të mësimnxënies përmes mjediseve më të përshtatshme dhe funksionale.

Këto investime kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë së procesit mësimor, efikasitetin e mësimdhënies dhe përmirësimin e performancës së stafit akademik, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin profesional të tyre dhe për formimin cilësor të studentëve.

Zërat kryesorë të shpenzimeve të fakultetit përfshijnë:

- shpenzimet e personelit (paga dhe orë suplementare),
- investimet kapitale, të lidhura me përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve laboratorike,
- shpenzimet për mallra dhe shërbime, që mbështesin funksionimin normal të procesit mësimor, kërkimor, shërbimeve për studentët si dhe veprimtarinë administrative të fakultetit.

Shpërndarja e fondeve kryhet duke respektuar prioritetet strategjike të UBT-së dhe të FSHP-së, me synimin kryesor të garantimit të standardeve të cilësisë në proceset akademike dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj komunitetit universitar.

FMV

Procesi i përmirësimit të infrastrukturës së Fakultetit ka vijuar me ritme të qëndrueshme gjatë periudhës së fundit, duke reflektuar angazhimin institucional për modernizimin e mjediseve akademike dhe për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme strategjike ka qenë rindërtimi i plotë i godinës së Anatomisë, një investim që synon jo vetëm përmirësimin e kushteve fizike, por edhe rritjen e kapaciteteve profesionale të studentëve dhe stafit akademik.

Godina e re e Anatomisë është projektuar dhe realizuar duke respektuar kriteret teknike të institucioneve bashkëkohore të arsimit të lartë. Ajo përmban katër laboratorë të profilizuar për zhvillimin e praktikave mësimore, ambiente të dedikuara teknike, si edhe një sallë të posaçme leksionesh e konceptuar për të ofruar kushte optimale për zhvillimin e orëve teorike. Një pjesë e godinës i është dedikuar gjithashtu klinikës veterinare, e cila përbën një komponent të domosdoshëm për formimin praktik të studentëve të Mjekësisë Veterinare.

Me përfundimin e punimeve dhe vënien në përdorim të godinës, kapacitetet infrastrukturore akademike të Fakultetit janë rritur dukshëm gjatë këtij viti akademik. Tani studentët kanë në dispozicion mjedise që mundësojnë zhvillimin e praktikave laboratorike në kushte më të sigurt dhe më efektive, duke ndihmuar kështu në ndërtimin e kompetencave profesionale të kërkuara nga programi i studimit.

Në mënyrë të veçantë, një pjesë e ambienteve të klinikës veterinare është bërë funksionale gjatë këtij viti, pasi është pajisur me mobilie bazë dhe disa aparatura të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale, si dhe të manipulimeve dhe procedurave praktike me kafshët e shoqërimit. Kjo ka mundësuar që studentët të angazhohen në ushtrime praktike reale, nën mbikëqyrjen e stafit të specializuar, duke përmirësuar cilësinë e formimit të tyre klinik. Aktivizimi i këtyre ambienteve përbën një hap të rëndësishëm drejt funksionalizimit të plotë të klinikës, e cila pritet të luajë një rol kyç në praktikën profesionale të studentëve dhe në shërbimet komunitare që Fakulteti synon të ofrojë.

Megjithatë, pavarësisht progresit të dukshëm, godina e re mbetet në proces plotësimi. Disa prej laboratorëve mësimorë kërkojnë ende pajisje shtesë dhe kompletim me instrumenta të specializuar që do të mundësonin përdorimin e tyre të plotë.

Në përfundim, investimet e kryera përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të infrastrukturës së Fakultetit, ndërsa vazhdimi i procesit të pajisjes dhe funksionalizimit të plotë të ambjentëve mbetet një objektiv i rëndësishëm institucional për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, për të rritur kapacitetin praktik të studentëve dhe për të forcuar bazën kërkimore të Fakultetit.

FBU nuk kane dhene informacion

4.3 Të dhëna mbi numrin e teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimi

FEA

Në mjediset e kampusit të UBT funksionojnë dy biblioteka shkencore, biblioteka shkencore “Mentor Përmeti” (në qendër të kampusit) krijuar ne 1951 dhe biblioteka shkencore e FEA-s në mjediset e Godinës FEA/B kati i pare. Roli i bibliotekës së UBT u rrit edhe më shumë pas vitit 1973 kur ajo mori atributet e Bibliotekës Shkencore. Në vitin 1975 biblioteka vendoset në ambientet e Pallatit të ri të Kulturës dhe merr fizionominë e plotë të një institucioni me standarde unike. Më 24. 04. 2015, Biblioteka Shkencore merr emrin e akademikut të shquar, Prof. Dr. Mentor Përmeti. Biblioteka ka aktualisht një fond prej mbi 26.000 libra dhe rreth 10.000 volume periodike. Ofron shërbim për komunitetin e studentëve të UBT, për stafin akademik dhe administrativ, si dhe për kërkuesit shkencor në fushën e bujqësisë. Gjithashtu, organizon ekspozita të ndryshme, aktivitete me studentët, përkujton studjuesit dhe akademikët e fushës së bujqësisë, etj.. Ndër vite kjo bibliotekë ka qenë ndër bibliotekat më në zë për pasurimin e fondeve, duke u vlerësuar si ndër më të rëndësishme në Ballkan për llojin e vet.

Duke qene pjese e sistemit COBBISS.NET, qysh prej 2013, Biblioteka Shkencore @Mentor Petrela” ka filluar hedhjen e te dhenae bibliografike dhe krijimin e katalogut online. Perdoruesi mund te kete informacion kudo dhe kurdo per literaturen shkencore qe gjendet ne kete biblioteke. Nje arritje e bibliotekes eshte dhe perfitimi i burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library). Biblioteka Shkencor “Mentor Permeti” duke qene anetare eKonsorciumit te Bibliotekave Shqiptare ka siguruar akses ne burime elektronike, si

JSTOR: <https://www.jstor.org>

Edëard Elgar Publishing <https://www.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent>

IOPSCIENCE <https://www.eifl.net/e-resources/iopscience>

The Company of Biologists: <https://journals.biologists.com/dev>
<https://journals.biologists.com/jcs>; <https://journals.biologists.com/jeb>

Në godinën B të FEA-s, në katin e poshtëm, funksionon që prej rreth 11 vitesh Biblioteka Shkencore e Fakultetit, me fond të pasur librash e revistash shkencore. Në fondin e kësaj salle gjenden rreth 500 libra shqip, 2000 libra në gjuhë të huaj, 1700 materiale jo libra, periodikë të ndryshëm, etj. Informacioni mbulon të gjitha fushat e ekonomisë. Salla e FEA permban rreth **100 poste për studim**, këndin e punës në grup, edhe një sistem kompjuterash ku vec internetit,

funksionon dhe libraria elektronike TEEAL. Biblioteka është sot një mjedis modern me kushte komode për studim për studentët dhe stafin.

Përveç fondit të librave, që është i pasur me informacionin e duhur për të mbështetur programet studimore, informacioni jepet edhe nëpërmjet periodikut shqip dhe të huaj. Në mënyrë më të detajuar informacioni jepet në vijim:

Revista shkencore periodike:

1. Revista angleze – The Economist
2. Revista gjermane – Z.K.G.
3. Revista hungareze – Studies in Agricultural Economics
4. Revista Rumune – România apicolă
5. Revista sllovene – Acta agriculturae Slovenica
Slovenian Veterinary Research

Nga analizat e zhvilluara në departamente, por dhe nga situata që konstatojmë si pasojë e ndjekjes së vazhdueshme të problematikave, informojmë se infrastruktura mësimore, që është detyrë dhe përgjegjësi direkte e stafit akademik, rezulton të jetë përgjithësisht e mirë.

Në përgjithësi nevojat e procesit mësimor dhe të studentëve me materiale didaktike janë të mbuluara mirë. Tekste, leksione në ppt, detyra, ushtrime dhe informacione të ndryshme, skripte të nevojshme për studentët, etj. janë të depozituara në librarinë e UBT si dhe një pjesë e tyre ju dërgohen elektronikisht studentëve.

FBM

Modulet në programet e studimit të FBM përbëjnë bazën kryesore të procesit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimit profesional. Ato janë të organizuara dhe zhvillohen sipas planit mësimor përmes leksioneve, seminareve/orëve laboratorike dhe praktikave të mësimdhënies në terren. Një rëndësi të veçantë zënë praktikat profesionale, të cilat synojnë të thellojnë njohuritë teorike dhe profesionale të studentëve të fituara gjatë studimeve.

Të gjitha modulet e zhvilluara nga FBM janë të pajisura me materialet përkatëse didaktike, si leksione, tekste, prezantime në PowerPoint dhe skripte apo udhëzues të praktikave laboratorike edhe në format elektronik. Kjo u mundëson studentëve të kenë akses më të gjerë në informacion, të rritet interaktiviteti dhe të përmirësohet cilësia e procesit mësimor. Stafi akademik i FBM përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirë pajisjet audiovizive si projektorët, duke mbështetur një proces më efikas dhe të orientuar drejt studentit.

Në përgjithësi janë respektuar standartet sasiore dhe cilësore të procesit mësimor. Studentëve ju ofrohet njohuri sipas programeve të miratuara zyrtarisht. Në fund të semestrit studentëve u bëhet i ditur rezultati i vlerësimit të modulit (max 40 pikë) me të cilën ata do të hyjnë në provim. Provimet dhe riprovimet janë zhvilluar konform rregullores së studimeve. Të gjitha tezat e provimeve tashmë janë hartuar me 60 pikë në total. Implementimi i sistemit elektronik për plotësimin e proces verbaleve dhe informimit të studentëve me rezultatet e provimeve në rrugë elektronike është një arritje e rëndësishme. *Problem mbetet ende edhe plotësimi dhe dorëzimi në kohë i proces verbaleve*

nga disa pedagogë e në mënyrë që të mos krijohen probleme me nxjerrjen e rezultateve në kohë si dhe evidentimin e kalueshmërisë.

Personeli akademik i FBM ka përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme programet mësimore, duke alternuar metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe duke u përshtatur me nevojat e studentëve. Shumica e moduleve të programeve të studimit përfshijnë detyra dhe aktivitete praktike që u mundësojnë studentëve të përvetësojnë dhe zbatojnë njohuritë teorike, si dhe të zhvillojnë aftësinë për të punuar në grup. Procesi i mësimdhënies në FBM synon gjithnjë e më shumë të ofrojë një edukim të orientuar drejt kompetencave të kërkuara në tregun e punës. Përmes praktikave mësimore dhe profesionale, synohet që studentët të fitojnë aftësi të zbatueshme në organizatat ku ata mund të punësohen pas përfundimit të studimeve.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ka mbështetur vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit. Objektivi kryesor në shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) përfshin përmirësim të procesit mësimor dhe veprimtarisë kërkimore, nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore, shkëmbimin e materialieve akademike dhe literaturës shkencore. Gjatë vitit të kaluar janë programuar dhe realizuar dhe orë të hapura leksionesh nga stafi i FBM apo dhe nga personalitete të ftuar. Ajo që vlen të theksohet si një fakt mjaft pozitiv është që një pjesë e madhe e lektorëve sjellin me vete eksperiencë shumë të mira nga institucionet kërkimore-shkencore të Universiteteve perëndimore si pjesë e shkëmbimit të eksperiencave nëpërmjet bursave ERASMUS. FBM ka mbështetur edhe këtë vit akademik, stafin akademik për zhvillimin e studimeve të thelluara (doktoratura) jashtë vendit, duke ju dhënë mundësinë të zhvillojnë modulet e tyre në periudha të përshtatshme për ta.

Modulet e zhvilluara në departamentet e FBM-së janë të pajisura me leksione, tekstet përkatëse, prezantime në PowerPoint, si edhe materiale dhe skripte të praktikave laboratorike në format elektronik, të publikuara në faqen zyrtare të UBT-së. Kjo u mundëson studentëve akses të gjerë në informacion, rrit interaktivitetin në auditor dhe kontribuon në një cilësi më të lartë të procesit mësimor. Duke u bazuar në përvojën e fituar gjatë periudhës së mësimi online, stafi i departamenteve vazhdon të përdorë këtë metodë në formë të kombinuar, duke u vënë në dispozicion studentëve, përmes platformës Classroom, të gjithë informacionin e nevojshëm për programin mësimor..

Në mjediset e kampusit të UBT funksionojnë biblioteka shkencore “Mentor Përmeti” (në qendër të kampusit) krijuar në 1951. Roli i bibliotekës së UBT u rrit edhe më shumë pas vitit 1973 kur ajo mori atributet e Bibliotekës Shkencore. Në vitin 1975 biblioteka vendoset në ambientet e Pallatit të ri të Kulturës dhe merr fizionominë e plotë të një institucioni me standarde unike. Më 24. 04. 2015, Biblioteka Shkencore merr emrin e akademikut të shquar, Prof. Dr. Mentor Përmeti. Biblioteka ka aktualisht një fond prej mbi 26.000 libra dhe rreth 10.000 volume periodike. Ofron shërbim për komunitetin e studentëve të UBT, për stafin akademik dhe administrativ, si dhe për kërkuesit shkencor në fushën e bujqësisë. Gjithashtu, organizon ekspozita të ndryshme, aktivitete me studentët, përkujton studjuesit dhe akademikët e fushës së bujqësisë, etj.. Ndër vite kjo

bibliotekë ka qenë ndër bibliotekat më në zë për pasurimin e fondeve, duke u vlerësuar si ndër më të rëndësishme në Ballkan për llojin e vet.

Duke qene pjese e sistemit COBBISS.NET, qysh prej 2013, Biblioteka Shkencore “Mentor Petrela” ka filluar hedhjen e te dhenave bibliografike dhe krijimin e katalogut online. Perdoruesi mund te kete informacion kudo dhe kurdo per literaturen shkencore qe gjendet ne kete biblioteke. Nje arritje e bibliotekes eshte dhe perfitimi i burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library). Biblioteka Shkencor “Mentor Permeti” duke qene anetare e Konsorciumit te Bibliotekave Shqiptare ka siguruar akses ne burime elektronike, si JSTOR: <https://www.jstor.org>; IOPSCIENCE <https://www.eifl.net/e-resources/iopscience>; <https://journals.biologists.com/dev>; <https://journals.biologists.com/jcs> ; <https://journals.biologists.com/jeb>

Nga analizat e zhvilluara në departamente, por dhe nga situata që konstatojmë si pasojë e ndjekjes së vazhdueshme të problematikave, informojmë se infrastruktura mësimore, që është detyrë dhe përgjegjësi direkte e stafit akademik, rezulton të jetë përgjithësisht e mirë.

Në përgjithësi nevojat e procesit mësimor dhe të studentëve me materiale didaktike janë të mbuluara mirë. Tekste, leksione në ppt, detyra, ushtrime dhe informacione të ndryshme, skripte të nevojshme për studentët, etj. janë të depozituara në librarinë e UBT si dhe një pjesë e tyre ju dërgohen elektronikisht studentëve. Më poshtë paraqiten disa të dhëna konkrete të grumbulluara nga departamentet mbi mbulimin e moduleve me tekste dhe skripte të depozituara pranë departamenteve, bibliotekës si dhe librarisë.

FMV

Të gjitha lëndët e ofruara nga lektorët e FMV-së janë të pajisura me tekste mësimore ose cikle leksionesh të miratuara nga Departamentet përkatëse, të cilat u vihen në dispozicion studentëve si literaturë bazë. Përmbajtja mësimore e këtyre lëndëve përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet angazhimit profesional të lektorëve, duke reflektuar zhvillimet më të fundit shkencore dhe akademike të fushave përkatëse. Këto përditësime transmetohen rregullisht gjatë procesit të mësimdhënies dhe shoqërohen me materiale shtesë që pasurojnë më tej përvojën mësimore të studentëve.

Materialet e depozituara në Librarinë Universitare janë në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të pedagogëve të moduleve, të cilët duhet të sigurojnë që vetëm materialet e miratuara në programet mësimore dhe nga Departamenti të kalojnë për përdorim zyrtar. Në zbatim të planit të masave të përcaktuar nga drejtuesit e institucionit, një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve të FMV-së kanë furnizuar edhe bibliotekën e Fakultetit me tekste të nevojshme, me synimin për të garantuar akses të gjerë dhe të barabartë në literaturë, si dhe për të mbështetur në mënyrë sa më efektive procesin e mësimnxënies

FSHP

Fakulteti i Shkencave Pyjore siguron mbështetje të plotë didaktike për të gjithë studentët e programeve të tij të studimit. Për të gjitha lëndët e kurrikulës ofrohen skripte, materiale ndihmëse dhe leksione të shkruara të përditësuara nga stafi akademik. Për një pjesë të moduleve janë të

disponueshme edhe tekste mësimore të botuara, të cilat u vihen në dispozicion studentëve në formë fizike ose elektronike.

Në Departamentin e Industrisë së Drurit, 12 lëndë - nga të cilat 4 i përkasin formimit të përgjithshëm - mbulohen me tekste të mirëfillta mësimore, ndërsa pjesa tjetër mbulohet përmes skripteve, materialeve të përgatitura nga pedagogët dhe cikleve të strukturuar të leksioneve. Praktika e përgatitjes së teksteve nga burime individuale të stafit akademik ka qenë dominuese ndër vite, por vlerësohet se kjo qasje duhet të evoluojë drejt botimit institucional të teksteve, me qëllim garantimin e cilësisë, unifikimit metodologjik dhe aksesueshmërisë për të gjithë studentët. Një rekomandim i rëndësishëm mbetet financimi institucional i botimit të teksteve bazë, si dhe përkthimi i literaturës së huaj bashkëkohore, veçanërisht në disiplinat ku mungojnë tekste të standardizuara në gjuhën shqipe. Kjo nismë do të sillte një rritje të dukshme të cilësisë së përmbajtjes akademike.

Megjithatë, në mungesë të teksteve të botuara, shumica e lëndëve vazhdojnë të mbulohen në mënyrë të plotë nga skripte apo leksione të shkruara. Problematikë e vazhdueshme mbetet **nevoja për përmirësim periodik të skripteve dhe ristrukturimi i tyre sipas standardeve bashkëkohore të didaktikës**, pasi procesi i përditësimit shpesh mbetet spontan dhe jo i lidhur me mekanizma institucionale.

Në këtë drejtim, është e domosdoshme që:

- departamentet të hartojnë plane vjetore për rishikimin dhe përditësimin e materialeve didaktike;
- procesi të jetë i organizuar dhe i monitoruar institucionalisht;
- skriptet dhe leksionet të përmirësohen në përputhje me zhvillimet e shkencës, tregut të punës dhe inovacionit teknologjik.

Këto masa do të garantonin rritjen e cilësisë së mësimdhënies, harmonizimin e përmbajtjes ndërmjet lëndëve, si dhe një mbështetje të konsoliduar akademike për studentët e Fakultetit të Shkencave Pyjore.

FBU nuk kane dhene informacion.


5. STAFI AKADEMIK

5.1 Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.

UBT-ja është e organizur në 5 Njësi Kryesore (Fakultete) dhe një Institut.

Organizimi i UBT është në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

Organigrama e UBT është:




Cilësia e mësimdhënies në UBT është ngushtësisht e lidhur me kualifikimin e stafit akademik me kohë të plotë.

Në pikat e forta të UBT-së cilësia e stafit akademik zë vend të rëndësishëm, sepse UBT ka:

- Staf akademik të kualifikuar me nivel të lartë ekspertize dhe eksperiencë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Stafi akademik ka eksperiencë studimi/kërkimi shkencor në universitetet perëndimore si dhe vazhdon të ketë kontakte dhe bashkëpunime.
- Stafi i ri akademik, asistent lektorët po zhvillojnë studimet e doktoraturës në universitet më të mira në BE, USA etj.


Gjatë vitit akademik 2024-2025 janë angazhuar në procesin e mësimdhënies 282 staf akademik me kohë të plotë dhe realizuan 66712 orë mësimore në auditor. Gjithashtu, janë angazhuar në mbështetje të procesit mësimor edhe 73 staf ndihmës akademik dhe 39 staf administrativ. Në procesin mësimor gjatë këtij viti akademik u angazhuan edhe 49 Staf akademik i ftuar. Referuar kualifikimit të stafit akademik dhe kërkimor-shkencor në UBT dhe sipas fakulteteve situata në vitin akademik 2024-2025 paraqitet si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik dhe kërkimor-shkencor në UBT 2024-2025



Aktualisht:

Në UBT janë 49 Asistentë Lektorë ose 18 % e totalit, 60 lektorë ose 22 % e totalit, 95 Prof.Assoc ose 35% dhe 70 Profesor ose 25 %. Përparësi për strukturat drejtuese të UBT-së ka qenë freskimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik edhe gjatë vitit akademik 2024-2025.



Burimi: Analizat mësimore të Njërive Kryesore , Dhjetor 2025.

Struktura organizative sipas Fakulteteve


Struktura / Njesia	Prof	Prof.As.	Lektor	Asistent Lektor	Ndihmës Akademik	Akademik i ftuar	Administrativ
FEA	11	44	17	15	8	36	12
FBM	33	16	15	19	34	6	10
FSHP	5	8	7	7	8	5	6
FBU	4	14	13	4	10	2	3
FMV	17	13	8	4	13	0	8
UBT	70	95	60	49	73	49	39


Burimi: Analizat Mësimore të Njësive Kryesore, Dhjetor 2025.

5.2 Angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 në procesin mësimor janë angazhuar 282 staf akademik me kohë të plotë i cili ka realizuar në total 66712 orë

Stafi i brendshëm i angazhuar në mësimdhënie sipas fakulteteve, realizimi, norma dhe mbinorma janë si më poshtë:





Angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që ka zhvilluar secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik është pasqyruar në formë tabelare, sipas fakulteteve në analizat mesimore të Njesive Kryesore. *Tabela nr 5 Për angazhimin e personelit akademik*

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga Fakultetet në DVBSC mbi planifikimin e ngarkesës mesimore dhe realizimin e ngarkesës mësimore në auditor për vitin akademik 2024-2025 rezultojnë:

1. Stafi akademik i brendshëm i UBT ka realizuar mbi 95 % të ngarkesës mësimore totale të planifikuar në auditor.
2. Janë realizuar 28944 orë mësimore mbinormë që rezultojnë 2631 orë me pak se 2023-2024, nga të cilat janë paguar 27938 orë ose 96.5% e totalit. *Vihet re një fakt, që programet mësimore me numër më të madh të studentëve (me numër më të madh grupesh mësimore) kanë rezultuar me ulje më të madhe të orëve mësimore të realizuara (normë + mbinormë) kundrejt programeve mësimore me numër të vogël studentesh (me 1 grup mësimor).*


Treguesi Ore/Pedagog në UBT dhe sipas Fakulteteve, 2024-025

Ngarkesa mesimore në auditor UBT				
Fakulteti	Ngarkesa mesatare për pedagogë (orë/pedagog) 2022-2023	Ngarkesa mesatare për pedagogë (orë/pedagog) 2023-2024	Pedagoge (Numër)	Ngarkesa mesatare për pedagogë (orë/pedagog) 2024-2025
FBM	327	295	90	206
FEA	241	174	88	289
FSHP	305	260	27	219
FBU	235	194	35	243
FMV	212	181	42	196
UBT	241	225	282	237

6. STUDENTËT DHE GJURIMI I TYRE

6.1 Të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit dhe treguesit

Gjatë vitit akademik 2024-2025, në UBT kanë qenë 6064 studentë aktive të cilët kanë zhvilluar studimet në të tre Ciklet e Studimit. Shpërndarja e studenteve sipas programeve të studimit dhe sipas fakulteteve është si më poshtë:



Numri me i madh i studentëve janë në Ciklin e Parë të studimeve (Bachelor) 3274 studentë ose 54% e totalit. Në Ciklin e Dytë të studimeve (Msc +MP+DIND) kanë kryer studimet 2054 studentë ose 34%. Në Ciklin e tretë (ME +PHD) 4% dhe në Programe Profesionale 2 vjeçare 8%.

Studentët Aktivë sipas programeve të studimit dhe Fakulteteve 2024-2025:

Studentë aktive sipas cikleve të studimit								
	Prog.prof. 2-vjeçar	Bachelor	Msc	MP	DIND	ME / SP	Ph.D	Totali
FEA	181	2015	224	461	0	51	82	3014
FBM	261	580	367	172	0	0	46	1426
FBU	0	416	142	107	0	0	20	685
FSHP	0	263	40	23	0	0	0	326
FMV	67	0	0	0	518	12	16	613
UBT_TOTAL	509	3274	773	763	518	63	164	6064

Treguesi Studentë/Pedagog në UBT dhe sipas Fakulteteve 2024-2025:


Treguesi Pedagog/Studente, UBT					
Fakulteti	Studentë/Pedagog (2022-2023)	Studentë/Pedagog (2023-2024)	Pedagogë (Numër) (2024-2025)	Totali studentë Nr (2024-2025)	Studentë/Pedagog (2024-2025)
FBM	17.6	16.6	90	1426	15.8
FEA	31.3	33.5	88	3014	34.3
FSHP	12.8	12.2	27	326	12.1
FBU	21.2	21.1	35	685	19.6
FMV	14.6	14.9	42	613	14.6
UBT	21.3	21.5	282	6064	21.5

Ecuria e regjistrimeve në vite në UBT është si më poshtë:

Viti akademik	Kuota plan	Regjistruar	Kuota të lira	Realizimi (%)
2016-2017	1614	1535	79	95%
2017-2018	1901	1588	313	84%
2018-2019	2186	1572	614	72%
2019-2020	1794	1376	418	77%
2020-2021	1907	1283	624	67%
2021-2022	2049	1242	807	60%
2022-2023	1805	1170	635	65%
2023-2024	1789	1206	583	67%
2024-2025	1410	900	510	64%
2025-2026	1035	824	211	80%

Studentet e diplomuar

Gjatë vitit akademik 2023-2024 janë diplomuar 1557 studentë, ndërsa gjatë vitit akademik 2024-2025 janë diplomuar 1532 studentë (25 më pak sesa vitin e kaluar).



Fakulteti	Diplomë Profesionale	Bachelor	Master Profesional	Master i Shkencave	DIND	Totali
FEA	50	493	198	63	0	804
FBM	41	123	59	85	0	308
FBU	0	94	82	41	0	217
FSHP	0	61	14	10	0	85
FMV	19	0	0	0	99	118
UBT	110	771	353	199	99	1532

Të dhënat e detajuara për studentët sipas fakulteteve janë pasqyruar në Analizat Mësimore të Njësive Kryesore dhe në menyrë të permblledhur janë sa me poshtë:

FEA

i. Të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

Në vitin akademik 2024 - 2025 regjistrimet patën një rënie në të gjitha ciklet e studimit. Përkatësisht plotësimi i kuotave për vitin akademik 2024-2025 në ciklin e parë Bachelor dhe programet profesionale 2 vjeçare rezultoi në nivelin 78%, ndërkohë në ciklin e dytë Master Profesional dhe Shkencor rezultoi në nivelin 62%.

Gjatë këtij viti akademik numri i përgjithshëm i studentëve në FEA është 3074 (Tabela nr. 6) në të gjitha ciklet e studimit, ku studentë përsëritës janë 904.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 janë diplomuar në total 824 studentë të shpërndarë sipas cikleve të studimit janë përkatësisht: 50 studentë në programet profesionale dy vjeçare, 493 studentë në ciklin e parë të studimit Bachelor, 216 në ciklin e dytë të studimit Master Profesional, 63 në ciklin e dytë të studimit Master Shkencor dhe 2 në ciklin e tretë Master Ekzekutiv (Tabela nr.12).

ii. Të dhëna mbi numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.

Sa i takon programeve prioritet kombëtar bëjmë me dije që për vitin akademik 2024-2025 asnjë nga programet e FEA-s nuk ishte në listen e programeve prioritare.

iii. Të dhëna mbi numrin e studentëve të shkëlqyer

Nga analizat e bëra vit mbas viti vihet re një rënie e moderuar e nivelit të mesatares së pranimeve të studentëve (edhe pse ajo është mjaft e ndryshme nga programi në program). Megjithkëtë ne vlerësojmë se FEA pranon studentët më të mirë në nivel UBT-je në programet e saj të studimit një pjesë e të cilëve edhe falë punës impenjative dhe serioze të stafit si edhe padyshim përpjekjeve të tyre individuale, vijojnë të ruajnë rezultate shumë të mira. Kësisoj vlerësojmë se gjatë vitit akademik 2024-2025 në FEA ka pasur 58 studentë të shkëlqyer që kanë plotësuar me vleresimet e tyre kriteret që përcakton regullorja për të qenë të tillë (Tabela nr. 6).

Informacione më të detajuara në lidhje me sa më sipër jepen në tabelat e parqitura në vijim.

Tabela nr 6 Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve.

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit	Cikli i Programit të Studimit	Është program prioritar apo jo (shënohet “prioritar” dhe “jo prioritar”)	Nr.studentësh të regjistruar (përfshirë edhe studentet perserites)	Nr.studentësh të shkëlqyer	Nr.studentësh përsëritës
1	FEA	Menaxhim Sistemesh Informacioni	Program Profesional 2 vjeçar	jo prioritar	85	0	26
2	FEA	Agroturizëm dhe Mikpritje	Program Profesional 2 vjeçar	jo prioritar	100	0	41
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	jo prioritar	393	1	148
4	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural	Bachelor	jo prioritar	312	1	156
5	FEA	Financë-Kontabilitet	Bachelor	jo prioritar	441	26	89
6	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural	Bachelor	jo prioritar	240	1	117
7	FEA	Informatikë Biznesi	Bachelor	jo prioritar	349	18	65
8	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	Bachelor	jo prioritar	343	3	98
9	FEA	Menaxhim Agrobiznesi profili "Administrim i Ndërmarrjeve"	Master i Shkencave	jo prioritar	19	0	7
10	FEA	Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital Diplomë e Dyfishtë (Duale) me Universiteti shtetëror i studimeve të Tuscias (UNITUS)	Master i Shkencave	jo prioritar	26	0	11
11	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare) Diplomë e Dyfishtë (Duale) me Universiteti shtetëror i	Master i Shkencave	jo prioritar	42	2	13

		studimeve të Tuscias (UNITUS)					
12	FEA	Financë-Kontabilitet	Master i Shkencave	jo prioritar	82	4	17
13	FEA	Informatike Biznesi	Master i Shkencave	jo prioritar	46	0	6
14	FEA	Menaxhimi i Ndërmarrjeveme profil "Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"	Master Profesional	jo prioritar	67	0	19
15	FEA	Ekonomi dhe Politikë Agrare me profil "Ekonomi dhe Politikë Agrare"	Master Profesional	jo prioritar	58	0	11
16	FEA	Financë Bankë	Master Profesional	jo prioritar	105	0	9
17	FEA	Kontabilitet dhe Auditim	Master Profesional	jo prioritar	142	2	26
18	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural	Master Profesional	jo prioritar	50	0	10
19	FEA	Menaxhim Informacioni në Agrobiznes	Master Profesional	jo prioritar	33	0	6
20	FEA	Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Territorial i Zonave Rurale	Master Ekzekutiv	jo prioritar	51	0	29
21	FEA	Ekonomi dhe Agrobiznes	Doktrorate	jo prioritar	82	0	0
22	FEA	Sipermarrje dhe Inovacion en Ekonomi Cirkulare (Diplomë e perbashkë)	Master Profesional	jo prioritar	8	0	0
		T O T A L I			3074	58	904

i) **numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar, të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;**

Gjatë vitit akademik 2024-2025 janë ç'regjistruar 56 studentë në total. Shpërndarja e tyre sipas programeve të studimit jepet në tabelën e mëposhtme (Tabela nr. 7). Kërkesat e studentëve për çregjistrim bëhen pranë sekretarisë, por formulari që ata plotësojnë nuk kërkon të specifikohet arsyeja e kësaj kërkesë, ndaj mungon informacioni për numrin e studentëve të transferuar, programet ku transferohen dhe IAL përkatëse. Ky boshllëk mbetet për tu korigjuar në vitin e ardhshëm.

Tabela nr. 7 Mbi numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar.

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit të parë	Cikli i Programit të Studimit	Nr. studentësh të çregjistruar	Nr. studentësh të transferuar	Programi i Studimit ku transferohet	Intistucioni i Arsimit të Lartë ku transferohet
1	FEA	Menaxhim Sistemesh Informacioni	Program Profesional 2 vjecar	1	NA	NA	NA
2	FEA	Agroturizëm dhe Mikpritje	Program Profesional 2 vjecar	1	NA	NA	NA
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	10	NA	NA	NA
4	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural	Bachelor	7	NA	NA	NA
5	FEA	Financë-Kontabilitet	Bachelor	14	NA	NA	NA
6	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural	Bachelor	6	NA	NA	NA
7	FEA	Informatikë Biznesi	Bachelor	1	NA	NA	NA
8	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	Bachelor	5	NA	NA	NA
9	FEA	Menaxhim Agrobiznesi profili "Administrim i Ndërmarrjeve"	Master i Shkencave	0	NA	NA	NA
10	FEA	Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital	Master i Shkencave	0	NA	NA	NA
11	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare)	Master i Shkencave	0	NA	NA	NA
12	FEA	Financë-Kontabilitet	Master i Shkencave	2	NA	NA	NA
13	FEA	Informatike Biznesi	Master i Shkencave	0	NA	NA	NA
14	FEA	Menaxhimi i Ndërmarrjeve i profil "Menaxhimi i Ndërmarrjeve Agrobiznesit"	Master Profesional	1	NA	NA	NA

15	FEA	Ekonomi dhe Politikë Agrare me profil "Ekonomi dhe Politikë Agrare"	Master Profesional	2	NA	NA	NA
16	FEA	Financë Bankë	Master Profesional	2	NA	NA	NA
17	FEA	Kontabilitet dhe Auditim	Master Profesional	3	NA	NA	NA
18	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural	Master Profesional	0	NA	NA	NA
19	FEA	Menaxhim Informacioni ne Agrobiznes	Master Profesional	0	NA	NA	NA
20	FEA	Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Territorial i Zonave Rurale	Master Ekzekutiv	1	NA	NA	NA
21	FEA	Sipermarrje dhe Inovacion ne Ekonomi Cirkulare	Master Profesional	0	NA	NA	NA

- ii) numrin e studentëve, që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;

Bashkangjitur tabela për numrin e studentëve që përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi përjashtim/reduktim nga tarifat dhe bursë studimi nga fondi i mbështetjes studentore.

Tabela nr 8: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kritereve.

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i studentëve të pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.	Numri i studentëve të regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 deri në 10, të vitit paraardhës akademik të përlogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë.	Numri i studentëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	Numri i studentëve bashkëshortë që kanë fëmijë (përfiton secili bursë)	Numri studentëve, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	Numri i studentëve që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	Numri i i studentëve që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;	Numri i studentëve, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë	Numri i studentëve që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç	Numri i studentëve që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;	Numri i studentëve që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç	Numri i studentëve që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
1	FEA	Ekonomi dhe Politika të Zhvillimit Rural	Bachelor	0	1	8		1			1				
2	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	Bachelor	0	2	16		1	2	2	2				
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	1	1	17		1							1
4	FEA	Informatik-Biznesi	Bachelor	18	6	12		1	1	2					
5	FEA	Financë-kontabilitet	Bachelor	15	10	17		2		3	2	1			
6	FEA	Menaxhim Turiz.Rural	Bachelor	1	0	15		1		2					
7	FEA	Agroturizëm dhe Mikpritje	2-vjecar	0	0	10		1				1			
8	FEA	Menaxhim Sistemes Informaconi	2-vjecar	0	0	11		2							
Shuma				35	20	106	0	10	3	9	5	2	0	0	1

Tabela nr 9: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që paguajnë tarifë (50% ose 100%) sipas VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (përditësuar) të ndarë sipas kritereve.

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i studentëve që pranohen në studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifë në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet VKM, Nr. 288, datë 21.05.2018.	Numri i studentëve që rezultojnë me notë mesatare më të madhe ose të bababartë me 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifë në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet VKM, Nr. 288, datë 21.05.2018.	Numri i studentëve që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifën e plotë të studimit sipas vlerave të pasqyruara në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet VKM, Nr. 288, datë 21.05.2018.
1	FEA	Ekonomi dhe Politika të Zhvillimit Rural	Bachelor	44	37	239
2	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	Bachelor	77	55	183
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	62	43	261
4	FEA	Informatik-Biznesi	Bachelor	76	92	138
5	FEA	Finance-kontabilitet	Bachelor	92	92	175
6	FEA	Menaxhim Turiz.Rural	Bachelor	23	38	161
7	FEA	Agroturizem dhe Mikpritje	2-vjekar	25	3	58
8	FEA	Menaxhim Sistemes Informaconi	2-vjekar	25	10	41
Total				424	370	1256

Tabela nr. 10: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017 (përditësuar) të ndarë sipas kriterëve

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i i studentëve të pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi i arsimit	Numri i studentëve të regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet	Numri i studentëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	Numri i studentëve bashkëshortë që kanë fëmijë (përfshatohet secili nga tarifat)	Numri i studentëve, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë	Numri i studentëve, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni	Numri i studentëve që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;	Numri i studentëve, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të	Numri i studentëve që kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç	Numri i studentëve që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në	Numri i studentëve që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfutur statusin	Numri i studentëve që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për	Numri i studentëve romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit;	Numri i studentëve, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie
1	FEA	Ekonomi dhe Politika të Zhvillimit Rural	Bachelor	0	1	8		1	4		1						
2	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	Bachelor	0	2	16		1	13	2	2						
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	1	1	17		1	7						1		1
4	FEA	Informatik-Biznesi	Bachelor	18	6	12		1	7	2							
5	FEA	Finance-kontabilitet	Bachelor	15	10	17		2	13	3	2	1					
6	FEA	Menaxhim Turiz.Rural	Bachelor	1	0	15		1	5	2							
7	FEA	Agroturizem dhe Mikpritje	2-vjecar	0	0	10		1	3			1					

8	FEA	Menaxhim Sistemesh Informaconi	2-vjecar	0	0	11		2	1								
		TOTALI		35	20	106	0	10	53	9	5	2	0	0	1	0	1

Tabela nr.11: Mbi numrin e studentëve të ciklit të dytë që paguajnë tarifë (50 %) të ndarë sipas kriterëve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i studentëve me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve	Numri i studentëve, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm	Numri i studentëve, që kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	Numri i studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatës të	Numri i studentëve deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe të qenieve njerëzore të shfrytëzuara	Numri i studentëve fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të	Numri i studentëve romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për
1	FEA	Menaxhim Agrobiznesi profili "Administrim i Ndërmarrjeve"	Master i Shkencave	1	1					
2	FEA	Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital	Master i Shkencave	1						
3	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomi Cirkulare)	Master i Shkencave							
4	FEA	Financë-Kontabilitet	Master i Shkencave	3	1					
5	FEA	Informatike Biznesi	Master i Shkencave	1	2					

6	FEA
7	FEA
8	FEA
9	FEA
10	FEA
11	FEA
12	

Menaxhimi i Ndërmarrjeve me profil "Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"	Master Profesional	2	2	1				
Ekonomi dhe Politikë Agrare me profil "Ekonomi dhe Politikë Agrare"	Master Profesional		1					
Financë Bankë	Master Profesional	9	4					
Kontabilitet dhe Auditim	Master Profesional	7	1	5				
Menaxhim i Turizmit Rural	Master Profesional	1						1
Menaxhim Informacioni në Agrobiznes	Master Profesional	1						
Sipermarrje dhe Inovacion ne Ekonomi Cirkulare,	Master Profesional							
TOTALI		26	12	6	0	0	0	1

a. Të dhëna të përgjithshme mbi gjurmimin e studentëve, që kanë përfunduar studimet në vitet e mëparshme

Zyra e karrierës mbikqyr përpilimin, plotësimin dhe përditësimin e Skedës së Punësimit për studentët e nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor. Kjo skedë plotësohet nga studentët para se të tërheqin diplomat. Në tabelën nr. 12 jepet informacion për numrin e studentëve të diplomuar në vitin akademik 2024-2025. Të dhënat e gjurmimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme, janë marrë nga informacioni që studentët vetdeklarojnë në skedë. Duke qënë se plotësimi i saj bëhet kryesisht në periudhën Nëntor - Dhjetor këto të dhëna nuk janë akoma të disponueshme për studentët e diplomuar në vitin akademik 2024-2025, ndaj në mungese të informacionit të gjurmimit për studentët e sapo diplomuar, vlerësimet e përqindjeve për punësimin apo jo të studentëve si dhe sektorët ku ata janë të punësuar u morën nga gjurmimi i studentëve të diplomuar në vitin 2023-2024. Nga të dhënat e grumbulluara vihet re se përqindja më e lartë e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimit bachelor të punësuar është në programet e studimit Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural, Informatikë Biznesi dhe Finance Kontabilitet ndërkohë që problematikë është punësimi i studentëve të Menaxhimit të turizmit Rural. Në ciklin e dytë të studimit Master Profesional, niveli i punësimit është më i lartë është për studentët që mbarojnë në programet e studimit “Financë Bankë” ose “Kontabilitet Auditim”, ndërkohë që në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor niveli më i lartë i punësimit është në programin e studimit Informatike Biznesi dhe Finance Kontabilitet. Ndërkohë që përse i përketë sektorit të punësimit vihet re se ata janë të punësuar kryesisht në sektorin privat.

FBM

Në FBM gjatë vitit akademik 2024-2025, ka patur 195 studentë të cilët kanë ndjekur studimet e tyre në 6 (gjashtë) programe që përbëjnë prioritet kombëtar në ciklin e parë të studimeve bachelor. Konkretisht të vlerësuara si programe studimi prioritare janë: Mbrojtje Bimësh, Hortikulturë, Agronomi, Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale, Agromekanizim si dhe Biologji Marine dhe Akuakulturë. Numri më i lartë i studentëve ndërmjet këtyre programave të studimit rezulton në programin e studimit bachelor në Mbrojtje e Bimeve (63 studentë, Tabela 6).

Tabela nr 6. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve në FBM .


Nr	Emërtimi i Programit të Studimit	Cikli i Programit të Studimit	Është program prioritar apo jo (shënohet “prioritar” dhe “jo prioritar”)	Nr.studentësh të regjistruar (përfshirë edhe studentet perserites)	Nr.studentësh të shkëlqyer	Nr.studentësh përsëritës
1	Inxhinier i Agromjedisit	Bachelor	Jo Prioritar	193	0	114
2	Menaxhim i Burimeve Natyrore	Bachelor	Jo Prioritar	88	0	53
3	Mbrojtje Bimesh	Bachelor	Prioritar	63	3	24

4	Hortikulture	Bachelor	Prioritar	32	0	27
5	Agronomi	Bachelor	Prioritar	59	1	27
6	Zootečni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Bachelor	Prioritar	0	0	10
7	Biologji Marine dhe Akuakulture	Bachelor	Prioritar	12	0	4
8	Arkitekturë Peizazhi	Bachelor	Jo Prioritar	108	1	51
9	Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit	Program 2 Vjeçar	Jo Prioritar	30	0	19
10	Zooveterinari	Program 2 Vjeçar	Jo Prioritar	27	0	16
11	Kopshtari	Program 2 Vjeçar	Jo Prioritar	52	0	25
12	Teknolog Bujqesor	Program 2 Vjeçar	Jo Prioritar	114	0	30
13	Agromekanizem	Bachelor	Prioritar	29	0	25
14	Inxhinier i Agromjedisit	Master i Shkencave	Jo Prioritar	61	0	24
15	Menaxhim i Burimeve Natyrore	Master i Shkencave	Jo Prioritar	43	0	19
16	Mjekësi Bimore	Master i Shkencave	Jo Prioritar	69	2	40
17	Hortikulturë	Master i Shkencave	Jo Prioritar	8	0	6
18	Shkencat Agronomike	Master i Shkencave	Jo Prioritar	46	3	14
19	Zootečni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Master i Shkencave	Jo Prioritar	17	0	6
20	Akuakulturë	Master i Shkencave	Jo Prioritar	4	0	3
21	Energjite e Rinovueshme	Master i Shkencave	Jo Prioritar	52	2	28
22	Arkitekture Peizazhi	Master i Shkencave	Jo Prioritar	49	0	20
23	Teknologjite e Avancuara ne Hortikulture (1 Vjeçar)	Master Profesional	Jo Prioritar	16	2	7
24	Mbrojtja Kimike dhe Fitofarmacia	Master Profesional	Jo Prioritar	46	1	12
25	Menaxhim Mjedisit	Master Profesional	Jo Prioritar	64	0	25
26	Zhvillim Rural dhe Mjedisor i Qendrueshëm	Master Profesional	Jo Prioritar	31	0	0
27	Arkitekture Peizazhi	Master Profesional	Jo Prioritar	0	0	13
28	Shencat Mjedisore	Doktorate	Jo Prioritar	25	0	0
TOTALI				1338	15	642


Burimi: Zyra e Shërbimeve Studentore të UBT-së

Mbi numrin e studentëve të shkëlqyer

Në FBM nga të dhënat e siguruar prej Zyrës së Shërbimeve Studentore të UBT-së, rezultojnë të regjistruar në programet e ciklit të parë Bachelor 584 studentë (335 përsëritës), nga të cilët 4 me rezultate të shkëlqyera. Në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” rezultojnë 349 studentë (160 përsëritës) dhe 7 prej tyre me rezultate të shkëlqyera, në programet “Master Profesional” ka 157 studentë (57 përsëritës) dhe 3 prej tyre me rezultate të shkëlqyera, ndërkohë në programet profesionale dy vjeçare të ofruara nga FBM rezultojnë 223 studentë (90 përsëritës) (Tabela 6).



(a)



(b)

Figura 5: Mbi studentët e rregjistruar, (a) të shkëlqyer dhe ata (b) përsëritës në programet e studimit të FBM-së gjatë 2024-2025

Numri total i përsëritësve është rritur ndjeshëm (gati 25%) nga viti akademik 2023-2024. Rritja më e lartë në përqindje është:

- Master Profesional (+39%) dhe Programet Profesionale 2-vjeçare (+36%)
- Programi Bachelor ka rritje të fortë relative (+28%).
- Master i Shkencave ka rritjen më të ulët (+8.8%), por sërish pozitive.

Tendenca tregon rritje të përgjithshme të përsëritjes së viteve/lëndëve, që mund të lidhet me faktorë akademikë, organizativë, ose nivel përgatitjeje të studentëve.

Mbi numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 referuar të dhënave të Zyrës së Shërbimeve Studentore të UBT-së, rezultojnë të çregjistruar gjithësej 26 studentë, prej të cilëve 15 të çregjistruar në ciklin e parë të studimeve Bachelor, 3 studentë të çregjistruar në ciklin e dytë të studimeve Masteri i Shkencave, 2 studentë të çregjistruar nga Master Profesional dhe 5 studentë nga Programi Profesional dy vjeçar. Gjatë këtij viti akademik nuk rezulton asnjë student i transferuar në programe të tjera studimi në UBT apo dhe kundrejt IAL-ve të tjera (Tabela 7).

Tabela nr 7. Mbi numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar në FBM, viti akademik 2024-2025

Nr	Emërtimi i Programit të Studimit të parë	Cikli i Programit të Studimit	Nr. studentësh të çregjistruar
1	Inxhinier i Agromjedisit	Bachelor	4
2	Menaxhim i Burimeve Natyrore	Bachelor	1
3	Mbrojtje Bimesh	Bachelor	4
4	Hortikulture	Bachelor	2
5	Agronomi	Bachelor	0
6	Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Bachelor	1
7	Biologji Marine dhe Akuakulture	Bachelor	0
8	Arkitekturë Peizazhi	Bachelor	3

9	Zooveterinari	Program 2 Vjeçare	1
10	Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit	Program 2 Vjeçare	4
11	Kopshtari	Program 2 Vjeçare	0
12	Teknolog Bujqesor	Program 2 Vjeçare	0
13	Agromekanizem	Bachelor	0
14	Inxhinier i Agromjedisit	Master i Shkencave	0
15	Menaxhim i Burimeve Natyrore	Master i Shkencave	0
16	Mjekësi Bimore	Master i Shkencave	1
17	Hortikulturë	Master i Shkencave	0
18	Shkencat Agronomike	Master i Shkencave	0
19	Zooteknit dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Master i Shkencave	1
20	Akuakulturë	Master i Shkencave	0
21	Energjite e Rinovueshme	Master i Shkencave	1
22	Arkitekture Peizazhi	Master i Shkencave	0
23	Teknologjite e Avancuara ne Hortikulture (1 Vjeçar)	Master Profesional	0
24	Mbrojtja Kimike dhe Fitofarmacia	Master Profesional	1
25	Menaxhim Mjedisit	Master Profesional	0
26	Zhvillim Rural dhe Mjedisit i Qendrueshëm	Master Profesional	1
27	Arkitekture Peizazhi	Master Profesional	0
28	Shencat Mjedisore	Doktorate	1
	TOTALI		26

Burimi: Zyra e Shërbimeve Studentore të UBT-së

Figura 6 tregon të dhënat krahasuese mbi numrin e studentëve të çregjistruar gjatë viteve akademike 2023–2024 dhe 2024–2025, të ndarë sipas cikleve të programeve të studimit (referuar ZSS, UBT). Numri i përgjithshëm i studentëve të çregjistruar ka shënuar një rritje nga 22 në vitin 2023–2024 në 25 në vitin 2024–2025. Kjo tregon një tendencë të lehtë rritjeje të braktisjeve, veçanërisht tek programet profesionale 2-vjeçare dhe Master Profesional, më konkretisht:

- Programi Bachelor ka çregjistrime të vazhdueshme, por të stabilizuara: 16 studentë u çregjistruan në vitin 2023–2024 ose 72.7% e çregjistrimeve, ndërsa 15 studentë u çregjistruan në vitin 2024–2025 ose 60% e çregjistrimeve për këtë vit akademik. Kjo tregon një stabilizim të lehtë të numrit të çregjistrimeve në këtë cikël, *megjithatë çregjistrimet mbeten relativisht të larta krahasuar me ciklet e tjera*.
- Programet profesionale 2-vjeçare tregojnë rritje të ndjeshme të braktisjes midis 2 viteve të fundit akademike nga 4.5% në 20%. Numri i studentëve të çregjistruar është rritur, duke sugjeruar një rritje të shqetësueshme të braktisjes së këtij programi.
- Çregjistrimet në programet Master mbeten relativisht të ulëta, por ka një rritje të vogël tek Master Profesional.
- Programet e ciklit të dytë (Master) kanë çregjistrime më të ulëta, duke treguar një angazhim më të madh të studentëve në këto programe: Ka një ulje të lehtë nga 4 studentë të çregjistruar në vitin 2023–2024 në 3 studentë në vitin 2024–2025, që tregon një stabilitet të moderuar në këtë cikël.
- Master Profesional: Numri i çregjistrimeve është rritur nga 1 në vitin 2023–2024 në 2 në vitin 2024–2025, që tregon një rritje të vogël të braktisjes.




Figura 6: Mbi numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar në FBM, viti akademik 2024-2025

Mbi numrin e studentëve, që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;

Përdorimi i **VKM nr. 903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kriterëve** në UBT dhe FBM është i rëndësishëm për të siguruar një menaxhim transparent dhe efektiv të bursave dhe mbështetjes financiare për studentët. Ky vendim ndihmon në motivimin e studentëve me rezultate të larta akademike, duke nxitur ruajtjen e performancës së mirë dhe konkurrencën pozitive, ndërsa njëkohësisht garanton qasje të barabartë për studentët në nevojë ekonomike, ata me aftësi të kufizuara dhe raste të veçanta sociale, duke ulur rrezikun e braktisjes së studimeve dhe promovuar përfshirjen sociale. Për institucionet e arsimit të lartë, VKM 903 mundëson planifikim të drejtë të fondeve, përmirësim të politikave mbështetëse dhe harmonizim të praktikave të brendshme me standardet kombëtare, duke rritur suksesin akademik, motivimin dhe aksesin e barabartë në arsimin e lartë.

Numri i studentëve të pranuar në vitin e parë akademik 2024-2025 në FBM, në programet e studimeve profesionale dhe programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor, të cilët përfitojnë bursë sipas **VKM nr. 903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kriterëve**, rezultojnë gjithësej 46, prej të cilëve me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë në programet bachelor rezultojnë 3, dhe 0 në programet e studimeve profesionale.

Gjatë 2024-2025 në FBM janë **31** studentë të cilët përfitojnë bursë nga kategoria familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.

Numri studentëve, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar është gjithësej **10**.

Numri i i studentëve të kategorisë së bursës që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton është **1**.

Në kategorinë që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar ka vetëm **1** student.



Figura 7: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas **VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar)** të ndara sipas kriterëve (Tabela 8).

VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (të përditësuar), i ndarë sipas qëllimit dhe kriterëve që vendimi përfshin, përcakton sa duhet të paguajnë studentët për studimet në institucionet publike të arsimit të lartë — duke vendosur një “kufij maksimal” tarife, dhe më pas, përmes ndryshimeve, vendosi që studentët e ciklit të parë të paguajnë vetëm 50% të tarifës, me pjesën tjetër të subvencionuar nga shteti; ndërkohë, vendosh kushte për cilësinë akademike (mesatare minimale për të mos paguar tarifë të plotë). Kjo politikë është e rëndësishme sepse lehtëson aksesin në arsimin e lartë, ndihmon studentët dhe familjet ekonomike, nxit përpjekje akademike dhe siguron menaxhim buxhetor dhe transparencë për universitetet publike.

Referuar të dhënave (Tabela 9) është **127** numri i studentëve që pranohen në studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, të cilët paguajnë tarifë në masën 50%. Numri më i lartë i studentëve në këtë kategori rezulton në programin profesional 2-vjeçar (68).

Janë **75** studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare më të madhe ose të bababartë me 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që paguajnë tarifë në masën 50%. Numri më i lartë i studentëve në këtë kategori rezulton në programin e studimit të ciklit të parë bachelor Arkitekturë Peizazhi (27) i pasuar nga Inxhinieri Agromjedisi (17) dhe ai më i ulti në programin profesional dy vjeçar Kopshtari (1).

Janë **428** studentë në FBM të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë,

paguajnë tarifën e plotë të studimit. Numri më i lartë i studentëve në këtë kategori rezulton në programin e studimit të ciklit të parë bachelor Inxhinieri Agromjedisi (127).

Bashkangjitur tabela për numrin e studentëve që përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi përjashtim/ reduktim nga tarifat dhe bursë studimi nga fondi i mbështetjes studentore.

Tabela nr 8: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas **VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kriterëve.**

Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Nr. i std të pranuar në vitin e I, me notë mes.	Nr. i std në vitet pas të parit, me notë mes. nga 9	Nr. i std, familje me ndihmë ekonomike	Nr. i std. bashkëshortë me fëmijë (përfiton secili	Nr. i std, me aftësi të kufizuara nga KMCAP.	Nr. i std, të dy prindërit me aftësi të kufizuara	Nr. Std. të dy prindërit pensionistë ose njërin	Nr. std. nga familje me tre fëmijë e më shumë.	Nr. std. me statusin e jetimit, deri në moshën	Nr. std. pa kujdestarinë prindërore, deri në	Nr. std. me statusin ligjor për trajtim si viktimë të	Nr. std. fëmijë të punonjëseve të Policisë së
			3	17	0	1	0	1					
Mbrojtje Bimesh	Bachelor		1										
Hortikulture	Bachelor												
Agronomi	Bachelor			3		1							
Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Bachelor												
Biologji Marine dhe Akuakulturë	Bachelor			1									
Inxhinier i Agromjedisit	Bachelor		1	6									
Agromekanizim	Bachelor												
Menaxhimi i Burimeve Natyrore	Bachelor			2									
Arkitekturë Peizazhi	Bachelor		1	5				1					
			0	14	0	9	1	0					
Zooveterinari	Program profesional 2-vjeçar			3									
Kopshtari	Program profesional 2-vjeçar			3		4							
Teknolog Bujqesor	Program profesional 2-vjeçar			6		4	1						
Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit	Program profesional 2-vjeçar			2		1							
			3	31	0	10	1	1					

Burimi: Sektori Menaxhimit Ekonomik dhe Financiar, FBM


Tabela nr 9: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që paguajnë tarifë (50% ose 100%) sipas **VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (përditësuar)** të ndarë sipas kritereve.

. Nr.	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i studentëve që pranohen në studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifë në masën 50%	Numri i studentëve që rezultojnë me notë mesatare më të madhe ose të bababartë me 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifë në masën 50%	Numri i studentëve që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, paguajnë tarifën e plotë të studimit
1	Mbrojtje Bimesh	Bachelor	4	4	35
2	Hortikulture	Bachelor	4	0	21
3	Agronomi	Bachelor	7	2	17
4	Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale	Bachelor		4	18
5	Biologji Marine dhe Akuakulturë	Bachelor	3	0	12
6	Inxhinier i Agromjedisit	Bachelor	15	17	127
7	Agromekanizim	Bachelor		0	14
8	Menaxhimi i Burimeve Natyrore	Bachelor	11	7	43
9	Arkitekturë Peizazhi	Bachelor	15	27	50
10	Zooveterinari 2-vjeçar	Program profesional 2-vjeçar	8	2	31
11	Kopshtari-2 vjeçar	Program profesional 2-vjeçar	7	1	22
12	Teknolog Bujqesor-2 vjeçar	Program profesional 2-vjeçar	44	8	34
13	Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit- 2 vjeçar	Program profesional 2-vjeçar	9	3	4
	Total		127	75	428

(Burimi: Sektori Menaxhimit Ekonomik dhe Financiar, FBM)

N r.	Fakulteti	Emërtimi i Programit të studimit	Lloji i programit të studimit	Numri i studentëve të pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimit eve profesionale, programet e ciklit të parë të studimit eve dhe programet e integruara të studimit eve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi arsimit mesëm të lartë.	Numri i studentëve të regjistruar në programet e studimit eve profesionale, programet e ciklit të parë të studimit eve dhe integruara të studimit eve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10, të vitit paraardhës	Numri i studentëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	Numri i studentëve bashkëshortë që kanë fëmijë (përfjashtohet secili nga tarifat)	Numri i studentëve, personat me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Përpunë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	Numri i studentëve, të cilët kanë, të paktën, njërin prindë person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Përpunë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	Numri i studentëve që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prindë pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;	Numri i studentëve, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë	Numri i studentëve që kanë humbur kujdesin prindëror me vendim gjykatës dhe formën e prerë, deri në moshën 25 vjeç;	Numri i studentëve që janë identifikuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	Numri i studentëve që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	Numri i studentëve romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit;	Numri i studentëve, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përmjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie	Studente dege prioritare	
1	Mjekësi Veterinare	Mjekësi Veterinare	PIC D	11	15	31	-	5	11	4	1	-	-	-	-	1	1	6
2		Menaxhim Veterinar	Prof. Zvëçar	-	-	6	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	
	Totali			11	15	37		6	12	4	1				1	1	6	

6.2 Gjurmimi i studenteve

Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve, nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni-t, ndër të tjera, gjurmon dhe ecurinë e studentëve të diplomuar. Gjurmimi realizohet në dy momente; momenti i parë menjëherë mbas diplomimit dhe momenti i dytë një vit mbas diplomimit.

Në momentin e parë të gjurmimit, QKA-ja nëpërmjet Zyrave të Karrierës pranë çdo njësie kryesore të UBT-së, mban të dhënat e studentëve nëpërmjet plotësimit të një formulari. Në këtë formular studentët deklarojnë të dhëna të përgjithshme (kontaktet, adresën etj.), ciklin e studimeve që përfundojnë, programin e studimit, aftësitë digjitale, tema e tezës, punësimi aktual dhe synimi. Ky proces i mbledhjes së të dhënave dhe plotësimit të databazës së gjurmimit është realizuar përgjatë periudhës Tetor, Nëntor, 2025.

Referuar të dhënave të paraqitura në *Tabelën 1*, për programet e profesionale nuk ka informacion në këtë drejtim. Nga të dhënat e grumbulluara vihet re se përqindja më e lartë e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimit bachelor të punësuar është në programet e studimit Ekonomi dhe politikat e zhvillimit rural me **44%**, Informatikë biznesi me **43%** dhe Financë - Kontabilitet me **42%** ndërkohë që problematikë është punësimi i studentëve të Menaxhimit të turizmit Rural dhe Ekonomiksi i Aplikuar. Përsa i përket tendencës së punësimit për ciklin e dytë të studimit Master Profesional, vihet re se ku niveli më i lartë i punësimit është tek studentët që mbarojnë në programet e studimit “Financë Bankë”, me **65%** dhe “Kontabilitet Auditim” me **45%**, ndërkohë që për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave niveli më i lartë i punësimit është në programin e studimit “Financë-Kontabilitet”, me **32%**. Ndërkohë që përsa i përket sektorit të punësimit vihet re se ata janë të punësuar kryesisht në sektorin privat.

Tabela 1. Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet pranë FEA

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Nr.i studentëve të diplomuar (2024-2025)	Nr.i studentëve të diplomuar (2023-2024)	Nr.studentëve i të licensuar (kur kërkohet	Studentë të punësuar	Të punësuar në publik	Të punësuar në privat	Të vetëpunësuar	Të papunësuar	Të padeklaruar (nuk ka informacion)	% mbi numri e studenteve te diplomuar					
												% Studentë të punësuar	% Të punësuar në publik	% Të punësuar në privat	% Të vetëpunësuar	% Të papunësuar	% Të padeklaruar (nuk ka informacion)
1	FEA	Menaxhim Sistemesh Informacioni (2- vjeçare)	25	12						12	0	0%	0%	0%	0%	100%	0%
2	FEA	Agroturizem & Mikpritje (2- vjeçare)	25	8						8	0	0%	0%	0%	0%	100%	0%
3	FEA	Menaxhim Agrobiznesi	111	62		20	1	18	1	15	27	32 %	2%	29%	2%	24%	44%
4	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural	69	64		28	2	26		15	21	44 %	3%	41%	0%	23%	33%
5	FEA	Financë-Kontabilitet	110	92		39	7	32		17	36	42 %	8%	35%	0%	18%	39%
6	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural	35	59		18	2	15	1	19	22	31 %	3%	25%	2%	32%	37%
7	FEA	Informatikë Biznesi	96	84		36	4	32	2	15	33	43 %	5%	38%	2%	18%	39%
8	FEA	Ekonomiks i Aplikuar	72	65		20	3	17		13	32	31 %	5%	26%	0%	20%	49%
9	FEA	Financë-Kontabilitet (Msc)	32	31		10	3	7		9	12	32 %	10%	23%	0%	29%	39%
10	FEA	Administrim Ndermarrjesh (Msc)	6	13		3		3		5	5	23 %	0%	23%	0%	38%	38%

11	FEA	Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Msc)	10	17		5	3	2		6	6	29 %	18%	12%	0%	35%	35%
12	FEA	Menaxhimi i Ndërmarrjeve (MP)	33	29		10	2	8		7	12	34 %	7%	28%	0%	24%	41%
13	FEA	Ekonomi dhe Politikë Agrare (MP)	24	24		4	2	2		9	11	17 %	8%	8%	0%	38%	46%
14	FEA	Financë Bankë (MP)	48	31		20	3	17		6	5	65 %	10%	55%	0%	19%	16%
15	FEA	Kontabilitet dhe Auditim (MP)	61	42		19	4	15		11	12	45 %	10%	36%	0%	26%	29%
16	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural (MP)	18	30		16	1	14	1	10	4	53 %	3%	47%	3%	33%	13%
17	FEA	Menaxhim Informacioni në Agrobiznes (MP)	14	6		2		2		1	3	33 %	0%	33%	0%	17%	50%
18	FEA	Menaxhim i Turizmit Rural (MP)	18	30		12	2	10		5	13	40 %	7%	33%	0%	17%	43%
19	FEA	Informatikë Biznesi (Msc)	7	6		2	1	1		1	3	33 %	17%	17%	0%	17%	50%
20	FEA	Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital	8	NA													
21	FEA	Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Territorial i Zonave Rurale (ME)	2	2						2	0	0%	0%	0%	0%	100%	0%
		Totali	824	707	0	264	40	221	5	186	257	37 %	6%	31%	1%	26%	36%

Gjurmimi i studentëve në FBM. Zyra e karrierës mbikqyr përpilimin, plotësimin dhe përditësimin e Skedës së Punësimit për studentët e nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor. Kjo skedë plotësohet nga studentët para se të tërheqin diplomat. Duke qënë se plotësimi i saj bëhet kryesisht në periudhën Nëntor - Dhjetor këto të dhëna nuk janë të plota për studentët e diplomuar në vitin akademik 2024-2025. Nga të dhënat e grumbulluara vihet re se përqindja më e lartë e studentëve që kanë mbaruar ciklet e studimit në FBM të punësuar është në programet e studimit të ofruar nga DHAP dhe DMB ndërkohë që problematikë është punësimi i studentëve të DAP dhe DSHZ. Ndërkohë që përsa i përket sektorit të punësimit vihet re se ata janë të punësuar kryesisht në sektorin privat.

Tabela nr 12 Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në FBM.

Programi i Studimit	Nr.i studentëve të diplomuar (2024-2025)	Nr.i studentëve të diplomuar (2023-2024)	Nr.studientëve i të licencuar (kur kërkohet licënsimi)	Studentë të punësuar	Të punësuar në publik	Të punësuar në privat	Të vetëpunësuar	Të papunësuar	Të padëklaruar (nuk ka informacion)	% mbi numri e studenteve të diplomuar					
										% Studentë të punësuar	% Të punësuar në publik	% Të punësuar në privat	% Të vetëpunësuar	% Të papunësuar	% Të padëklaruar (nuk ka informacion)
Hortikulturë/Teknologji e avancë Horti/Ark.Pezazhi/Kopshtari		87		16	1	8	1	5	43	18	1	9	1	6	49
Mbrojtje Bimësh/Mjeksi Bim. (Msc)/Mb. Kim.& Fitofarm./MP		49		14	2	5	7	15	25	29	4	10	14	31	51
Mjedis dhe Burime Natyrore/MSc&MP		118		8	0	8	0	4	39	7	0	7	0	3	33
Zooteknia dhe Siguria e Produkteve Blegtorale/MSc/2-vjeçar		20		1	0	1	0	0	19	5	0	5	0	0	95
Biologji Marine dhe Akuakulturë/Tek Prodh Akuakulture		9		0	0	0	0	0	9	0	0	0	0	0	100
Shkenca Agronomike		56		4	0	1	3	0	41	7	0	2	5	0	73
Totali	0	339	0	43	3	23	11	24	176	13	1	7	3	7	52

Burimi: Qendra e Karrierës dhe Alumnit UBT, Zyra e karrierës-FBM

Gjurmimi i studenteve ne FBU. Studentët e diplomuar në Fakultetin e Bioteknologjisë Ushqimore sipas të tdhënave të paraqitura në tabelën 2, lidhur me nivelin e punësimit, rezulton se studentët që diplomohen në Masterin e Shkencave “Teknologji Agroushqimore ” janë punësuar 79% prej tyre dhe studentët e diplomuar në Masterin Profesional Analizat e ushqimit janë punësuar 48% e tyre, ndërsa studentët e diplomuar në Masterin Shkencor “Sistemet e qëndrueshme të ushqimeve” kanë normë më të ulët punësimi. Studentët e diplomuar në FBU janë kryesisht të punësuar në sektorët privatë më shumë se atë publik. Vetëpunësimi rezulton në përqindje më të ulët.

Tabela nr 2: Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Nr.i stud. të diplom.	Nr.stud. i të lçens. (kur kërkohet lçens.)	% studentëve të punësuar	% Të punësuar në publik	% Të punësuar në privat	% Të vetëpunësuar	% Të papunësuar	% Të padëklaru ar (nuk ka informacion)
1	FBU	M. Sh. Teknologji Agroushqimore	19		79%(15/19)		80%(12/15)	20%(3/15)	21%(4/19)	
2	FBU	M. Sh. Sistemet e Qendrueshme të Ushqimeve"	3		33% (1/3)		100%(1/1)			67%(2/3)
3	FBU	M. Sh. Bioteknologji Ushqimore	14		43% (6/14)	33%(2/6)	67%(4/6)		57%(8/14)	
4	FBU	M. Sh. Shkencat e Ushqimit dhe te Ushqyerit	19		47% (9/19)		47%(9/19)		53%(10/19)	
3	FBU	M. P. "Cilesia dhe Siguria Ushqimore"	60		37% (22/60)	5%(1/22)	95%(2/22)		63%(38/60)	
5	FBU	M. P. Analizat e Ushqimit	23		48% (11/23)	27%(3/11)	55%(6/11)	18%(2/11)	52%(12/23)	

Gjurmimi i studenteve ne FMV. Për vitin akademik 2024-2025, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, janë diplomuar 99 studentë ne Mjekësi Veterinare dhe 19 studentë në programin profesional 2 vjeçar Menaxhim Veterinar. Përsa i përket të dhënave për punësimin nuk janë paraqitur të dhëna nga ana e fakultetit.

Tabela 4. Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare.

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Nr.i studentëve të diplomuar	Nr. studentëve të licensuar (kur kërkohet licënsimi)	% Studentëve të punësuar	% Të punësuar në publik	% Të punësuar në privat	% Të vetëpunësuar	% Të papunësuar	% Të padeklaruar (nuk ka informacion)
1.	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	Mjekësi Veterinare	99	Nuk ka informacion	-	-	-	-	-	-
		Menaxhim Veterinar	19	Nuk ka informacion	-	-	-	-	-	-

Gjurmimi i studenteve ne FSHP Për vitin akademik 2024-2025, në Fakultetin e Shkencave Pyjore, janë diplomuar 77 studentë gjithsej. Përsa i përket të dhënave për punësimin nuk janë paraqitur të dhëna nga ana e fakultetit. Përsa i përket të dhënave të punësimit numri më i lartë i punësimit është tek programi i studimit Master Profesional “Konstruksione druri” me 100% të të punësuarave. Problem është punësimi tek studentët të cilët kanë përfunduar programin e studimit të ciklit të parë në Inxhinieri Pyjore me profil "Menaxhim i zonave të mbrojtura dhe Qeverisja e Parqeve Urbane dhe Periurbane"

Tabla 5. Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Nr.i studentëve të diplomuar	Nr.studentëve i të licensuar (kur kërkohet licensimi)	% Studentëve të punësuar	% Të punësuar në publik	% Të punësuar në privat	% Të vetë punësuar	% Të papunësuar	% Të padeklaruar (nuk ka informacion)
1	FSHP	Inxhinieri Pyjore Bachelor	14		50		50		30	20
2	FSHP	Inxhinieri Perpunim Druri Bachelor	12				40		60	
3	FSHP	Dizajn i Mobilieve dhe Interierit Bachelor	9				22		78	
4	FSHP	Inxhinieri Pyjore me profil "Menaxhim i zonave të mbrojtura dhe Qeverisja e Parqeve Urbane dhe Periurbane"	-							
5	FSHP	Inxhinieri Pyjore Msc	7			30	70			
6	FSHP	Inxhinieri Perpunim Druri Msc	10			20	80			
7	FSHP	Konstruksione Druri Mp	5				100			
8	FSHP	Menaxh.Integr.Pyjev e me baze komuniteti Mp	20			40	60			

6.3 Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së .

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutin e UBT-së, si edhe në Rregulloren ”Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UBT-së”, studentët kanë të drejtë të jenë anëtarë dhe përfaqësues në organet drejtuese të IAL-së me rol vendimmarrës.

Në Universitetin Bujqësor të Tiranës 3 studentë janë pjesë e Senatit Akademik.

Studentë anëtarë të Senatit Akademik

Njësia Kryesore	Programi i studimit	Emër Mbiemër
Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	Cikli i parë Bachelor Inxhinieri Agromjedi	Jurilda Frroku
Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Cikli i parë Bachelor Finance - Kontabilitet	Fjona Allkaj
Fakulteti i Bioteknologjisë Ushqimore	Cikli i parë Bachelor Shkencat Ushqimit	Estela Pinderi

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutin e UBT-së, studentët kanë përfaqësues dhe në Këshillin e Etikës së Universitetit

Njësia Kryesore	Programi i studimit	Emër Mbiemër
Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Cikli i parë Bachelor Menaxhim Agrobiznesi	Marina Njebeza

7. ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE SIGURIMI I BREND SHEM I CILËSISË

Një nga elementet bazë të funksionimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës mbështetur në historikun dhe traditën e tij është sigurimi i cilësisë së mësimdhënies. Aktivitetet në fushën e cilësisë së mesimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës janë në përputhje me Strategjinë e UBT-së dhe në përputhje me udhëzimet e Kartës së Bolonjës.

Cilësia e mesimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës bazohet në dispozitat ligjore, rregulloret e brendshme dhe rekomandimet për cilësinë e arsimit që përmban Standartet dhe Udhëzimet për Cilësinë e Arsimit pranë ASCAL si dhe në cdo udhëzim të njohur si praktikatat të mira në gjithë hapësirën arsimore globale .

7.1 Standartet Kombëtare të Cilësisë

- Ligji Nr. 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqiptarisë
<https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/Ligji%20Nr.%2080,%202015.pdf>
- Vendim i KM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.”
<https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM%20Nr.824,%20date%2024.12.2021%20Per%20miratimin%20e%20Kodit%20te%20Cilesise%20se%20Arsimit%20te%20Larte.pdf>
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
<https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20e%20Arsimit%202021-2026.pdf>
- Manual për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit
<https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20programet%202017.pdf>
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm
<https://www.ascal.al/sq/informacione/publikime#modeli-i-raportit-te-vleresimit-te-brendshem-2022>
- Statuti i UBT

7.2 Standartet Ndërkombëtare të Cilësisë

- Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG)
<https://www.eqar.eu/kb/esg/>
- Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA)
<https://www.qaa.ac.uk/en/home>
- Italian National Agency for the Evaluation of Universities and Research Institutes (ANVUR)
<https://www.anvur.it/en/homepage/>
- Association of European Schools of Planning (AESOP)
<https://www.aesop-planning.eu/aesop/about-aesop>

Gjate vitit akademik 2025-2025 puna e drejtorisë ka qenë e ngjeshur dhe ka konsistuar në një sërë aktiviteteve të cilat kanë kontribuar rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të cilësisë së procesit të mësimin në univesitet.

- Gjatë vitit të kaluar akademik ka përfunduar procesi i Kodifikimit të programeve të studimit sipas kërkesave të MAS dhe ASCAL. Procesi i Kodifikimit ka mundësuar unifikimin e programeve të studimit në rang vendi.
- Kanë përfunduar rezultatet e akreditimit për dhjetë programe studimi nga ana e ASCAL.
- Gjithashtu ka përfunduar dhe procesi i kodifikimit për të gjithë programet e studimit të UBT. Në formë të detajuar i gjithë aktiviteti i drejtorisë është paraqitur në Aneksin 5. Ndërkohë procesi i cilësisë është zhvilluar dhe sipas fakulteteve.
- Zyra ka përgatitur dhe pyetësin për misionin e tretë kërkuar nga ASCAL dhe MAS.

7.3 Organizimi, menaxhimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë sipas fakulteteve

Në drejtim të sigurimit të cilësisë është punuar edhe nga fakultetet, veprimtari e cila paraqitet si më poshtë :

FEA

Fakulteti ka funksionuar normalisht në bazë të rregullores së brendshme të tij. Rregullorja mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit Bujqësor, në Rregulloren e Studimeve në UBT, në vendimet e Senatit Akademik të UBT-së. Cdo program studimi ka rregulloren e tij ku ka specifikime më të detajuara sipas vecantive të tyre.

Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në FEA, bazuar edhe në përcaktimet statutores (Neni 85 i statutit të UBT), funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC). Ajo bashkëpunon me Drejtorinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBSC) në nivel rektorati në veprimtarinë e saj. Kjo njësi gjatë vitit të kaluar ka bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat e dekanatit të FEA-s dhe në vecanti me Zëvendës Dekanen për mesimin në funksion të mbarëvajtjes së procesit akademik. Ky bashkëpunim ka konsistuar kryesisht në kontributin e NJSC në procesin e akreditimit të programeve (një angazhim konstant i FEA-s gjatë dy viteve të fundit në përmbushje të detyrimeve ligjore) si edhe në procesin e përmirësimit të kurrikulave apo mbarëvajtjen së procesit mësimor. Gjatë vitit akademik 2024-2025 roli i këtyre strukturave ishte thelbësor për mbarëvajtjen e procesit të akreditimit. Tabela e mëposhtë paraqet një informacion të aktiviteteve të zhvilluara nga këto struktura.

Tabela 15 – Mbi veprimtarinë e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë

Nr.	Aktiviteti/ Veprimtaria	Grupi 122lerësimitt ë Brendshëm/ Përbërja	Periudha Kohore	Rezultati/ Produkti
1	Mbarëvajtja e mësimit	UBT/FEA	Viti 2024- 2025	Raporte dhe konkluzione që përfshihen në analizat e veprimtarisë mësimore.

2	Kontrolle te vazhdueshme te procsit mesimor	UBT/FEA	Viti 2024-2025	Raporte kontrolli si dhe permiresimi i respektimit te procesit mesimor
---	---	---------	----------------	--

FBM

UBT ka në përbërjen e tij Drejtorinë e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila administron sistemin e menaxhimit të procesit mësimor, organizativ dhe administrativ, i cili është i paisur me strukturë të teknologjisë së informacionit dhe që është në varësi të kësaj zyre.

Fakulteti funksionon në bazë të rregullores së brendshme të tij. Rregullorja mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit Bujqësor, në Rregulloren e Studimeve në UBT, në vendimet e Senatit Akademik të UBT-së. Çdo program studimi ka rregulloren e tij ku ka specifikime më të detajuara sipas vecantive të tyre.

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor

Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

FBM bashkëpunon me Drejtorinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBSC) në nivel rektorati në veprimtarinë e saj. Kjo njësi gjatë vitit të kaluar ka bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat e dekanatit të FBM-s në funksion të mbarëvajtjes së procesit akademik. Ky bashkëpunim ka konsistuar kryesisht në kontributin në procesin e akreditimit të programeve si edhe në procesin e përmirësimit të kurrikulave apo mbarëvajtjen së procesit mësimor.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion të aktiviteteve të zhvilluara nga këto struktura.

Tabela 25 - Mbi veprimtarinë e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë

Nr.	Aktiviteti/ Veprimtaria	Grupi Vlerësimit të Brendshëm/ Përbërja	Periodha Kohore	Rezultati/ Produkti
1	Mbarëvajtja e mësimit	UBT/FBM	Viti 2024-2025	Raporte dhe konkluzione që përfshihen në analizat e veprimtarisë mësimore.
2	Kontrolle të vazhdueshme të procsit mesimor	UBT/FBM	Viti 2024-2025	Raporte kontrolli si dhe permiresimi i respektimit te procesit mesimor

FMV

Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky informacion paraqitet në mënyre përshkruese, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

FMV në funksionimin e tij bazohet në Ligjin në fuqi për arsimin e lartë, Statutin e UBT, Kodin e etikës si edhe Rregulloren e studimeve të UBT. Është punuar në përmirësimin dhe përditësimin e Rregullores së brendshme të FMV e finalizuar me miratimin e saj **me Vendim Nr. 7, datë**

16.05.2022 të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Gjithashtu fakulteti disponon dhe punon vazhdimisht në drejtim të përditësimit të Rregullores së zhvillimit të praktikës profesionale dhe Rregullores së diplomimit.

Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas tabelës mëposhtë:

Gjatë vitit akademik 2024-2025, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) nuk funksionoi në praktikë në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Kjo njësi ka detyrën të monitorojë dhe vlerësojë të gjitha proceset mësimore dhe kërkimore, duke siguruar përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë **ESEVT (European System of Evaluation of Veterinary Training)** dhe rekomandimet e BOKU-AUT 2030. Në vend të saj, dhe duke u bazuar edhe në kërkesat e reformës së projektit **BOKU-AUT 2030**, aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm u realizuan nga **Grupi i Vetë-Vlerësimit** i ngritur për këtë qëllim, duke përfshirë anëtarët kryesorë të Fakultetit dhe studentë përfaqësues:

- **Prof. Dr. Xhelil Koleci** – Kryetar i Komitetit të Akreditimit, Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar
- **Prof. Asoc. Sonila Çoçoli** – Kryesuese e Lëndëve të Shëndetit Publik Veterinar
- **Prof. Asoc. Eglantina Xhemollari** – Kryesuese e Lëndëve Preklinike
- **Dr. Majlind Sulçe** – Kryesues i Lëndëve Morfofunksionale
- **Prof. Asoc. Albana Munga** – Zv. Dekane për Mësimdhënien
- **Prof. Asoc. Egon Andoni** – Zv. Dekan për Kërkimin Shkencor
- **Dr. Gerald Muça** – Departamenti i Lëndëve Klinike
- **MSc. Taulant Goga, MSc. Bledar Goxha, MSc. Altin Metalla, MSc. Florian Plaku** – Departamenti i Lëndëve Klinike
- **Student kursi 2: Mrs. Valjona Shyti**
- **Student kursi 4: Mrs. Arjana Çobaj**

Ky grup hartoi një analizë të detajuar të kurrikulës ekzistuese, duke vlerësuar çdo komponent akademik dhe praktik të programit 5-vjeçar. Analiza përqendrohej në disa pika kyçe:

1. **Struktura e programit:** Semestri final ishte i pazhvilluar dhe i pa-strukturuar, duke u mbështetur kryesisht në praktikë jashtë fakultetit me mbikëqyrje të kufizuar.
2. **Praktika klinike dhe rotacionet:** Nuk ofrohej ekspozim i mjaftueshëm ndaj lëndëve kyçe si kirurgjia, mjekësia e brendshme, nekropsia dhe siguria ushqimore.
3. **Kompetencat “Day-One”:** Studentët aktualisht nuk mund të arrijnë të gjitha **38 kompetencat themelore** të kërkuara nga standardet ESEVT, përfshirë marrjen e mostrave biologjike nga specie të ndryshme, kryerjen e procedurave emergjente dhe interpretimin e gjendjeve patologjike.
4. **Vlerësimi dhe metodologjia mësimore:** Strategjitë aktuale të vlerësimit ishin të vjetruara dhe të pa-alinuara me edukimin bazuar në kompetenca, duke përdorur kryesisht teste me alternativa të shumëfishta pa standardizim dhe pa trajnime të mjaftueshme për stafin mësimor.

Në këtë kontekst, **misioni i ekspertëve të EAEVE** (European Association of Establishments for Veterinary Education) u zhvillua për të vlerësuar raportin e vetë-vlerësimit dhe për të dhënë rekomandime të drejtpërdrejta mbi reformën e kurrikulës. Në mision bënë pjesë:

- **Prof. Dr. Petra Winter** – Presidente e EAEVE
- **Prof. Dr. Pierre Lekeux** – Sekretar i përgjithshëm i EAEVE

Ekspertët vlerësuan se raporti i vetë-vlerësimit ishte i plotë, vetëkritik dhe strukturuar mirë, duke reflektuar një analizë të detajuar të të gjitha aspekteve të programit. Megjithatë, ata konstatuan mangësi kritike në përmbushjen e standardeve për akreditim sipas direktivave të BE-së, dhe theksuan nevojën urgjente për:

- Strukturimin e semestrit përfundimtar dhe rotacionet klinike;
- Përmirësimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe të stafit për të mbështetur trajnimin praktik;
- Hartimin e një sistemi të gjurmimit të kompetencave të studentëve, siç është **e-logbook digital**, për të siguruar përputhshmërinë me 38 kompetencat Day-One;
- Modernizimin e metodave të vlerësimit duke përdorur simulime klinike, vlerësime orale strukturuara dhe teste praktike të aftësive.

Për të siguruar që hartimi i programeve të ardhshme të jetë **i pavarur, transparent dhe i bazuar në standarde ndërkombëtare**, u vendos ngritja e një **Komisioni të veçantë për Kurrikulën**, i përbërë nga anëtarë të fakultetit pa përfshirje të dekanatit.

Mbledhjet e Komisionit të Kurrikulës kanë pasur si qëllim fillimin e procesit të ridizenjimit dhe përmirësimit të kurrikulës së Fakultetit, në përputhje me standardet e EAEVE-së dhe kërkesat bashkëkohore të tregut të punës dhe studentëve. Procesi fokusohet te zhvillimi i një plani të qartë pune, përfshirja e moduleve mbi sigurinë ushqimore, shëndetin publik, biologjinë molekulare, teknologjitë diagnostike dhe dixhitalizimin e shërbimeve veterinarie.

Diskutimet kanë përfshirë përshtatjen e një modeli ekzistues kurrikular ose ndërtimin e një qasjeje të re, të moduluar sipas nevojave lokale. Është theksuar rëndësia e lidhjes së lëndëve bazë me aftësitë praktike që studentët do të zhvillojnë, si dhe zhvillimi i një pyetësoi për grupe interesi për të identifikuar nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, stafit akademik dhe praktikuesve. Rezultatet e pyetësoit janë përpunuar në mënyrë anonime dhe po integrohen në draftin e kurrikulës.

Janë përcaktuar detyra kryesore dhe afatet për fazën e parë të punës, duke përfshirë mbledhjen dhe analizimin e modeleve kurrikulare ekzistuese, hartimin e pyetësoit, përgatitjen e draft-planit strategjik dhe dokumentacionin për miratim nga Ministria e Arsimit. Takimet e komisionit zhvillohen rregullisht çdo javë, ndërsa dokumentet e përgatitura shpërndahen për rishikim në format PDF përpara takimeve.

Afatet kryesore të fazës së parë përfshijnë finalizimin e pyetësoit dhe gjetjeve të tij, prezantimin e koncepteve kurrikulare, konsultimin me ekspertët ndërkombëtarë dhe dorëzimin e modelit të parë të kurrikulës së ridizajnuar dhe draft-planin strategjik. Mbledhjet dhe aktivitetet e komisionit synojnë të sigurojnë një proces të koordinuar dhe të vazhdueshëm për përmirësimin e kurrikulës së Fakultetit.

Ky komision punon sipas **Kuadrit Rregullator dhe Standardeve për Hartimin e Programeve Mësimore të projektit BOKU-AUT 2030**, duke garantuar që çdo propozim për program Bachelor dhe Master të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Harmonizim me programet e BOKU-së dhe universiteteve prestigjioze të BE-së;
- Përputhshmëri me kompetencat e përcaktuara nga UBT;
- Qëndrueshmëri për një periudhë 5-10 vjeçare;
- Përshtatje me tregun e punës, fushat kërkimore dhe nivelin e internacionalizimit (të paktën 1/3 e programit në anglisht);
- Përfshirja e pedagogëve me përvojë ndërkombëtare dhe konsultimi me homologët e BOKU/VetMedUni për miratimin e syllabuseve dhe materialeve bazë;
- Identifikimi i kapaciteteve infrastrukturore të nevojshme për mësim dhe kërkim;
- Hartimi i një plani të qartë për menaxhimin e stafit dhe përgjegjësitë e tyre akademike;
- Zhvillimi i moduleve të përbashkëta, të fushës dhe të drejtimit specifik, duke përfshirë tekstet bazë të përdorura në universitetet prestigjioze.

Ky proces i ndërtimit të programit të ri është themelor për **reformën e kurrikulës 5.5-vjeçare**, duke siguruar një kalim të qetë për studentët ekzistues, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe trajnimin praktik, dhe krijimin e bazës për **akreditim ndërkombëtar** dhe ngritjen e Fakultetit si udhëheqës rajonal në edukimin veterinar.

Megjithëse NJSBC nuk ka funksionuar si strukturë operative gjatë këtij viti akademik, mekanizmat e përkohshëm të ngritur nga **Grupi i Vetë-Vlerësimit** kanë siguruar që procesi i vlerësimit të brendshëm të realizohet në mënyrë sistematike, duke mbështetur reformën e kurrikulës dhe përgatitjen për akreditim ndërkombëtar.

Për vitet e ardhshme, është planifikuar rikthimi dhe forcimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke përfshirë:

- Trajnime të stafit dhe studentëve për praktikat më të mira të sigurimit të cilësisë;
- Implementimin e sistemeve digjitale për vlerësimin e programeve dhe gjurmimin e kompetencave;
- Bashkëpunimin e vazhdueshëm me ekspertët ndërkombëtarë dhe homologët e BOKU/VetMedUni;
- Sigurimin e monitorimit të rregullt të programeve Bachelor dhe Master sipas standardeve të BE-së.

Ky proces do të garantojë që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare të ketë një strukturë të qëndrueshme për **menaxhimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë**, e cila do të mbështesë zhvillimin profesional të stafit dhe arritjen e standardeve të larta akademike dhe praktike.

Tabela nr 15. Mbi veprimtarinë e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.

Nr.	Aktiviteti/ Veprimtaria	Grupi Vlerësimit të Brendshëm/ Përbërja	Periodha Kohore	Rezultati/ Produkti
1	Analizë e detajuar e strukturës së programit 5-vjeçar	Prof. Dr. Xhelil Koleci, Prof. Asoc. Sonila Çoçoli, Prof. Asoc. Eglantina Xhemollari, Dr. Majlind Sulçe, Prof. Asoc. Albana Munga, Prof. Asoc. Egon Andoni, Dr. Gerald Muça, MSc. Taulant Goga, MSc. Bledar Goxha, MSc. Altin Metalla, MSc. Florian Plaku, Studentë përfaqësues: Valjona Shyti, Arjana Çobaj	Viti akademik 2024-2025	Përfunduar; identifikuan mangësitë kryesore në semestrin final dhe rotacionet klinike
2	Vlerësimi i përputhshmërisë me 38 kompetencat Day-One të ESEVT	Grupi i Vetë-Vlerësimit	Viti akademik 2024-2025	Përfunduar; konstatuar deficite të rëndësishme
3	Vlerësimi i metodave të vlerësimit dhe praktikave mësimore	Grupi i Vetë-Vlerësimit	Viti akademik 2024-2025	Përfunduar; rekomandime për përdorimin e simulimeve klinike dhe logbook
4	Hartimi i raporteve të përkohshme dhe koordinimi me ekspertët e EAEVE	Grupi i Vetë-Vlerësimit dhe ekspertët e EAEVE: Prof. Dr. Petra Winter, Prof. Dr. Pierre Lekeux	Viti akademik 2024-2025	Përfunduar; ekspertët dhanë rekomandime për reformë urgjente
5	Propozimi i ngritjes së Komisionit të Kurrikulës për hartimin e programit të ri 5.5-vjeçar	Komisioni i Kurrikulës (Prof. Dr. Xhelil Koleci (Kryetar), Prof. Dr. Pëllumb Zalla, Prof. Asoc. Dr. Dritan Laçi, Dr. Ermiona Hajdini (grup interesi Bashkia Tiranë), Arjana Cobaj dhe Valjona Shyti (përfaqësuese studentësh) dhe Dekanati	Viti akademik 2024-2025	Realizuar; komisioni punon sipas Kuadrit Rregullator BOKU-AUT 2030
6	Mbledhja e Komisionit për kurrikulën	Anëtarë të komisionit, përfaqësues studentësh, grup interesi	Qershor 2025	Diskutime mbi ridizenjimin e kurrikulës, përcaktim i detyrave dhe afateve, draft-plan strategjik fillestar
7	Hartimi i pyetësorit për grupe interesi	Anëtarët e komisionit	Qershor 2025	Pyetësor elektronik për studentë, staf akademik dhe praktikues; përpunim anonim i të dhënave

8	Analiza e modeleve ekzistuese kurrikulare	Grupi i brendshëm i komisionit	Qershor – Korrik 2025	Përmbledhje dhe sintetizim i modeleve të ndryshme; draft i parë për diskutim
9	Draft-plani strategjik për kurrikulën e re	Grupi i komisionit	Qershor – Korrik 2025	Draft i planit strategjik me faza pune, burime, risk-management dhe buxhet preliminar
10	Konsultimi me ekspertë ndërkombëtarë	Komisioni, ekspertë EAEVE	Qershor 2025	Sugjerime dhe komente për draftin e kurrikulës; integrimi i rekomandimeve ndërkombëtare
11	Draftimi i rekomandimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe stafit akademik	Komisioni i Kurrikulës dhe Dekanati	Viti akademik 2024-2025	Draft i përfunduar; rekomandime për kapacitetet infrastrukturore dhe staf për trajnimin praktik
12	Hartimi i planit për implementimin e sistemeve të vlerësimit	Komisioni i Kurrikulës dhe Dekanati	Viti akademik 2024-2025	Draft i përfunduar; sugjerim për logbook dhe monitorim kompetencash
13	Përgatitja e dokumentacionit për miratim në Ministri	Dekanati / Komisioni	Korrik 2025	Paketë e plotë dokumentacioni për miratim, duke përfshirë draftin kurrikular, analizat e pyetësorit dhe planin strategjik
14	Bashkëpunimi me homologët ndërkombëtarë dhe ekspertët e EAEVE për miratimin e syllabuseve	Komisioni i Kurrikulës dhe ekspertët e EAEVE	Viti akademik 2024-2025	Në vazhdim; syllabuset dhe materialet bazë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare

Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë.

Gjatë vitit akademik, ndërveprimi i Universitetit Bujqësor të Tiranës me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e saj vartëse ka qenë funksional dhe i konsoliduar, duke reflektuar një bashkëpunim korrekt dhe të harmonizuar në procese të rëndësishme institucionale si miratimi i programeve të reja, akreditimi, investimet infrastrukturore dhe qartësimi i procedurave administrative të nevojshme për zbatimin e projekteve. UBT, si universitet publik me profil të specializuar në shkencat bujqësore, ushqimore dhe veterinare, varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga udhëzimet dhe aktet ligjore që burojnë nga MAS, duke e bërë këtë ndërveprim kyç për funksionimin e tij të rregullt.

Në këtë kuadër, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare përfaqëson një strukturë me specifikë të veçantë dhe me rëndësi të lartë strategjike, pasi Mjekësia Veterinare është programi i vetëm i këtij lloji në vend dhe është i lidhur drejtpërdrejt me standardet e Bashkimit European, përfshirë direktivat për njohjen profesionale dhe kërkesat cilësore të EAEVE. Për këto arsye, është thelbësore që MAS të ketë parasysh rolin që ky program luan në sigurinë ushqimore, shëndetin publik, ekonominë bujqësore dhe tregtinë e produkteve shtazore. Përvoja ndërkombëtare, tregon se programet e mjekësisë veterinarë trajtohen me prioritet të lartë politik, financiar dhe akademik, pasi përfshihen drejtpërdrejt në menaxhimin e zoonozave, sëmundjeve me ndikim ekonomik, mirëqenien e kafshëve dhe qasjen ndërdisiplinore One Health, që lidhet me ndërthurjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe mjedisit.

Në këtë perspektivë, rekomandohet që programi i Mjekësisë Veterinare të trajtohet me një qasje të diferencuar në nivel kombëtar, duke marrë parasysh natyrën e tij strategjike. Programet e këtij karakteri kërkojnë mbështetje të dedikuar në buxhetim, modernizim dhe përditësim ligjor, pasi ndikojnë në sigurinë ushqimore, menaxhimin e emergjencave veterinarë, tregtinë e produkteve shtazore dhe përmbushjen e detyrimeve të BE-së në kuadër të kapitujve të negociatave. Po ashtu, është e domosdoshme që MAS të mbështesë në mënyrë të qëndrueshme investimet infrastrukturore që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e arsimit veterinar. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka nevojë për laboratorë të certifikueshëm, pajisje moderne diagnostike, ambiente klinike funksionale, skill-labs, platforma të avancuara digjitale dhe një sallë nekropsie të standardeve ndërkombëtare, infrastrukturë e cila, sipas praktikave globale, konsiderohet minimale dhe e domosdoshme për garantimin e një programi veterinarë të akredituar dhe efektiv.

Në mënyrë të veçantë, kërkohet mbështetje më e gjerë për zhvillimin e praktikave profesionale, të cilat përbëjnë bërthamën e formimit të studentëve të UBT-së dhe sidomos të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Praktikantët në ferma blegtorale, në thertore, në qendra grumbullimi, në operatorë të përpunimit të produkteve shtazore dhe në struktura të tjera të sigurisë ushqimore kanë një rol kyç në përgatitjen reale të studentëve, por shoqërohen me kosto të larta për universitetin. Këto aktivitete kërkojnë transport të dedikuar, pajisje mbrojtëse, sigurime, staf shoqëruar dhe marrëveshje operative me subjektet pritëse, elemente që tejkalojnë shpesh kufijtë e buxhetit të një institucioni të arsimit të lartë. Për këtë arsye, është e nevojshme që MAS të vendosë fonde të dedikuara për praktikantët profesionale në programet bujqësore dhe veterinarë, duke garantuar që studentët të kenë akses të plotë në eksperiencë reale në terren, ashtu siç aplikojnë modelet e vendeve të zhvilluara.

Përmirësimi i kësaj marrëdhënieje ndërinstitucionale ndërmjet UBT-së dhe MAS-it, si dhe mbështetja specifike për programe strategjike si Mjekësia Veterinare, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, forcimin e kapaciteteve profesionale të studentëve dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare në fushën e shëndetit të kafshëve, shëndetit publik dhe sigurisë ushqimore, duke kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në interesin ekonomik dhe social të vendit.

FSHP

Fakulteti ka funksionuar normalisht në bazë të rregullores së brendshme të tij. Rregullorja mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit Bujqësor, në Rregulloren e Studimeve në UBT, në vendimet e Senatit Akademik të UBT-së. Cdo program studimi ka rregulloren e tij ku ka specifikime më të detajuara sipas vecantive të tyre.

Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në FSHP, bazuar edhe në përcaktimet statutores (Neni 85 i statutit të UBT), funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC). Ajo bashkëpunon me Drejtorinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBSC) në nivel rektorati në veprimtarinë e saj. Kjo njësi gjatë vitit akademik 2023-2024 ka bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat e dekanatit dhe në vecanti me Zëvendës Dekanin për mesimin në funksion të mbarëvajtjes së procesit akademik. Gjatë vitit akademik 2023-2024 roli i këtyre strukturave ishte thelbësor për mbarëvajtjen e procesit të akreditimit. Tabela e mëposhtme paraqet një informacion të aktiviteteve të zhvilluara nga këto struktura.

Table 7. Mbi veprimtarinë e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë

Nr.	Aktiviteti/ Veprimtaria	Grupi Vlerësimit të Brendshëm/ Përbërja	Periudha Kohore	Rezultati/ Produkti
1	Mbarëvajtja e mësimit	UBT/FSHP	Viti 2024-2025	Raporte dhe konkluzione që përfshihen në analizat e veprimtarisë mësimore.
2	Kontrolle vazhdueshme të procesit mesimor	UBT/FSHP	Viti 2024-2025	Raporte kontrolli si dhe permiresimi i respektimit te procesit mesimor

FBU Nuk ka informcion

8. VEPRIMTARIA MBESHTETESE NE FUSHEN E MESIMIT

8.1 Veprimtaria mbështetëse në fushën e mësimit

Veprimtaria mbështetëse në fushën e mësimit ka qenë si në nivel universiteti ashtu dhe në fakultetet përkatëse. Më konkretisht të gjitha fakultetet e kanë analizuar si më poshtë mbështetjen në fushën e mësimit:

FEA

Adminstratori i njësisë:

Administratori i FEA-së në bashkëpunim me Dekanatin ka realizuar të gjithë detyrat e tij të parashikuara nga Statuti i UBT-së. Strukturat përgjegjëse të Fakultetit tregojnë përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse. Bashkëpunimi dhe suporti mes strukturës akademike dhe administrative, ka bërë të mundur të argumentojnë, të tërheqin e të përfitojnë, buxhetin e kërkuar, në funksion të stafit, por edhe për studentët.

Mbështetur në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në IAL-të në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, analiza e veprimtarisë administrative dhe financiare paraqitet si vijon:

Raportimi i përvitshëm financiar dhe administrativ përbën një instrument thelbësor për menaxhimin transparent, të përgjegjshëm dhe efektiv të burimeve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Vlera e tij qëndron në përdorimin sistematik të të dhënave të mbledhura nga të gjitha njësitë për të analizuar mënyrën e shpenzimit të të ardhurave, të cilat përfshijnë jo vetëm tarifën e studentëve, por edhe fondet e alokuara nga buxheti i shtetit, projektet kërkimore dhe të ardhurat shitesë nga shërbimet ndaj aktorëve të jashtëm.

Raportimi i rregullt mundëson vlerësimin e nivelit të realizimit të planit buxhetor të miratuar, identifikimin e devijimeve, analizimin e kostove operative dhe planifikimin me efikasitet të burimeve të nevojshme për funksionimin e njësive akademike dhe administrative. Kjo qasje kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të situatës financiare dhe në ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm për administrimin efikas të buxhetit vjetor të FEA-s, duke garantuar përdorim racional të fondeve dhe mbështetje të objektivave strategjike të Fakultetit dhe UBT-së.

Në funksion të realizimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare, të domosdoshme janë jo vetëm burimet monetare, por edhe burimet njerëzore, të cilat përbëjnë një komponent kyç për zbatimin korrekt dhe profesional të proceseve të planifikimit, ekzekutimit dhe monitorimit financiar.

Kapacitetet administrative dhe ekspertiza e stafit të angazhuar në menaxhimin financiar sigurojnë integritetin e procedurave buxhetore, përgatitjen e analizave të besueshme dhe koordinimin me njësitë e tjera të UBT-së për të garantuar që burimet të orientohen drejt prioriteteve akademike, kërkimore dhe infrastrukturore të fakultetit.

Në terma më të gjerë, raportimi financiar i përvitshëm krijon bazën e vendimmarrjes strategjike, rrit transparencën institucionale dhe ndihmon në forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë dhe të qeverisjes së mirë brenda FEA-s.

Referuar sa më sipër, numri aktual i stafit të FEA-s është 111 nga 112 të miratuar në strukturën organizative (1 vend në ruajtje për kategorinë Prof. Dr. Ilir Kapaj në Departamentin Menaxhim Agrobiznesi, sepse kryen funksionin e Zv. Rektorit të UBT-së), nga të cilët, 91 janë staf akademik, 8 ndihmës akademikë dhe 12 staf administrativ dhe mbështetës. Nga 91 staf akademik, 16 janë Prof. Dr, 43 Prof. Ass, 17 Lektorë (Dr) dhe 15 Ass. Lektor (MSc) po ashtu edhe 51 Personel Akademik të ftuar. Bazuar në metodologjinë e planifikimit dhe pritshmërie për realizimin e objektivave të buxhetit për vitin akademik 2024-2025, analizojmë treguesit ekonomiko-financiarë faktik të vitit buxhetor 2025, duke i'u referuar situacioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve,

treguesit e të cilave janë rakorduar me sistemin e thesarit. Treguesit faktik të veprimtarisë ekonomike dhe financiare paraqesin përputhshmëri me objektivat e vendosura për vitin 2025. Efektet financiare të të ardhurave kanë ndikuar maksimalisht në realizimin e objektivave si:

1. Rritja e cilësisë së programeve të studimit aktual dhe të reja, si edhe konsolidimi i tyre mbi bazën e kriterëve të standarteve ndërkombëtare dhe reformës UBT_BOKU 2030,
2. Rritja e nivelit të kërkimit shkencor, nxitja e punës kërkimore-shkencore, si me fondet e fakultetit ashtu edhe nëpërmjet rritjes së numrit të projekteve kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomiko - bujqësore, nëpërmjet mbështetjes financiare nga AKKSHI dhe jo vetëm,
3. Përmirësimi i kushteve të ambienteve mësimore dhe të punës në fakultet, për studentët dhe stafin e FEA-s, nëpërmjet, kompletimit dhe rinovimit të pajisjeve elektronike dhe atyre orendi- mobilieri apo ngrohje ftohje, në auditorë për studentët, por edhe për stafin akademik, për rritjen e cilësisë së mësimnxënies dhe mësimdhënies.

Theksojmë se gjatë vitit 2025 janë kryer investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe posaçërisht atë mësimore, si edhe ndërhyrje të tjera gjithashtu të rëndësishme në infrastrukturën ndihmëse.

Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobizest, për vitin akademik 2024-2025, kanë ndjekur studimet **3074** studentë, përfshirë këtu dhe studentët, që ndjekin studimet dy vjeçare në Sisteme Informacioni në Agrobiznes dhe Agroturizëm e Mikpritje pa përfshirë studentët në ciklin e tretë të studimeve, Master Ekzekutiv e Doktoraturë.

Këta studentë zhvillojnë mësim si dhe aktivitetin e tyre akademik në ambientet e mëposhtme:

- 9 laboratorë me kapacitet total 170 vende ulje, në 3 prej të cilëve zhvillojnë mësim edhe studentët e fakulteteve të tjera të UBT-së.
- 14 auditor leksionesh, me kapacitet total 1,602 vende ulje, si edhe salla Behar Male, me kapacitet 280 vende ulje
- 28 auditor seminaresh, me kapacitet total 1,040 vende ulje.
- Salla e Videokonferencave me kapacitet total 30 vende ulje e cila është në dispozicion të doktorantëve të të gjithë UBT-së.
- 6 Salla audiovizive, L. Agraja, B. Male, 101 B, 114B, 215 B, 312 B.
- 63 Ambiente Personeli Akademik me kapacitet total 107 vende ulje
- 21 Ambiente Personeli Administrativ me kapacitet total 100 vende ulje.
- Biblioteka Fizike-FAE me kapacitet total 48 vende ulje
- Për të dy godinat është siguruar burim energjie alternative, nga instalimi i gjeneratorit me fuqi të lartë, që garanton furnizimin me energji elektrike.
- Të dy godinat kanë sistem mbrojtje kundra zjarrit.

Në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatin, sektorin e financës së FEA-së, Drejtorinë Ekonomike dhe Financës, si dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Fondeve dhe Investimeve të UBT-së, fakulteti ka arritur të sigurojë koordinim të plotë institucional për realizimin e objektivave të tij akademike dhe administrative. Proceset janë mbështetur gjithashtu në kontributin e njëjësive

bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të cilat kanë ofruar informacionet, analizat dhe nevojat respektive për planifikimin e saktë financiar dhe operacional.

Për vitin akademik 2025, në përputhje me Planin Buxhetor vjetor, puna është përqendruar veçanërisht në realizimin e fondeve të miratuara dhe menaxhimin e tyre eficient. Në këtë kuadër, është kryer një bashkërendim i vazhdueshëm me Degën e Thesarit Tiranë për zbatimin e procedurave buxhetore, ekzekutimin e pagesave dhe monitorimin e flukseve financiare. Paralelisht, janë rakorduar të gjitha të ardhurat e vetë FEA-s me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në UBT, duke siguruar koherencë ndërmjet buxhetit të planifikuar dhe atij të realizuar.

Ky koordinim i gjerë institucional ka mundësuar:

- rritjen e transparencës në menaxhimin e fondeve;
- mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve;
- përmirësimin e proceseve të planifikimit buxhetor;
- sigurimin e burimeve të nevojshme për mësimdhënie, kërkim dhe veprimtari administrativ-shkencore;
- rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në administrimin financiar të fakultetit;

Në tërësi, bashkëpunimi ndërmjet strukturave financiare të FEA-së dhe UBT-së garantojnë një administrim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të burimeve, duke krijuar një bazë të fortë për realizimin e prioritetëve institucionale dhe avancimin e zhvillimit akademik të fakultetit.

Burimet kryesore të financimit të buxhetit të FEA-s, vazhdojnë të jenë dy, buxheti i shtetit dhe të ardhurat e FEA/UBT.

Për vitin akademik 2024-2025, në FEA janë 3,074 studentë në të gjitha ciklet e studimit, përfshirë ciklet 2 vjeçare. Ndërkohë të Ardhura vijnë edhe nga 82 studentë doktorantë.

Për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar të ardhura për FEA-n, në vlerën prej 336,082 lekë, ku 74.5% e zë Buxheti i Shtetit dhe 25,5% e zënë të Ardhurat e fakultetit. Pra, burimi kryesor i të ardhurave është **Buxheti i Shtetit, në vlerën 245,079 lekë**, për financimin e mësimdhënies (shpenzime të funksionimit, për bursa studenti dhe fonde që trashëgohen nga viti paraardhës).

Të ardhurat nga Fakulteti, janë planifikuar për t'u arkëtuar në vlerën 91,003 lekë, duke konsideruar përlogaritjen me korrektësi të arkëtimeve nga:

- Tarifat e Shkollimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, sipas numrit aktual të studentëve, duke përjashtuar studentët përsëritës të mbartur në vite.
- Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë të studimeve, sipas kuotave pritëse.
- Tarifa e shkollimit për programin profesional 2-vjeçar.
- Taksat e regjistrimit, sipas kuotave pritëse për të dy ciklet e studimit.
- Tarifat për kredit nga provimet.
- Të ardhurat nga diploma e vërtetime.
- Të ardhura të rimbursimit nga shteti për tarifa shkollimi BC+DIND.
- Të ardhura nga shërbimet për studentët, përfshirë edhe ato për provimin APTIS.
- Të ardhura nga pagesa e tarifës për procedurat e kulafikimit të stafit akademik të IAL-ve të tjera.

Mungesa e realizimit të të ardhurave, në masën rreth 5 %, vjen kryesisht si rezultat i studentëve përsëritës, ku numri më i madh i tyre, referuar informacionit nga ZSS-ja nuk kanë frekuentuar mësimin për vitin akademik 2024-2025.

Në lidhje me studentët, janë

- Realizuar pagesat për student të kategorisë së shtresave në nevojë.
- Realizuar pagesat për student të regjistruar në degët prioritare (*është vetëm 1*).
- Kanë nisur procedurat ligjore për bursat e vitit akademik 2025-2026. Aktualisht , *deri me 30.11.2025 përfundon faza e parë e depozitimit të dokumentacionit të studentëve, sipas kategorive përfituese.*
